100 VJET PAVARESI

Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (71). MARS 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

HISTORI
“Gjenerali me shajak”
Nga: **XHAFER MARTINI** - FAQE 6-7

DEBAT
Beteja e Torviollit: vendi dhe simbolika
Nga: **ALI HOXHA** - FAQE 8-9

MJEDIS
Pylli i fermerit ka zot fermerin
Nga: **HAKI KOLA** - FAQE 12-13

PORTRET
Jashar Erebara
Nga: **MIMOZA EREBARA** - FAQE 18
Kadri Demiri
Nga: **MEVLUD BUCI** - FAQE 19

Stop sulmit shtetëror ndaj Dibrës së Madhe: Tkurren trojet dhe grabiten ujërat e lumit Radikë

Ujërat e Radikës në Strasburg

“Ne, dibranët, do t’i luftojmë këto çështje dhe këto padrejtësi me të gjitha mjetet e mundshme paqësore e demokratike, do t’i drejtohemi së fundit edhe Gjykatës së Strasburgut për t’i mbrojtur dhe për t’ia kthyer lumin Radikë dhe këto bukuri Dibrës së Madhe”

Nga **Prof.Dr.Inxh.ABDYL KOLECI**

Dibranët e Dibrës së Madhe janë shumë të shqetësuar për shfrytëzimin pa kriter dhe të papërgjegjshëm të përrenjve dhe të ujit të lumit Radikë për ndërtimin e liqenit të Mavrovës që tashmë është ndërtuar, uji i të cilit derdhet në lumen Vardar, në anën e kundërt të rrjedhjes natyrore, si edhe të planit për ndërtimin e minihidrocentraleve të tjerë, të cilët ujin e lumit Radikë do ta përshkojnë nëpër tunele dhe do ta derdhin sërish në lumin Vardar, duke e devijuar rrjedhjen normale të lumit Radikë dhe duke e prishur ekosistemin e kësaj zone të virgjër natyrore, pa e konsultuar fare popullatën e këtushme.

Sjelljet e shtetit me Dibrën e Madhe i ngjan sjelljes sikur me pronën pa pronar. Vendimi për ndërtimin e HC Spila dhe të liqenit artificial te Dibra e Madhe është marrë në vitet e 60-ta, ndërsa punimet kanë përfunduar në vitin 1969. Me ndërtimin e digës së këtij liqeni artificial u mbulua edhe Fusha e Udovës me sipërfaqe prej 1340 hektarë tokë pjellore e klasit të parë, përndryshe hambari i Dibrës së Madhe, ku qyteti me rrethinë siguronte bukën e gojës dhe mirëqenien e vet. Në këtë fushë tepër pjellore prodhoheshin rendimente të larta të drithërave, si misri, gruri, elbi, thekëri, por edhe patatet, specat, domatet, lakra dhe ku rriteshin edhe shumë pemë frutore cilësore si arra, mollë, dardhë, kumbulla, hardhi etj.

Në Fushën e Udovës prodhohej gjer në 30 tonelata patate në një hektar, ndërsa nga varietetet e prodhuara sasi të konsiderueshme edhe eksportoheshin. Me mbulimin e Fushës së Udovës nga liqeni artificial i HC Spila, tashmë Dibra e Madhe është e detyruar që t’i importojë nga jashtë prodhimet e sipërpërmendura, sepse pjesa tjetër e tokës së punueshme tashmë shumë vite ka mbetur pa ujë dhe nuk prodhon asgjë.

(Lexoni në faqen 3)



Radika takon liqenin pasi kalon fshatin e Kosovrast. Në sfond, Ura e Mulliçanit. Kjo pamje nuk mund të fotografohet më në vitet e ardhshme, në qoftë se ndërpriten ujërat e lumit Radika
© Foto: Gazmend Kërkuti

- Ekziston një marrëveshje ndërshtetërore mes Maqedonisë dhe Shqipërisë që nga diga e liqenit artificial të HC Spila të Dibrës së Madhe në drejtim të Shqipërisë duhet të derdhen nga 45 metra kub ujë në sekondë, gjë që nuk ndodh as për së afërmi dhe më është e çuditshme se pse Shqipëria nuk interesohet për këtë çështje.
- Sulmi tejet dëmprurës i është bërë Dibrës së Madhe edhe me ndarjet territoriale, ku janë krijuar komunat Qendra Zhupë dhe Mavrovë - Rostushë, duke e tkurrur territorin dhe popullsinë e Dibrës së Madhe. Kështu që, Dibra e Madhe sot ka mbetur me 20 mijë banorë dhe me territor prej 145 kilometra katrorë.
- Kaloi gati gjysëm shekulli që Dibra e Madhe dhe dibranët as nga toka dhe as nga hidrocentrali Spila nuk kanë asnjë përfitim. Ky është edhe shkaku kryesor që i detyroi dibranët nga viti 1969 të emigrojnë masivisht për në SHBA, në kërkim për të siguruar bukën e gojës.

cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (71). 1 - 31 Mars 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Avni Alcani, Hysen Likdisha, Destan Rama se shkrimet e tyre jane planifikuar për numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Abdyl KOLECI
Xhafer MARTINI
Ali HOXHA
Rexhep TORTE
Bashkim RAMA
Abdurahim ASHIKU
Haki KOLA
Bedri TAHIRI
Beqir SINA
Armond DURAKU
Sakip CAMI
Naim PLAKU
Xhelal ZEJNELI
Haki PËRNEZHA
Hajredin TOCA
Mimoza EREBARA
Sokol ÇOBO
Mevlud BUCI
Kastriot CAKA
Ilmi DERVISHI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

KROMI NË BULQIZË

Koncesioni, si u anashkalua Kuvendi

Ministria e Ekonomisë rinovoi koncesionin në muajin gusht 2009, pas zgjedhjeve të përgjithshme

Nga: **SOKOL ÇOBO**



Ministria e Ekonomisë ka anash kaluar Kuvendin e Shqipërisë për dhënien e koncesionit për minierën e kromit në Bulqizë. Prokuroria e Tiranës dyshon se zyrtarët e ministrisë në vitin 2009 kanë shkelur ligjin për dhënien e koncesioneve, pasi të drejtën ekskluzive për këto procedura e kishte Kuvendi dhe jo ministria (sipas ligjit të 2009-s). Hetimet po zhvillohen nga Njësia Task-Forcë, e cila ka gati vendimmarrjen për këtë çështje, ku nuk përjashtohet që të ngrihet akuzë ndaj disa personave. Ditët e fundit, çështja është diskutuar edhe në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila saktëson se letër-porositë e ardhura nga Italia dhe Austria janë përkthyer dhe i janë bashkëngjitur fashikujve hetimorë.

Historia e koncesionit

Sipas burimeve nga akuza qendrore, procedimi penal vijon të jetë pa emër personi të hetuar, megjithëse gjatë diskutimeve të fundit do të vendoset nëse kjo çështje do të kalojë apo jo në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga hetimet e deritanishme ka rezultuar se kompania DARFO ka fituar koncesionin e kromit para vitit 2005. Në këtë hark kohor, pra gjatë viteve 2005-2009, kompania ka pasur probleme dhe nuk ka përmbushur detyrimin për të hapur vende pune, për të investuar apo për të shtuar sigurinë në galeritë e kromit. Sipas prokurorisë, koncesioni është vënë në pikëpyetje dhe në vitin 2009, kompania, duke qenë në "presion", ka paraqitur dokumentacion për rinegocimin e kushteve. Megjithëse kompania shkruante se kishte "probleme", duke parë edhe inventarin e fitimeve, kompania ka "gjetur" paratë dhe ka premtuar se do të hapnin vende pune, apo do të investonin në galeritë e kromit, me qëllim për të rritur kushtet e sigurisë. Shoqëria ka kërkuar që të fitonte sërish koncesionin dhe ka paraqitur kërkesë pranë Ministrisë së Ekonomisë.

Hetimet nga prokuroria

Njësia Task-Forcë në Prokurorinë e Tiranës ka nisur një hetim të plotë për dhënien e koncesionit të kromit në Bulqizë, pasi kishte dyshime se firma fituese ishte paracaktuar apo se Ministria e Ekonomisë kishte shkelur ligjin. Në fokusin e oficerëve të policisë gjyqësore ishte mënyra e dhënies së koncesionit nga ministria dhe krahasimi me procedurat ligjore "për dhënien e koncesioneve", ligji në fuqi që ishte në vitin 2009. Sipas këtij dispozitivi, koncesioni jepej nga Kuvendi (ligji në vitin 2009, pasi më pas, ai përcaktonte se koncesionet i jepte qeveria), ndërsa dyshohet se Ministria e Ekonomisë nuk e ka "pyetur" Kuvendin për dhënien e kësaj "leje". Zyrtarët e ministrisë, në vitin 2009, kanë rinegociuar kushtet e koncesionit me firmën DARFO, që më vonë mori emrin ACR. Pretendimi i Ministrisë së Ekonomisë ka qenë se "koncesioni është dhënë në muajin gusht 2009 dhe në këtë kohë, Kuvendi ka qenë pushim". Megjithatë, akuza saktëson se koncesioni vërtet është dhënë në muajin gusht, në një moment që Parlamenti nuk ishte mbledhur pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009, por ligji përcaktonte se ky koncesion kalon në Parlament.

Letër-porositë në Itali dhe Austri

Prokuroria ka përkthyer letër-porositë e ardhura nga Italia dhe Austria. Në to pasqyrohen të gjitha ndryshimet e bëra në kompaninë DARFO në pesë vitet e fundit. Ka rezultuar se gjatë vitit 2009, kompania kishte probleme të mëdha ekonomike dhe ka dalë në shitje. DARFO është blerë nga disa investitorë austriakë që kanë investuar për të mbajtur degët e firmave. Prokuroria thotë se edhe paratë e "premtuara" për t'u investuar në Shqipëri, në galeritë e kromit në Bulqizë, kanë ardhur nga investitorët austriakë që kanë marrë pronësinë e shoqërisë. Akuza vijon se ka zbardhur të gjitha ndryshimet e kapitaleve të kompanisë. Ndërkohë edhe letër-porosia e ardhur nga Austria bën fjalë për paratë e investuara në kompaninë DARFO dhe transaksionet e kësaj firme në degën e saj në Shqipëri. Grupi hetimor saktëson se tashmë çështja është në diskutim, nëse do të hetohet në Prokurorinë e Tiranës apo në Prokurorinë e Përgjithshme.

(2012-03-29 gazeta-shqip.com)

BULQIZË, SEKUESTROHEN 400 TON KROM

Policia e Bulqizës ka sekuestruar rreth 400 ton krom, që po transportohej pa u shoqëruar me dokumentet përkatëse. Ndalimi është bërë në pjesën jugore të minierës së Bulqizës, në Zonën D, e cila njihet pjesa si më problematike për sa i përket informalitetit. Burime nga policia lokale, bëjnë të ditura se do vazhdojnë kontrollet për të shmangur çdo mundësi e mënyrë për korrupsion apo për vjedhje të pasurisë kombëtare, në zonën krommbajtëse të Bulqizës. Kontrollet e policisë të nisura që nga fundjava e kaluar, deri më tani kanë pasur në fokusin e tyre kryesisht kontrollin e makinave të transportit të mineralit.

20 mars 2012 (gazeta-shqip.com)

ASFIKSOHEN NË GALERITË E KROMIT DY MINATORË

Dy minatorë janë asfiksuar dje në mëngjes në galeritë e thella të minierës së Bulqizës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 09:20 në nivelin e 13 të pusit nr.2 që administrohet nga kompania ACR. Destan Koxha, 47 vjeç, dhe Ymer Konezha, 57 vjeç kanë shfaqur shenja dobësie deri në asfiksim të plotë sapo kanë nisur punën për pastrimin e frontit. Kolegët i kanë nxjerrë në sipërfaqe dhe i kanë dërguar me urgjencë drejt spitalit të Bulqizës. Mjeku Shahin Kaja, tha se minatorët kishin dhembje të forta koke dhe ulje të tensionit arterial, por ishin jashtë rrezikut për jetën. Një specialist i vjetër i minierës tha se ngjarja mund të kishte ndodhur për shkak të ajrimit të pamjaftueshëm në frontin e punës, por një grup pune që ka nisur hetimet, do të përcaktojë çfarë ka ndodhur realisht. Kompania ACR, ende pa dalë konkluzionet e hetimeve, e ka përjashtuar mungesën e ajrimit në galeri, duke i konsideruar problemet shëndetësore të minatorëve "për shkak të lodhjes apo një dobësie të çastit, që në ambientet e nëntokës ndihet edhe më shumë." *2012-03-27 (gazeta-shqip.com)*

ZBULOHET SHEMBJA E MINIERËS SË KROMIT

Shembja e një galerie minerare në zonën D të Bulqizës ka rikthyer ankthin dhe frikën në këtë qytet. Dy ditë më parë, specialistët e nëntokës konstatuan se një minierë private në këtë zonë ishte fundosur plotësisht. Edhe vite më parë specialistët e minierave janë shprehur se nëntoka e Bulqizës është një zgavër e rrezikshme dhe se shembjet do të jenë të pranishme. Inxhinieri i njohur, Jorgo Kola, në shumë raste ka deklaruar se shfrytëzimi pa kriter i nëntokës mund të sjellë pasoja të paparashikueshme në zonën mineralmbajtëse të Bulqizës. Rasti i parë ka të bëjë me cedimin e tokës mes dy lagjeve në Bulqizë. Fusha e Vajkalit, siç bulqizakët e quajnë fushën mes Qytetit të Ri dhe Qytetit të Vjetër, ka pësuar një rënie rreth 6 metra nga niveli i mëparshëm. Ky cedim ka sjellë dëme materiale në disa objekte shtetërore dhe private, ndërsa vetë fusha është shndërruar prej më shumë se një dekade në një liqen, ku çuditërisht në stinën e verës banorë të Bulqizës dalin të gjuajnë peshk. Prej vitit 1968, specialistët e minierave kanë parë se toka mes dy lagjeve të qytetit po lëvizte. Në vitin 1995, specialistët e gjeologjisë kanë konstatuar cedimin e parë, por ulja më e madhe e kësaj fushe është regjistruar në vitet 1996-2000. Rasti i dytë regjistrohet vetëm dy ditë më parë. Tani, pikërisht pas reshjeve të papara të borës, regjistrohen të tjera cedime dhe shembje. Në zonën D, një minierë kromi është shembur totalisht dhe të tjera janë në rrezik. Specialistët sqarojnë se kjo shembje ishte parashikuar nga ana e tyre, pasi minierat aktualisht menaxhohen nga njerëz joprofesionistë dhe punimet e kryera nuk kanë synuar jetëgjatësinë e minierës, por shfrytëzimin maksimal të saj. Jorgo Kola ka sqaruar për të disatën herë se shpëlarja e grimcave aluvionale ka shkaktuar shkëputjen e lidhjeve mes masës shkëmbore e për rrjedhojë shembjen e minierave. Me siguri ndikim ka pasur dhe pesha e madhe e borës mbi galeritë, pasi hapësirat e tyre nuk kanë siguruar më lëndë drusore apo profile metalike. ***Hasan Pasha / Gazeta Panorama/23-03-2012***

Ne, dibranët, do t'i luftojmë këto çështje dhe këto padrejtësi me të gjitha mjetet e mundshme paqesore e demokratike, do t'i drejtohemi së fundit edhe Gjykatës së Strasburgut për t'i mbrojtur dhe për t'ia kthyer lumin Radikë dhe këto bukuri Dibrës së Madhe.



Stop sulmit *shtetëror* ndaj Dibrës së Madhe

Tkurren trojet dhe grabiten ujërat e lumit Radikë

Nga **Prof.Dr.Inxh.Abdyl KOLECI**



Radika takon liqenin pasi kalon fshatin e Kosovrast. Në sfond, Ura e Mulliçanit. Kjo pamje nuk mund të fotografohet më në vitet e ardhshme, në qoftë se ndërpriten ujërat e lumit Radika © Foto: Gazmend Kërkuti

Dibranët e Dibrës së Madhe janë shumë të shqetësuar për shfrytëzimin pa kriter dhe të papërgjegjshëm të përrenjve dhe të ujit të lumit Radikë për ndërtimin e liqenit të Mavrovës që tashmë është ndërtuar, uji i të cilit derdhet në lumen Vardar, në anën e kundërt të rrjedhjes natyrore, si edhe të planit për ndërtimin e minihidrocentraleve të tjerë, të cilët ujin e lumit Radikë do ta përshkojnë nëpër tunele dhe do ta derdhin sërish në lumin Vardar, duke e devijuar rrjedhjen normale të lumit Radikë dhe duke e prishur ekosistemin e kësaj zone të virgjër natyrore, pa e konsultuar fare popullatën e këtushme.

Sjelljet e shtetit me Dibrën e Madhe i ngjan sjelljes sikur me pronën pa pronar. Vendimi për ndërtimin e HC Spila dhe të liqenit artificial te Dibra e Madhe është marrë në vitet e 60-ta, ndërsa punimet kanë përfunduar në vitin 1969. Me ndërtimin e digës së këtij liqeni artificial u mbulua edhe Fusha e Udovës me sipërfaqe prej 1340 hektarë tokë pjellore e klasit të parë, përndryshe hambari i Dibrës së Madhe, ku qyteti me rrethinë siguronte bukën e gojës dhe mirëqenien e vet. Në këtë fushë tepër pjellore prodhoheshin rendimente të larta të drithërave, si misri, gruri, elbi, thekëri, por edhe patatet, specat, domatet, lakra dhe ku rriteshin edhe shumë pemë frutore cilësore si arra, mollë, dardhë, kumbulla, hardhi etj.

Në Fushën e Udovës prodhohej gjer në 30 tonelata patate në një hektar, ndërsa nga varietetet e prodhuara sasi të konsiderueshme edhe eksportoheshin. Me mbulimin e Fushës së Udovës nga liqeni artificial i HC Spila, tashmë Dibra e Madhe është e detyruar që t'i importojë nga jashtë prodhimet e sipërpërmendura, sepse pjesa tjetër e tokës së punueshme tashmë shumë vite ka mbetur pa ujë dhe nuk prodhon asgjë. Shpronësimi i Fushës së Udovës të mbuluar me ujë ndaj bujqve dibranë ishte shumë i lirë, thënë simbolikisht një metër katror tokë pjellore u pagua me çmimin e një akulloreje, çmim që sot e kësaj dite shumë bujq dibranë edhe nuk e kanë marrë.

Kjo tokë pjellore u mbulua me ujë dhe kjo pasuri e dibranëve u humb për jetë të jetëve. Kaloi gati gjysmë shekulli që Dibra e Madhe dhe dibranët as nga toka dhe as nga hidrocentrali Spila nuk kanë asnjë përfitim. Ky është edhe shkaku kryesor që i detyroi dibranët nga viti 1969 të emigrojnë masivisht për në SHBA, në kërkim për të siguruar bukën e gojës.

Çka është edhe më e keqja, edhe pse është dashur që HC Spila t'i sigurojë ujë fushës së Dibrës së Madhe, kjo çështje ka arritur deri në Parlamentin e Maqedonisë, por për fat të keq një obligim apo marrëveshje e tillë nuk është arritur. Ujitja e tokës bujqësore të Dibrës së Madhe me sistemin e motopompave ka funksionuar pjesërisht, sepse bujqit dibranë për shkak të çmimit shumë të lartë të harxhimeve të ujitjes si rezultat i pagesës së energjisë elektrike. Edhe po ta shisnin tërë bereqetin e prodhuar, bujqit dibranë nuk mund t'i mbulonin këto harxhime të ujit ku me motopompa merreshin 1.2m3 ujë \sek.

Para se të mbulohej Fusha e Udovës nga liqeni artificial i HC, nga lumi Radika me rrjedhje të lirë merreshin 2m3 ujë në sekondë dhe vaditeshin tokat e punueshme në fshatrat Taranik, Bohmovë, Kojnjarë e gjer në fshatin Sollokiç, ku edhe sot e kësaj dite janë të pranishme vijat e ujitjes. Tashmë edhe kjo pjesë e tokës ka mbetur pa ujë dhe askush nuk po i dëgjon kërkesat e bujqëve të këtyre fshatrave.

Ky ishte edhe një ndër shkaqet që sollën shpërnguljen fillimisht të fshatrave Taranik dhe Bohmovë, e më pastaj edhe të fshatrave Kojnjarë dhe Sollokiç. Duhet përmendur se fshati Kojnjarë u përmbyt nga ujërat nëntokësorë që dolën nga liqeni artificial i HC Spila, me ç'rast këtyre fshatarëve iu dha një ndihmë e vogël sa për të ndërtuar një shtëpi të vogël në Dibër të Madhe dhe asgjë tjetër. Ndërkaq fitimet e hidrocentralit Spila janë kolosale kundrejt prodhimeve bujqësore. Bile, pse të mos ceket edhe fakti se, shteti në këtë hidrocentral punësoi afër 90 persona pjesëtarë të komunitetit maqedonfolës dhe vetëm 9 shqiptarë.

Para se të ndërtohej Liqeni i HC Spila të gjitha prodhimet bujqësore ishin ekologjikisht të pastra, ndërsa pas vënies në funksionim të HC Spila u prish edhe ekosistemi natyror që ndikoi të paraqiten edhe sëmundjet e drurit të gështenjës, por edhe perimet sot nuk mund të prodhohen pa pesticide.

Është shumë me rëndësi të theksohet se në vitin 1953 në luginën e Mavrovës por në terren të tokave dibrane u ndërtua liqeni i Mavrovës ndoshta më i rralli në botë në lartësi mbidetare rreth 1700-1800m. Këtu duhet ngritur pyetja se kush ia dha atë të drejtë shtetit të atëhershëm Jugosllav që 70% të sasive së ujit të lumit Radikë, i cili buron në majat e bjeshkëve të Korabit ku e tërë kjo sasi e ujit të pijshëm e të pastër si loti, lumi Radikë konsiderohet lumi më i pastër në Europë e më gjerë, nëpërmjet tunelit e tubacioneve mbushi liqenin artificial të Mavrovës dhe prej aty shfrytëzohet për hidrocentralin e Vrutokut dhe derdhet në lumin Vardar jashtë të gjitha rregullave dhe parametrave natyrorë.

Kjo ka ndikuar që të prishet tërë sistemi ekologjik nga burimi i lumit Radikë e gjer në digën e liqenit të HC Spila te Dibra e Madhe. Të moshuarit e mbajnë mend se çfarë bukurie të rrallë natyrore kishte kjo zonë në rrjedhjen e lumit Radikë.

Për ndërtimin e segmenteve rrugore me gjerësi prej 5 metrash në gjatësi prej 60 kilometrash në kanionet e lumenjve Radikë dhe Drini i Zi, Qeveria e Maqedonisë në kohën e ish Jugosllavisë, edhe pse ishte e vetmja rrugë e ndërtuar për të lidhur qytetet ndërurbane, e arsyetonte se kjo është bërë që vizitorët e kanionit të Radikës të vozisin më ngadalë për t'i shijuar e përjetuar këto bukuri natyrore.

Përkundër të gjitha këtyre të këqijave tani është duke u përgatitur edhe një projekt tjetër që edhe 70% të ujërave që vijnë nëpërmjet lumit Radikë të përdoren për minicentralet elektrike që pritet të ndërtohen përgjatë lumit Radikë. Insistohet ajo më e keqja që sërish të prishet edhe më shumë eko sistemi i Fushës së Korabit dhe kanionit të Radikës, që edhe kjo sasi e ujit të çohet në liqenin e Mavrovës mandej në hidrocentralin e Vrutokut e mandej të derdhet në Vardar.

Dibranët në vazhdimësi e kanë lutur Zotin për një demokraci të mirëfilltë, që edhe ujërat e Radikës tu kthehen njëherë e përgjithmonë Dibrës dhe dibranëve, sepse Radika është pasuri e Zotit dhe kjo pasuri me shekuj u ka takuar dibranëve që sëbashku edhe me pellgun e Drinit të Zi me rrjedhjen në drejtim të Detit Adriatik.

Ataku tejet dëmprurës i është bërë Dibrës së Madhe edhe me ndarjet territoriale ku janë krijuar komunat Qendra Zhupë dhe Mavrovë- Rostushë, duke e tkurrur territorin dhe popullsinë e Dibrës së Madhe. Kështu që, Dibra e Madhe sot ka mbetur me 20 mijë banorë dhe me territor prej 145 kilometra katrorë.

Ne, dibranët, do t'i luftojmë këto çështje dhe këto padrejtësi me të gjitha mjetet e mundshme paqësore e demokratike, do t'i drejtohemi së fundit edhe Gjykatës së Strasburgut për t'i mbrojtur dhe për t'ia kthyer lumin Radikë dhe këto bukuri Dibrës së Madhe.

Ekziston një marrëveshje ndërshtetërore mes Maqedonisë dhe Shqipërisë që nga diga e liqenit artificial të HC Spila të Dibrës së Madhe në drejtim të Shqipërisë duhet të derdhen nga 45 metra kub ujë në sekondë, gjë që nuk ndodh as për së afërmi dhe më vjen çudi pse Shqipëria nuk interesohet për këtë çështje.

Ne, dibranët, do t'i luftojmë këto çështje dhe këto padrejtësi me të gjitha mjetet e mundëshme paqesore e demokratike, do t'i drejtohemi së fundit edhe Gjykatës së Strasburgut për t'i mbrojtur dhe për t'ia kthyer lumin Radikë dhe këto bukuri Dibrës së Madhe.

Ekziston një marrëveshje ndërshtetërore mes Maqedonisë dhe Shqipërisë që nga diga e liqenit artificial të HC Spila të Dibrës së Madhe në drejtim të Shqipërisë duhet të derdhen nga 45 metra kub ujë në sekondë, gjë që nuk ndodh as për së afërmi dhe më vjen çudi pse Shqipëria nuk interesohet për këtë çështje.

Dibranët do të kërkojë nga organet kompetente shtetërore të Maqedonisë që Drejtoria e HC Spila, me që flitet se ka kaluar nga Dibra e Madhe në Strugë, të kthehet sërish në Dibër të Madhe. Dibranët do të kërkojnë gjithashtu që edhe shumë kompetenca të gjyqësorit nga Gostivari, si edhe kompetencat e Drejtorisë së të hyrave publike të kthehen sërish në Dibër të Madhe. Pa realizimin e këtyre kërkesave Dibra e Madhe nuk do ta ketë funksionalitetin dhe dinjitetin e merituar si qytet me histori të gjatë e të begatë administrative e kulturore.

Rruga e Arbërit nr. 71
sociale

Dibër e Madhe - Takim i ish të burgosurve dhe të persekutuarve politikë shqiptarë të Maqedonisë



Qeveria e ish Jugosllavisë dhe kjo e Maqedonisë në projektet e tyre kanë dashur e duan edhe sot që njëjtë si Krahinën e Dibrës të ndarë në dysh nga viti 1913, duan ta shkatërrojnë edhe qytetin e Dibrës së Madhe ta shndërrojnë në një fshat. Po pse ndodh kjo? Kjo ndodh për arsye se qyteti jonë si një nga qytetet më të ngritura intelektualisht dhe me një vetëdije të lartë kombëtare do të ishte pengesë dhe ferë në sy për planet asimiliuese...

"Për të drejtat tona ta padisim shtetin"

Nga: **REXHEP TORTE**

Në kërkim të gjetjes së mundësive për të realizuar të drejtat e tyre legjitime ish të burgosurit dhe të persekutuarve politikë shqiptarë në Maqedoni janë duke mbajtur një sërë takimesh nëpër qytete. Takim i këtillë u mbajt edhe në Dibër më 16 mars të këtij viti.

Shpëtim Pollozhani, kryetar i Shoqatës së ish të Burgosurve e të Persekutuarve Politikë Shqiptarë në Maqedoni, para të pranishmëve, tha se, " Kemi një barë të rëndë për ta lëvizur nga vendi, por nga vendosmëria e jonë varet se sa do të fitojmë. Që të jetë aksioni ynë i suksesshëm, shtetin duhet ta padisin më së paku 1000 të persekutuar dhe të burgosur politik. Duhet organizuar edhe një proteste para Parlamentit të Maqedonisë, ku do të duhej të merrnin pjesë mbi 2000 ish të burgosur e të persekutuar politikë shqiptarë, që do të ndikonte t'i lëvizim gurët nga vendi. Ne si Shoqatë kemi pasur qindra takime me përfaqësues të institucioneve dhe delegacioneve ndërkombëtare dhe gjetani asgjë nuk ka lëvizur nga vendi.

Shfrytëzoj rastin të përshëndes nismën e kryeministres daneze Helle Thorning-Schmidt, dhe njëkohësisht Danimarkën, kryesuesen me Bashkimin Europian në 6 muajt e ardhshëm.Z.Thorning, pat deklaruar se në fokus të veprimtarisë së saj në krye të BE do të jetë aktiviteti i shtuar sa u takon të drejtave dhe lirive të njeriut në politikën e jashtme të BE.Përshëndesim paralajmërimin e emërimit të përfaqësuesit të posaçëm të BE për të drejtat e njeriut, dhe përgaditjen e planit të aksionit deri në fund të kryesimit danez. Edhe Qeveria e Maqedonisë e ka përshëndetur këtë nismë dhe ka premtuar se , ,do ta japë si gjithnjë kontributun e saj,, në drejtim të vlerave të saj demokratike dhe të respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut". Mendoj se përfaqësuesit e BE në vend janë të informuar për aktivitetet e Shoqatës sonë. Shpresojmë të shohim a do të reflektojnë me ndonjë ftesë per takim me përfaqësues të Shoqatës.

Problemi i jonë është problem politik dhe ai duhet të zgjidhet politikisht. Nuk është i zgjidhur problemi në rast se 10 ose 20 ish të burgosur e kanë zgjidhur problemin e vet, bile ky është edhe qëllimi i pushtetit, t'i zgjidhë problemet individuale dhe jo ato kolektive. Për zgjidhjen e problemeve kolektive ne kemi përfaqësues në legjislativin e vendit, por gjithashtu jemi dëshmitarë të kapacitetit të tyre profesional dhe intelektual.

Ne do ta padisim shtetin për arsye të moszgjidhjes të këtij problemi, mirëpo në rast se Qeveria dhe Parlamenti fillojnë një procedurë, me garanca serioze të faktorit ndërkombëtar, se do ta zgjidhin problemin, ne mundemi ta ngrimë për një kohë Padinë.

Qeveria dhe Parlamenti seriozitetin e punës të vetë do ta tregojnë me atë që do t'I shpallin të pavlefshme të gjitha vendimet për persekutime politike t ëish sistemit komunist të RSF Jugosllavisë, ose forma tjetër e mundshme do të ishte marëveshja politike, sipas të cilës do të hartohej një rregullore, e cila do të rregullonte nivelin, formën dhe mënyrën e çdëmtimit (shembull i shkëlqyeshëm është rasti i Shqipërisë). Çdëmtimi i ish të persekutuarve duhet bërë në bazë të dy Rezolutave të Këshillit të Europës për dënim të krimeve të komunizmit-në rast se pranohet krimi duhet të çdëmtohet viktima. Rez.1096 e vitit 1996 për distancim nga e kaluara komuniste dhe Rez.1481 e vitit 1997 për dënim të krimeve të komunizmit. Qeverisë i sugjerojmë të marë për model rastin e Shqipërisë, Sllovenisë, Gjermanisë, Çekisë. P.sh. Sllovenia formoi një këshill, i cili përbëhej nga ish të burgosur dhe anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Sllovenisë. Forma më e mirë e çdëmtimit, duhet të llogaritet në nivelin e të burgosurit pa faj. Ne që nga viti 2005 ua kemi ofruar Ligjin për çdëmtim partive politike shqiptare dhe faktorit ndërkombëtar, mirëpo, deri në ditën e sotme ne nuk kemi marë asnjë far lloj përgjigje.

Na habit fakti, se si është e mundur që BE i dha Pyetësorin Maqedonisë për fillim të negociatave për antarësim (në këtë pyetësor bëhen pyetje për qen mace, lopë, dhen e dhi), dhe nga mbi 1000 pyetje që i kishte pyetësori,nuk e pa të udhës, që t'i bënte qoftë edhe një pyetje Maqedonisë, që do të kishte të bënte me zgjidhjen e problemit dhe statusin e të ish të Burgosurve e të persekutuarve politikë shqiptarë. Dua të theksoj edhe njëherë, se maqedonasit e kanë zgjidhur këtë problem, me padi individuale, ose grupore, për grupe që janë dënuar si të tillë. Një grup i dënuar për të njejtën vepër, ka angazhuar një avokat, i cili e ka ndjekur procedurën (rasti i Metodij Antonov-Çento etj..). Edhe në rastin tonë duhet të ndiqet e njëjta rugë, persona të dënuar si grup mund të angazhojnë një avokat. E gjithë kjo është rezultat i impotencës të përfaqësuesve shqiptarë në Qeveri, dhe nga pasiviteti i jonë si Shoqatë.

Në rast se shtetin e padisin mbi 1000 ish të burgosur dhe të persekutuar politik,dhe në rast të një proteste me mbi 2000 ish të persekutuar dhe të burgosur politikë para Parlamentit të Maqedonisë, vetëm atëherë mund ta zgjidhim këtë problem.

Ne nga ky Tubim do t'i drejtohemi edhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (sekretariatit të saj), që problemi me ish të burgosurit dhe të persekutuarut politikë shqiptarë, të jetë një çështje me prioritet,përndryshe ne si kategori do të dyshojmë në vlerat e mirëfillta demokratike të këtij institucioni.(ne si Shoqatë kemi pasur disa dhjetra takime me përfaqësues të BE në vend dhe i kem informuar për aktivitetet e Shoqatës.

Propozoj një monument....

Duhet themeluar një Këshill për ndarjen i mirënjohjeve,për veprimtarë të çështjes kombëtare me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë të Shqipërisë të Londrës,jo të asaj të Ismail Qemalit,pasi Shqipëria e Ismail Qemalit, kishte përfaqësues dhe nënshkrues nga personalitete të rëndësishëm nga të gjithë vilajetet shqiptare.

Nga ky tubim, do tu kisha bërë apel shqiptarëve të zgjohen nga gjumi, që i futën pushtetarët shqiptarë në të gjitha trojet shqiptare. Të mobilizohemi të gjithë kundër maqinerisë vrastare të Gruevistëve,e cila sa vjen po e shton zullumin.

Kërkojmë nga Republika e Shqipërisë të plotësojë obligimet e veta kushtetuese për shqiptarët jashtë kufijve të saj, njëlloj sikurse këtë e bëjnë të gjithë shtetet që kanë popullatë të vetë jashtë kufijve administrativë", deklaroi Shpëtim Pollozhani.

Bashkim Mashkulli, ish I burgosur dhe kryetar i Degës së Ish të burgosurve e të persekutuarve politikë në Dibër të Madhe, kërkoi që me një minutë heshtje të nderohen të gjithë ish të burgosurit politike shqiptarë që vdiqën nëpër burgjet sllave. Mashkulli pastaj theksoi se, "Shoqata e ish të persekutuarve dhe e të burgosurve politik nga formimi i degës së saj në Dibër të Madhe nisi evidentimin e të gjithë të burgosurve, të dëmtuarve, të pushkatuarve e të internuarve në qytetin tonë.

Në bazë të evidencave tona jo të plota Dibra e Madhe rezulton si qyteti më i persekutuar potikisht dhe më i dëmtuari ekonomikisht.

Qeveria e ish Jugosllavisë dhe kjo e Maqedonisë në projektet e tyre kanë dashur e duan edhe sot që njëjtë si Krahinën e Dibrës të ndarë në dysh nga viti 1913, duan ta shkatërrojnë edhe qytetin e Dibrës së Madhe ta shndërrojnë në një fshat.

Po pse ndodh kjo?

Kjo ndodh për arsye se qyteti jonë si një nga qytetet më të ngritura intelektualisht dhe me një vetëdije të lartë kombëtare do të ishte pengesë dhe ferë në sy për planet asimiliuese të qeverive sllave maqedonase.

Ky qe dhe është shkaku i persekutimeve në qytetin tonë.

Në Dibër të Madhe janë evidente të gjitha kategoritë e dhunës politike, që nga vrasjet në qytet dhe në çdo fshat, burgosjet, përndjekjet dhe shpërnguljet si dhe internimet e familjeve të tëra, që nga foshnjet e djepit deri te pleqtë që i internuan dhunshëm në fshatrat e Velesit dhe të Manastirit nga ku shumë fëmi dhe pleq nuk u kthyen më. Internimet masive vazhduan për 1 vjet e disa muaj.

Në Dibër të Madhe ishte evidente edhe ora policore e natës ku ishte e ndaluar dalja natën dhe çdo kush që shihej natën vritej pa paralajmërim. Për një decenie nga viti 1960 deri 1970 pas perëndimit të diellit nuk mund të lëvizte askush deri në daljen e diellit.

E gjithë kjo dhunë qeveritare nuk e mposhti popullin e Dibrës së Madhe për të ngritur zërin e tij.

Dibranët qenë ata që ishin mësuesit e parë të shkollave shqipe në Maqedoni.

Dibranët qenë ata që reaguan ndaj politikës asimiluese duke themeluar shoqatat kulturore-artistike në qytetet e Maqedonisë. Dibranët qenë ata të cilët ishin inkuadruar edhe në grupet ilegale të kohës, për këto arsye burgjet e Jugosllavisë ishin përplot me dibranë që nga Goli Otoku dhe Idrizova e Shkupit. Të burgosurit dhe të përndjekurit politikë që duhet të ishin sot kategoria më e respektuar e shoqërisë, sepse pa të burgosurit politik nuk do të kishte shkolla shqipe, nuk do të valvitej flamuri shqiptar, nuk do të kishte universitet shqip i cili në themelet e vet ka gjakun dhe sakrificën e kësaj kategorie. Produkt i veprimtarisë politike është ngjarja e marsit të vitit 1981 i cili i gjeti shqiptarët dhe dibranët të organizuar për të kërkuar ndryshimet e kufijve dhe të historisë. Vetëm për pjesëmarrjen në demonstratat e vitit 1981 u dënuan 60 studentë dibranë dhe dhjetra të tjerë u detyruan të emigrojnë për në SHBA. Veprimtaria politike e ish të burgosurve ishte edhe themelimi i UÇK-së në Kosovë në vitet 1997-1999 në luftën e saj për pavarësi që shkon drejt bashkimit kombëtar.

Nga shoqata jonë dolën edhe nismëtarët e luftës së UÇK-së në vitin 2001 në Maqedoni, e cila solli Marrëveshjen e Ohrit për një shtet të barabartë mes sllavo maqedonasve dhe shqiptarëve, të cilën marrveshje Qeveria e Gruevskit e shkoli me dy këmbët. Ish të burgosurit që sot duhet të ishin kategoria e angazhuar në proceset politiko shoqërore, për arsyet e lartpërmendura, sot janë më të diskriminuarit. Për ata dhe familjet e tyre nuk mendon askush. Shumë ish të burgosur janë pa punë, pa pension për arsye se nuk kanë 15 vite stazh pune. Shteti i Maqedonisë edhe sot i kategorizon si të pa përshtatshëm dhe të rrezikshëm, për arsye se ne kemi mbetur si kategori e diskriminuar dhe jo e barabartë.

Edhe sot qytetit tonë me një politikë qëndrore antishqiptare arriti që të mbetet pa institucione të rëndësishme të cilët tashmë kanë kaluar në Tetovë dhe Gostivar. Edhe ujrat e Lumit Radikë po dërgohen në rrjedhën e lumit Vardar, ndërsa drejtoria e HC Spile pretendon të kalon në Strugë. Lufta e Dibrës së Madhe për mbijetesë po vazhdon", tha në fund Bashkim Mashkulli.

Sazan Papraniku, ish i burgosur politik, dha informatën për të gjitha kategoritë e të burgosurve e të përndjekurve politikë shqiptarë në Maqedoni, duke theksuar se, "Shoqata e të Burgosurve e të Persekutuarve Politikë Shqiptarë vepron që nga viti 1992. Si subjekt pranë Regjistrit të organizatave joqeveritare u regjistrua në 10 shkurt të vitit 1999. Pas shumë aktiviteteve, Shoqata në vitin 2005 hartoi një Propozim-ligj për ç'dëmtim dhe kompenzim të gjithë ish të burgosurve dhe të persekutuarve politikë shqiptar në R Maqedonisë.

Propozim ligji i Shoqatës u punua nge juristë më të mirë shqiptarë.Për hartim të këtij propozim ligji,i konsulltuam ligjet e disa ish shteteve të ish bllokut komunist, të cilët që moti e kanë zgjidhur këtë ptoblem. Kompenzim duhet të bëhet në të holla (kompensimi për një ditë burg të bëhet në nivelin e kompensimit të të dënuarit pa faj), me prona të shtetit, me letra me vlerë, me troje ndërtimi, me shtëpi, banesa, kredi, kompensim të përvojës të punës dhe disa mundësi të tjera që i posedon shteti.

Propozim- ligjin ua kemi dërguar të gjithë përbërjeve parlamentare që nga viti 2005. Propozim- ligji u është dorrëzuar edhe shumë faktorëve shumë të rëndësishën në vend. Fatkeqësisht, asnjë subjekt politik shqiptar deri tashti, nuk e pa të udhës që Propozim- ligjin e Shoqatës, ta parashtrojë në diskutim, pranë Komisionit parlamentar për Sistem politik pranë Parlamentit të R.M, dhe as në ndonjë seancë të Parlamentit.

Duke e marë parasysh faktin se, përfaqësuesit politikë shqiptarë, nuk e panë të udhës që ta zgjidhin këtë

arsim

Shoqata Atdhetare Dibra festoi 7 Marsin ditën e Mësuesit dhe 8 Marsi festën e Nënave

Festë për mësuesit dhe nënat përplot me suksese të dibranëve në Amerikë


© Foto: www.dibra.us

BEQIR SINA, New York

STATEN ISLAND - NYC : Festat e 7 dhe 8 Marsit, por dhe 15 vjetori i Shoqatës Atdhetare "Dibra" është festuar mbrëmë në ishullin e "dibranëve" në qytetin e New Yorkut - Staten Island, me një spektakël, që zgjati disa orë, mbushur plot me këngë e valle, dhe fjalime kushtuar këtyre dy datave të shënuara. Mbrëmja festive, këtu ku jeton një komunitet i konsiderueshëm dibranësh, i pesti për nga madhësia numerike, mes shumë etnive që e karakterizojnë këtë qytet tipik amerikan, mblodhi qindra vetë, kryesishtë familjet dibrane, të emigruara në periudha dhe rethana të ndryshme.

Mbrëmja festive për nder të 7 Marsit ditën e Mësuesit dhe 8 Marsin festën e Nënave, u organizua dje në mbrëmje, në mjediset e lokalit luksoz "The Vanderbilt" në Father Capodanno Blvd - Staten Island, nga Shoqata Atdhetare Dibra. 7 Marsi dita e Mësuesit dhe 8 Marsi festa e Nënave, është bërë, nga dibranët në Amerikë, "festa e Dibranëve" të cilët e kanë këtë festë një nga veprimtarit kulturore të përvitshme. Ky manifestim tradicional në këtë komunitet tash sa vjet çmohet si përpjekje e bashkëpunimit të veprimtarive dibrane që mbështesin dhe festojnë në Shtetet e Bashkuara, edhe ngjarjet dhe datat më të rëndësishme kombëtare.

Shoqata Atdhetare Dibra, për çdo vit feston 28 Nëntorin 1912 ditën e Flamurit - Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, ditën kur Kosova u shpall e pavarur dhe ditë të tjera me karakter kombëtare. Këto ngjarje të mëdha kombëtare, kan ndërgjegjësuar bashkëatdhetarët tanë, për të u mbeldhur së bashku, por edhe mbështetur edhe kontribuar, për Dibrën, në radhë të parë, por edhe Kosovën dhe çështjen shqiptare, duke ju bashkëngjitur bashkësisë shqiptare, organizatave dhe shoqatave të tjera në të gjitha veprimtarit e saj në komunitet.

Në këtë mbrëmje festive, përmes ekraneve të televizionit, u përcollë dokumentari i Shoqatës Atdhetare Dibra, ku tregohet se të gjithë kështilltarët e kësaj shoqate kanë vendosur që çdo njëri prej tyre të dhurojë sipas mundësisë (kush sat ë dojë)një shumë të hollash të cilat do t'ju dhurohen shkollave fillore Vllazërim Bashkim dhe Said Najdeni në formën e një ngrënje, kryesisht mëngjesi, me qëllimin e vetëm që fëmijët dibran nga klasa e parë deri në të pestën të mos ndjejn mungesën e ushqimit gjatë qëndrimit të tyre në ambientet shkollore.

Në dokumentarin televizivë, thuhej se ky projekt filloi te realizohet që më 20 Shkurtë, ku çdo ditë të ndrimit të parë, fëmijëve nga klasa e parë deri në pestën , pa marë parasysh se në çfarë gjuhë zhvilohet mësimi, u ndahen racione të ushqimit të mëngjesit. Kryetari i SHAD-it, Ilir Rusi, tha se kjo bëhet me qëllim: "Për të mos ua bërë monotone fëmijëve ushqimin e njëjtë çdo ditë, ne vendosëm që tu jepen ushqime të ndryshme çdo ditë të javës. Një ditë do të kenë kifle me zdenkë, ditën tjetër krosan me djath dhe kos, kifle me aerokrem dhe sok etj etj. Ky donacion, shtojë zoti Rusi nga këshilltarët do të vijoj deri në fund të vitit shkollor 2011-2012 (Qershor). Kuptohet se për ta vazhduar këtë inisiativë që të mbetet afatgjate Shoqata Atdhetare Dibra do të ketë nevojë për donacione dhe sponzorë nga të gjithë kush ka dëshirë të ndihmojë".

Mbrëmjen festive për nder të 7 dhe 8 marsit me përgjegjës të skenarit Muharrem Shehu dhe Dritan Klloboçishta, arketar Ago Maqellara dhe sekretar/administratori Adriatik Pilku, e udhëhoqi këngëtari i mirënjohur dibran, "bilbili" i këngës dibrane Haxhi Maqellara, i cili këndoi disa këngë së bashku me solistët e Grupit Muzikor "Fisnikët" nga Staten Island. Këtë mbrëmje do ta bënin edhe më të hareshme më këngë e valle nga të gjitha trevat, këngëtarët: Shqipe Kastrati dhe Agron Maqellara.

Mysafir i kësaj mbrëmje spektakel - ishte edhe Lundrim Paçuku, një emër që ka kapluar shumë zemra dhe admirues, i cili u shfaq kohët e fundit si një talent në spektaklin më të njohur për përzgjedhje të talenteve "The Voice of Albania", dhe talenti i mahnitëshëm dibran në Amerikë, 18 vjeçari Bledar Maqellara, tenor, bariton, këngëtar, aktor dhe kërcimtar, i biri i këngëtarit Agron Maqellara.

Bekimin e festës së dibranëve e kreu Imam Omer Papraniku. Shoqata Atdhetare Dibra per nder të 7 Marsit ditës së mësuesit nderojë me një pllakat mirënjohje dy veteranët e arsimit shqip në Dibër të Madhe, mësuesin Xhevat Telqiu, dhe mësuesin Shpëtim Klloboçishta. Ndërkohë, që e përshëndeti këtë mbrëmje festive kryetaria e Shoqatës së Gruas në New York "Zëri Ynë", zonja Leunora Abdullahu, dhe në emër të Klubit Futbollistik Korabi nga New Yorku, Përparim Papraniku. Në fund u luajt edhe loja e fatit, ku "fatëmëdhenjët" fituan përkatësisht një televizot flat 42 inch, një lop top, një aparat fotografik, dhe një shumë parash.

Fjalën kryesore të darkës vjetor për 125 vjetorin e ditës së Mësuesit dhe kremtimin e ditës Ndërkombëtare të Gruas e mbajti kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibra, zoti Ilir Rusi.

7 Marsin tha kreu i dibranëve e kujtojmë me respekt të thellë për mësuesit dhe rilindasit e parë shqiptarë të cilët na e lanë amanet gjuhën shqipe, të cilën e flasim tani. Mësuesit - prindërit tanë të dytë, u sakrifikuan me vite të tëra, andaj shprehim falënderimin për gjithçka që bënë për ne, për durimin që kishin dhe për tërë diturinë që mbollën në ne.Të gjithë atyre që punuan dhe punojnë në mësimdhënie, ua urojmë Ditën e mësuesit.Gëzuar të gjithë edukatorëve, mësuesve, arsimtarëve dhe profesorëve!

Sikurse edhe edhe 8 Marsi festa më domëthënëse për Gratë Shqiptare pra Nënave tona kudo që janë ato punojnë , jetojnë edhe mesojnë sot, theksoi zoti Rusi.

Një ditë që mbart respekt,dashuri të pafund, e ka quajtur Rusi 8 Marsin, për ato që na dhanë jetë nga jeta e tyre.Për ato që natën e bënë ditë dhe na mëkuan me qumësht nga gjiri i tyre. Për ato që gjenden pranë sado larg që të jemi ,sa herë zemrat tona dëshperohen,sa here shpirtrat tanë rënkojnë.

Duke shtuar se për atë krijesë të Zotit,mbushur me kaq dashuri,me kaq miësi.Ndaj sot në këtë ditë të shënuar të mbështesim kokën dhe mendimet tona në prehrin e nënes,në atë prehër ku loti thahet si me magji,dhe brengat dhe trishtimet largohen.Aty ku pastë diell, dritë, paqë, lumturi, qofshin ngahera NËNAT tona.

Gëzuar festën e 8 Marsit për të gjitha NËNAT e botës,për ato më të dhemshurat,më të mirat, më të shtrenjtat, ka thënë ndër të tjera kryetari i Shoqatës Atdhetare Dibra, zoti Ilir Rusi.Më pasë ai bëri një analizë dhe paraqiti një raport vjetor të veprimtarisë së Shoqatës Atdhetare Dibra gjatë kohës që ai ai udhëheq këtë shoqatë. Ai permendi sukseset dhe arritjes e kësaj shoqate dhe bëri thirrje, anëtarëve për bashkëpunim me të gjithë dibranët në komunitet

Ai kujtojë me këtë rast takimin me biznesmenë të komunitetit tonë për të prezantuar projektin për kontributin dhe angazhimin financiar për të blerë, atë që Rusi e quajti "Shtëpinë tonë të re ...," për të cilën kryetari i dibranëve zoti Rusi tha se " unë jam duke iu referuar deri më tani, ndërtimit në të ardhmen i një Qendre Klutruore të Shoqatës Atdhetare Dibra në Staten Island. Ky është objektivi im kryesor, i cili është mbështetur nga bordi dhe atë që unë besoj është arsyeja kryesore ne kemi formuar edhe Shoqatën tonë 15 vjet më parë ..."

"Për të drejtat tona ta padisim shtetin"

problem madhor, Shoqata e të Burgosurve dhe e të Persekutuarve Politikë Shqiptarë,duke u bazuar në shumë akte politike dhe juridike të faktorit të jashtëm dhe të brendshëm, sipas të cilave neve si ish të burgosur dhe të persekutuar politikë na shpallin viktima, na hapin rrugën për ti realizuar të drejtat tona.

Ja se cilat janë ato akte juridike dhe ndërkombëtare që ne na e hapin rrugën për të kërkuar çdëmtim si viktima të ish sistemit komunist.

Në vitin 1996 Asanbleja Parlamentare e Këshillit të Europës, miratoi Rezolutën 1096, me të cilën nga ish shtetet e bllokut komunist, kërkonte ata shtete të distancohen nga e kuluara e tyre komuniste. Në vitin 1997, poashtu Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, e miratoi Rezolutën numër 1481, me të cilën, po nga të njejtët shtete, kërkonte ta dënojnë sistemin dhe krimet e komunizmit. I detyruar nga këto rezoluta, të Këshillit të Europës, Parlamenti i R. Maqedonisë, në vitin 2006, miratoi një rezolutë me të cilën u kërkohej falje viktimave të komunizmit. Poashtu edhe Maqedonia në vitin 2007 miratoi një Rezolutë, me të cilën dënoheshin krimet e komunizmit.

Për realizimin e këtij projekti, në Strugë, në tetor të vitit 2007, Shoqata e të Burgosurve dhe e të Persekutuarve Politikë Shqiptar, dhe shoqata e të Burgosurve Politikë Maqedonas, në patronatin e ish Kryetarit të Parlamentit z.Lubisha Georgievskin organizoi një Konferencë ndërkombëtare dhe miratoi një Rrezolutë, me të cilën dënoheshin krimet e kryer nga ish sistemi komunist. Me këto akte madhore Maqedonia "lau" borxhin ndaj faktorit ndërkombëtar.

Pas gjithë këtyre aktiviteteve dhe rezultateve, ne mundemi të konkludojmë një punë. Në rast se ndokujt i kërkohet falje, për padrejtësinë dhe për krimin që i është bërë, atëherë rezulton se i dëmtuari duhet të ç'dëmtohet. Në këto rrethana të gjithë ish të burgosurit dhe të persekutuarit politikë shqiptarë duhet të çdëmtohen dhe të kompenzohen, materialisht dhe në forma të tjera. Në rast se ka krim atëherë ka edhe viktimë.

Edhe pse ne si shoqatë kemi bërë qindra takime, dhe përpjekje për ta definuar statusin e të burgosurit politik, nuk ia kemi aritur qëllimit, dhe për këtë arsye SHPBPSH ka përgatitur padi kundër Qeverisë të R.Maqedonisë, si trashëgimtare e ish RSF Jugosllavisë, për kompenzim material dhe në beneficione të tjera (pranim i përvojës të punës-stazhit,gjatë kohës të qëndrimit pa punë,kompensim për pasoja psikofizike,etj. etj.etj.) për dënimet dhe persekutimet e ndryshme.

Statusin i burgosur dhe i persekutuar politik shqiptar e kanë të gjithë ata persona që në mënyra të ndryshme janë dëmtuar nga ish pushteti i RSF Jugosllavisë, nga Gushti i vitit 1944-1991.

Gjatë aktiviteteve të Shoqatës në periudhë që pason, duke dashur simbolizim të opinionit shqiptar, ish të persekutuarit dhe të burgosurit politikë shqiptarë.

Ka nisur aktiviteti për informimin dhe sensibilizimin e opinionit për zgjidhjen e këtij problemi. Do të kishim dashur që ne si Kryesi e Shoqatës, ti informojmë ish të persekutuarit dhe të burgosurit politikë, të mobilizohen në dobi të vetvetes dhe të fillojnë me grumbullimin e dokumentacionit, për ta kryer padinë ndaj shtetit për të drejtat e tyre. Ish të persekutuarit dhe të burgosurit që nuk e kanë dokumentacionin përkatës, le ti drejtohen gjyqit që i ka dënuar. Kërkesa bëhet në gjyq me një pullë takse 50 denarë. Ata ish të burgosur, që nuk do t'i gjejnë vendimet e tyre për suspendim nga puna, në gjyqet, të cilët i kanë dënuar, ose vendimet për burgosje, duhet ti drejtohen Arkivit historik të rrethit të tyre. (Struga e ka në Ohër, Dibra në Gostivar, Kumanova në Shkup etj.)

Ne si ish të persekutuarit dhe të burgosurit politikë, do të kemi aqë sukses në aksionin tonë moral dhe praktik, për sa do të jemi konsekuent dhe të vendosor për t'i dalë këtij aktiviteti deri në fund.Urtësia popullore pat thënë: s'bëhet gardhi me një thupër, as dasma me një fyell, pa le më muri me një gur. Gozhda do të mundet të depërtojë edhe në drurin më të fortë, për aqë sa do të jetë forca e çekiçit" u shpreh Sazan Papraniku.

Në fund të këtij takimi u tha se do të përgaditen nga juristë ekspertë modele të kërkesës për çdëmtimin e ish të burgosurve. U apelua që të paraqiten sa më shumë padi individuale dhe më 9 maj 2012, në përvjetorin e Marrëveshjes së Kumanovës që i dha fund ish Jugosllavisë dhe agresionit serb ndaj Kosovës, të marrin pjesë sa më masovikisht në protestën që do të mbahet para parlamentit të Maqedonisë, mbase do ta shtojnë interesimin e përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe të institucioneve shtetërore për çdëmtimin ish të murgosurve dhe të persekutuarve shqiptarç në Maqedoni.

Rruga e Arbërit nr. 71

kujtesë

ELEZ ISUFI
(1861-1924)



"Gjenerali me shajak"

Po japim disa fragmente nga monografia e re për Elez Isufin që ka përgatitur për shtyp shkrimtari Xhafer Martini. Autori edhe në këto fragmente e njeh lexuesin me premisat që u krijuan për t'iu rikthyer edhe një herë figurës së Elez Isufit, por më mirë këtë gjë do ta shikoni kur të lexoni të plotë variantin e ri, që, në krahasim me të parin (1994), ka ndryshime strukturore dhe të përmbajtjes, me qëllim për ta dhënë atë sa më të plotë dhe më të saktë.

Nga: **XHAFER MARTINI**

NË VEND TË HYRJES

Interesimi im për figurën e Elez Isufit ka filluar gjysmë shekulli më parë, me gjurmimin e materiale arkivore e gojore. Më 1980, në gazetën "Ushtima e Maleve", botova një shkrim të gjatë me titull "Gjenerali i veshur me shajak".*) Shkrimi u pëlqye nga lexuesit, sepse ishte i pari për një figurë kaq madhore, por që deri në atë kohë kishte mbetur krejt në hije. Pastaj pak nga pak erdha duke krijuar figurën e plotë të këtij heroi, derisa hartova një monografi të plotë, të cilën më 1989 e dërgova për ta botuar në shtëpinë botuese "8 Nëntori". Por rrodhën ngjarje të tjera që lidheshin me përmbysjen e sistemit. Institucionet e atij shteti pothuaj e pushuan funksionin dhe Shtëpia Botuese "8 Nënëtori" ma ktheu librin për ta botuar në një kohë më të përshatshme. Kjo kohë erdhi në vitin 1993, kur Isa Ndreu me banim në Itali, u interesua pranë Akademisë së Shkencave për të dituar nëse ekzistonte ndonjë dorëshkrim i hartuar për Elez Isufin, dhe, nëse kishte më shumë se një, lutej të zgjidhej më i miri prej tyre. Përgjigjja për Isa Ndreun ishte se ekzistonin dy monografi, paraqitur pothuaj në të njejtën kohë për botim.U bënë reçensa krahasuese dhe monografia ime u zgjodh dhe u botua në vitin 1994 me shpenzimet e z.Isa Ndreu.

Që nga ajo kohë kanë kaluar 18 vjet. Monografia nuk ka qenë e tillë që të plakej në kaq pak vite, por, siç e thashë, ajo është shkruar 20 vjet para se të botohej, kur konceptet dhe formimi im nuk ishin këto që kam sot, kur shumë ndodhi dhe ngjarje shikoheshin me tjetër sy. Kështu, si shembull, unë i kam interpretuar në atë mënyrë që sot nuk më kënaqin dy ngjarje të rëndësishme të historisë sonë: Lëvizjen e Marsit 1922 dhe Revolucion e Qershorit 1924, ku Elez Isufi ka qenë jo vetëm pjesëmarrës, por edhe me rol udhëheqës. Figura e Elez Isufit është shumëdimensionale. Natyra e tij komplekse të bën të mbash parasysh atë që ka thënë Niçe "Për çdo specie njerëzore, që është mbajtur e fortë dhe pranë natyrës, dashuria dhe urrejtja, mirënjohja dhe hakmarrja, mirësia dhe zemërimi, veprimi pozitiv dhe veprimi negativ janë të pandara…" Kësaj figure unë iu ktheva prapë këto dytri vitet e fundit për ta dhënë më të plotë dhe më të vërtetë.

Megjithatë, figura e Elez Isufit nuk është përmbysur; ajo nuk ka ndryshime të theksuara nga varianti i parë. Në këtë variant u është mëshuar më shumë lidhjeve të Elez Isufit me figura të tjera kombëtare, me miq dhe personalitete të ndryshme nga vende të Europës; janë pasqyruar me plasticitet dhe shumanshmëri krijimi i lidhjeve miqësore, ndikimi i politikës në këto marrëdhënie etj. Në këtë monografi Elez Isufi nuk shikohet thjesht si luftëtar i shquar, si komandant i betejave dhe kryengritjeve të popullit të Dibrës, vetëm si strateg, si "gjenerali me shajak", por edhe si politikan, diplomat, filozof e mendimtar, arsimdashës, zot shtëpie, bashkëshort etj. Në këtë variant jepet më mirë rritja ekonomike e shtëpisë së madhe të Ndreve, një shtëpi tipike feudale, ku pushteti dhe autoriteti nuk buronin vetëm nga cilësitë individuale, por edhe nga pasuria, nga ato raporte politike e ekonomike që krijoheshin vetvetiu me të tjerët.Me interes të madh, si pjesë përbërëse e plotësuese e personalitetit të njeriut, është të dimë edhe për qëndrimin e Elez Isufit rreth gjuhës, kulturës, traditës dhe mënyrave se si ajo kuptohej dhe përfytyrohej; qëndrimit rreth rolit dhe figurës së femrës, rreth mënyrës së jetesës etj. Meriton njohje dhe interes mënyra dhe forma sesi ai e kuptonte hapjen me vendet e tjera, deri ku arrinte ballkanizmi dhe europianizimi i tij, deri në ç`masë ishte i aftë për bashkëpunim dhe integrim. Marrja përsipër nga ana ime e ndriçimit të të gjitha këtyre problemeve duke pasur në fokus figurën e Elez Isufit, është detyrë e vështirë për t`u realizuar në shkallën e duhur. Megjithatë, është një nismë që duhet marrë, qoftë edhe për t`i dhënë një dimension të ri mënyrës së kërkimit dhe të thellimit në figurat e së kaluarës.

DIPLOMACIA E ELEZ ISUFIT

Elez Isufi nga shtypi i kohës është cilësuar si diplomat natyral. Diplomacia e Elez Isufit ka dyanshmërinë e saj: marrëdhëniet e brendshme, me politikanët dhe atdhetarët shqiptarë, me popullin dhe parinë vendase, por edhe marrëdhëniet me shtetet dhe me përfaqësuesit e tyre, me të cilët Shqipëria dhe shqiptarët i përplasën dallgët e historisë.

Me Perandorinë Osmane shqiptarët i lidhi pushtimi i gjatë, me shtetet e Ballkanit, si: Serbia, Mali i Zi, Bullgaria e Greqia, i përplasi fqinjësia, me Austro-Hungarinë dhe Anglinë i çuan në marrëdhënie dy Luftërat Botërore. Qëndrimi i Elez Isufit ndaj këtyre shteteve ka qenë i ndryshëm, sepse të ndryshme kanë qenë edhe synimet e tyre ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë. Elez Isufi në këto marrëdhënie me të huajt është nisur më së shumti nga interesat kombëtare, megjithëse ka pasur raste që është sunduar edhe nga interesat personale. Shqyrtimi i këtij problemi në mënyrë të veçantë dhe shterruese, do të ndihmonte për të njohur sadopak talentin diplomatik të Elez Isufit si dhe zbulon anë të ndryshme të personalitetit të këtij njeriu të madh, anë të cilat nuk kanë dalë me plotshmëri në variantin e parë.

* * *

Me Turqinë Elez Isufi ka ndjekur një diplomaci pragmatiste, përfituese, momentale. Ishin vitet e para kur ai la kërrabën e çobanit dhe doli në jetën e gjerë për të kërkuar fat tjetër për veten dhe atdheun. Lidhja me osmanët ishte e detyrueshme. Elez Isufi ishte i varfër. Pa hequr qafe varfërinë, nuk mund të bëje asgjë as për vete, as për atdheun. Elezin në fillim e caktuan derbenxhi, i cili, në krye të një toge ushtarësh osmanë, kishte si detyrë ruajtjen dhe sigurimin e vendeve të rrezikshme, sigurimin e rrugëve dhe vendkalimeve të ngushta nga grabitësit, hajdutët dhe pretarët që në atë kohë ishin të shumtë. Derbenxhinjtë ishin të liruar nga tatimi dhe çdo detyrim tjetër për aq kohë sa këtë detyrë e kryenin mirë, duke dhënë rezultate konkrete. 1)

Në këtë periudhë të jetës dhe të veprimtarisë së tij Elez Isufi kishte për qëllim jo vetëm të pasurohej, por edhe të njihej dhe të krijonte një farë legjitimiteti. Ai nuk ishte pari, as bej dhe as aga. As të parët e tij nuk kishin qenë të tillë. I ati i tij, kur doli nga Sorica e Dardhës për në Lisivalle të Sllovës, mori me vete vetëm një gomar me plaçka. Po Dibra të pyeste nga vjen, kush je? Dibra të kërkonte njeri me tagër, me pasuri. Pa qenë i pasur, nuk të afrohej askush. Në këtë botë nuk të jepet gjëja, ajo duhet rrëmbyer. Format dhe mënyrat janë të ndryshme. Elezi diti të përfitonte nga detyra që kishte, sepse ai i ruante nga të tjerët karvanët e tregtarëve, por jo pa përfituar vetë prej tyre. Mbas disa vjetësh ai kaloi në detyrën e çaushit në postën turke të Trojakut. Në kohën kur erdhi Shefqet Turgut Pasha me ekspeditën e tij ndëshkuese në Shqipëri, nuk kemi të dhëna të sigurta, por, si duket, Elez Isufi bashkëpunoi me të, prandaj në një këngë popullore, sipas Xhelal Ndreut, thuhet:

"Të nandë malet kush e hupi,
Dorgut Pasha, Elez Isufi" 2)

Elez Isufi nuk e pati të vështirë të kalonte në ekstremin tjetër, duke luftuar kundër turqve. Atë do ta shikojmë mëpastaj në udhëheqje të kryengritjeve të njëpasnjëshme që quan në pavarësinë e Shqipërisë

* * *

Në marrëdhënie me Serbinë ai ka qenë luajal dhe për këtë arsye Jeliq, në letrën e tij për "Politikën" e cilëson si njeriun e tyre për një kohë të shkurtër. Jeliq, duke qenë nën ndikimin e politikës shoviniste të Beogradit, nuk mund të kuptonte prirjen dhe shpirtin demokratik të Elez Isufit, i cili aspironte për fqinjësi të mirë me shtetet ballkanike, si një mjet i rëndësishëm për prosperitet kombëtar e më gjerë. Ai shumë herë u ka zgjatur dorën e miqësisë serbëve, duke u thënë se ishte mirë për të dy popujt që të jetonin në paqe dhe miqësi sesa në armiqësi dhe luftë të vazhdueshme.

"Ju jeni ma shumë se ne dhe të fortë, keni ushtri të rregullt dhe armë moderne, keni edhe miq ma shumë se ne e të mëdhenj- i tha ai një herë një gjenerali serb, - por pse i keni të gjitha këto, ne nuk do t`ju përulemi dhe nuk do t`jua lamë atdheun tonë, se asht mundi, gjaku e sakrificat e brezave në mijëra vite.Ju mund të fitoni ndaj nesh dhe të na gjakosni, por edhe ne rehat nuk do t`u lëmë kurrë, edhe ne bukën në fyt do t`ua zëmë. Kur t`i bini në fund kësaj pune dhe kur t`i bani hesapet mirë, do ta shikoni se nuk dilni të fituem as ju.Prandaj ma mirë secili popull të rrijë në vend të vet dhe t`i bëjë ismet asaj që i ka dhanë Zoti. Shikoni kombet e shtetet e zhvillueme, zoti gjeneral, edhe ato janë vra e janë pre me njeni-tjetrin, por tani kanë ra në prehje e saqim, se e kuptuen se vetëm miqësia të le të shijosh jetën e të kapësh rrugën e përparimit. Këtë duhet të bajmë edhe ne Ballkanasit, ne, shqiptarë e serbë, se vendi na merr të dyja palëve."

Këto mendime është për t'i pasur zili çdo burrë shteti sot, në ditët tona. Të thëna nga një malësor i pashkolluar, njëqind vjet më parë, ato marrin vlerë të veçantë, në radhë të parë për të analizuar personalitetin e tij. Nga këto pak fjalë del që Elez Isufi kishte aspirata evropiane, dhe ndonëse në ato kohëra edhe shtetet e Europës kishin konflikte, ai prapë i merr si model për fqinjësi dhe harmoni. Ai na del si një mendimtar dhe filozof i madh kur thotë(ose më mirë lihet të nënkuptohet) se jeta është e shkurtër dhe se ajo duhet shijuar në paqe dhe liri, se Zoti ka krijuar mundësi dhe hapësira për të gjithë. Themelet e paqes Elez Isufi i shikon kur secili, si shprehej ai, rri në shtëpi të vetë, në kuptimin e mosndërhyrjes në punët e të tjerëve. Siç shikohet, ai, me një intuitë gjeniale, qysh në atë kohë kishte, ndonëse turbullt, të projektuar në mendje Europën e Bashkuar. Ballkanit të trazuar i bënte thirrje që të ndiqte rrugën e Europës, me pak fjalë të bëhej pjesë e saj, po ajo gjë që kërkohet sot.

Qeveria e Pashiqit dhe serbët në përgjithësi nuk i kishin mendësitë integruese dhe të fqinjësisë së mirë si Elez Isufi. Ata nuk mund të pajtoheshin kurrë me idenë e një shteti shqiptar. Por, kur u detyruan të pajtohen, këtë shtet e deshën të ishte sa më i cunguar, i varfër, i destabilizuar, që t'i ndizin flakët kur të donin. Dhe kjo, për fat të keq, ka ndodhur gjatë gjithë rrugës së historisë moderne. Srebët, duke qenë të tillë, nuk përpiqeshin ta shikonin dorën e miqësisë që u zgjaste Elez Isufi, por donin ta blinin. Ata nuk lanë mjet pa përdorur për ta bërë të tyrin, domethënë që të shiste interesat e atdheut dhe t'i këmbente ato me poste, grada e pasuri. Nëpërmjet komandës ushtarake të pushtimit, Elez Isufit iu propozua detyra e komandantit të përgjithshëm të forcave shqiptare që nga Ura e Spiles e deri tek Ura e Vezirit. Elez Isufi nuk pranoi.

Ndryshe nga ç'kërkonin serbët prej tij, Elez Isufi kërkonte tjetër gjë prej tyre. Ai i kërkoi ushtarakut të lart serb që Serbia, si shtet fqinj, ta njihte e para Shqipërinë si shtet të pavaruar dhe ta përkrahte në rrugën e saj të vështirë për t'u stabilizuar dhe për të krijuar institucionet. "Ju duhet ta bëni këtë thjesht pse jemi fqinj pse Zoti na ka caktuar që, duam nuk duam ne, të jetojmë në këtë cep të botës bashkë e pranë njeri-tjetrit. Këtë gjë kërkon nga ju edhe Europa, Fuqitë e Mëdha. Propozimet tuaja

Cila është dekorata më e lartë për Eles Isufin dhe të tjerë?

Eles Isuf Ndreu është një figurë e madhe historike, më e madhja për Dibrën dhe një ndër më të mëdhatë për të gjithë Shqipërinë. Kam shkruar për të dhe matem të shkruaj edhe sot në 100 Vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, tash për emigrantët shqiptarë në Greqi. Dëshira për të shkruar për Të më mbushi shpirtin tek lexoja librin "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë" , kujtime historike të Ismail Strazimirit, një figure tjetër dibrane binjak i Eles Isufit që përveç pushkës në tre luftëra të mëdha për popullin shqiptar (lufta kundër pushtuesve osmanë, lufta kundër pushtuesve serbë dhe lufta kundër fashizmit dhe nazizmit) i njohëm më në fund edhe penën e tij të artë.

Kam përpara "Vjetarin statistikor të rrethit të Dibrës 1966" në faqen 196 të të cilit, në "Të dekoruem me urdhrin "Për veprimtari patriotike" , i dyti në radhë, dekoruar me urdhrin "Për veprimtari patriotike" të klasës së Dytë është Eles Isuf Ndreu. Me sa di unë ky Urdhër i është akorduar me rastin e 50 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, 50 vjet më parë.

Ismail Rushit Strazimiri, po në këtë kohë, është vlerësuar me urdhrin "Për veprimtari patriotike" të klasës së Tretë

I ndodhur larg Dibrës dhe Shqipërisë, tash 16 vjet, nuk kam dëgjuar dhe lexuar gjëkundi për ndonjë vlerësim më të lartë për Eles Isufin Ndreun, Ismail Rushit Strazimirin, Dom Nikoll Kaçorrin, Haxhi Vehbi Dibrën (Agolli) dhe figura të tjera që i bëjnë nder Dibrës dhe Shqipërisë e që kanë qenë pjesëmarrës historikë edhe drejtpërdrejt në 28 Nëntorin e Shpalljes së Pavarësisë.

Dua, nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbërit", të më jepet një përgjigje institucionale se çfarë vlerësimesh publike kanë marrë këta kolosë të mëdhenj të pushkës dhe penës dibrane në hapësirën e këtyre 50 vjetëve (1962-2012) ?

Për mua është koha që këta njerëz të marrin vlerësimin më të lartë të kohës sonë. Njëqind Vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë është rasti i fundit për t'i ngjitur Ata në piedestalin e lartë të Nderit dhe Krenarisë së Kombit.

ABDURAHIM ASHIKU

ndaj meje janë pazarllëk dhe bëhen sikur unë të isha pronari Dibrës, por duhet ta dini se Dibra nuk është imja, është e popullit, e Shqipërisë. Në qoftë se Serbisë nuk ia ka njoftë Europa që të ketë të drejta mbi Shqipërinë, atëherë ju lutem mos prishni qetësinë, dhe mos na bini në qafë. Ju rrini në vendin tuaj dhe ne do të rrimë në vendin tonë." 3)

* * *

Marrëdhënie në dobi të interesit kombëtar Elez Isufi ka vendosur edhe me Bullgarinë, posaçërisht me autoritetet pushtuese bullgare gjatë Luftë së Parë Botërore. Elez Isufi bëri çmos që pushtimi bullgar të kalonte me sa më pak dhimbje, sidomos në zonën e Gollobordëas.

Në Luftën e Parë Botërore Austro-Hungaria, për arsye strategjike, pushtoi edhe Shqipërinë. Në Dibër ajo ishte tok me aleaten e saj, Bullgarinë. Kjo e fundit, si hyri në luftë përkrah fuqive qendrore, pushtoi disa toka shqiptare. Sipas marrëveshjes së fshehtë që qeveria bullgare kishte nënshkruar me qeveritë e fuqive qendrore, kufiri bullgar në tokat shqiptare do të niste nga kreshta e malit të Sharit dhe do të vazhdonte gjatë kufirit që parashikohej nga Traktati i Shën Stefanit. 4) Ushtria bullgare në trevën e Dibrës u përhap gjerësisht jo vetëm në Dibrën e Epërme, por edhe në Dibrën e Poshtme me përqëndrime në disa pika me rëndësi strategjike, si: në Topuzaj, Rreth Kale, Selane, Viçisht, Gollobordë deri te Zalli i Okshtunit. Austro-hungarezët, edhe pse ishin aleatë me bullgarët, nuk e shikonin me sy të mirë shtrirjen aq të gjerë të tyre në qarkun e Dibrës. Elez Isufi tashmë ishte njeri i dëgjuar, i legjitimuar nga populli, i pranuar dhe i adhuruar prej tij. Ai kuptonte se edhe nën pushtim mund të bëhej politikë dhe se shumë probleme mund të zgjidheshin pa armë. Kjo mund të arrihej duke u mbështetur tek njëri pushtues kundër pushtuesit tjetër. Bullgarët qysh me traktatin e Shën Stefanit kishin shfaqur ambicien aneksioniste ndaj tokave shqiptare, duke e hequr veten edhe si vëlla i madh në krahinën e Gollobordës ku ka një numër të konsiderueshëm shqiptarësh që flasin një dialekt të afërt me bullgarishten. Me 1 prill 1916 midis Austro-Hungarisë dhe Bullgarisë u nënshkrua një marrëveshje për të përcaktuar qartë një vijë demarkacioni, e cila niste në veriperëndim të Dibrës së Madhe dhe do të zbriste deri në breg të lumit Drini i Zi për të vazhduar në drejtim të kuotës nr. 495(në veri të fshatit Strikçan) dhe për së gjati zallit të Okshtunit, zallit të Rrapunit për të mbërritur tek derdhja e tij në lumin e Shkumbinit. 5) Ushtria bullgare u detyrua të tërhiqej nga Peshkopia dhe zonat që përmendëm dhe u përqëndrua kryesisht në krahinën e Gollobordës. Megjithatë, qeveria bullgare nuk hoqi dorë nga synimi për ta shtuar ndikimin e saj në mbarë Dibrën. Për këtë qëllim ajo solli në Dibër Basri beun, i cili formoi në mendjen e tij një "qeveri të përkohshme shqiptare", e cila ishte hija e qeverisë së Sofjes. Basri beu, në kohën e pushtimit osman, kishte qenë deputet i Dibrës në parlamentin turk. Ai shpeshherë i kishte mbrojtur me kurajë të drejtat e popullit shqiptar. Për këtë shkak u përndoq nga turqit dhe shkoi dhe u strehua tek Elez Isufi, në Dardhë. Ky njeri, me një të kaluar patriotike, por tani në shërbim të bullgarëve, mbante shpresa tek Elez Isufi, të cilit i kishte dhënë detyrën e "ministrit të brendshëm" në "qeverinë provizore". Elez Isufit ia donte puna që të tregohej i afrueshëm. Ushtria bullgare ishte pritur me armë në Gollobordë. Populli patriot i kësaj treve u ngrit në këmbë për ta kundërshtuar okupimin e trevës. Ushtria bullgare filloi reprezaljet. Bullgarët masakruan edhe dy udhëheqësit kryesorë të lëvizjes antibullgare: Elez Koçin dhe Qazim Dukën, por qëndresa e gollobordasve vijoi nën udhëheqjen e Bajram Koçit.6) Që ta ulte efektin e goditjes së ushtrisë bullgare në Gollobordë, Elez Isufi bëri sikur pranoi të merrte pjesë në atë qeveri hije. Basri beu propagandonte që edhe atdhetarët e tjerë, si Pandeli Cali në jug dhe Bajram Curri në veri përpiqeshin për këtë qeveri. Elez Isufi tha se asnjë lloj qeverie nuk mund të formohej përderisa bullgarët masakronin popullin e Gollobordës. Nëse bullgarët donin me të vërtetë të formonin një qeveri provizore shqiptare, shtoi ai, ata duhet të ndalin dhunën.

Elez Isufi më në fund doli hapur kundër formimit të "qeverisë provizore" dhe bëri një deklaratë që asnjë patriot dibran të mos afrohej për një gjë të tillë, mbasi Basri beu nuk ishte më miku i tij dhe se ai nuk punonte për të mirën e Shqipërisë. Si përfundim, "qeveria provizore" e Basri beut mbeti vetëm në kokën e tij. Edhe Bullgaria, më në fund, hoqi dorë prej saj. Ministri i Punëve të Jashtme të Bullgarisë njofton kryeministrin bullgar Radosllav se ndikimi i "qeverisë provizore" të Basri beut në Dibër ishte zero. 7)

* * *

Qëndrimi i Elez Isufit ndaj Austro-Hungarisë ishte krejt i ndryshëm krahasuar me qëndrimin që mbajti me bullgarët. Tek bullgarët ai shikonte ndikimin rus. Përshtrirja e sllavëve në Ballkan, sidomos në tokat shqiptare, dhe hapja prej tyre një korridor për në Adriatik, ishte një ëndërr e madhe e Rusisë. "Më 1852 perandori francez Napoloni III, që porsa kishte marrë fronin me grusht shteti, bindi sulltanin e Turqisë t`i jepte atributin e Mbrojtësit të të Krishterëve në Perandorinë Osmane, rol që cari i Rusisë tradicionalisht ia kishte rezervuar vetes. Nikolla I u tërbua që Napoleoni, të cilin ai e quante një zengjin të ri dhe të paligjshëm, guxonte t`i zinte vendin Rusisë si mbrojtëse e sllavëve të Ballkanit... " 8) Madje jo vetëm cari, por edhe shkrimtari i shquar Fjodor Dostojevski e shikonte si të ligjshëm dhe e bekonte sulmin e ushtrisë ruse për të çliruar sllavët nga sundimi i huaj, duke iu kundërvënë, po qe nevoja, gjithë Evropës Perëndimore: "Pyesni njerëzit, pyesni ushtarët: Përse po ngrihen? Përse po shkojnë në luftë dhe ç`presin ata prej saj? Ata do t`ju thonë me një gojë se po shkojnë t`i shërbejnë Krishtit dhe të çlirojnë vëllezërit e shtypur." 9)

Elez Isufi e dinte që Austria kishte interesa në Ballkan. "Pas dëbimit nga Gjermania, Perandoria e Austro-Hungarezëve nuk kishte se ku të shtrihej tjetër, përveç Ballkanit." 10)

Diplomacia e Elez Isufit qëndron në faktin se ai e përshtati sjelljen dhe qëndrimin e tij në përputhje me interesat kombëtare. Ai nuk ngurronte të bëhej me cilindo shtet, nëse ai do t'ia plotësonte më mirë këto interesa. Elez Isufi kishte qenë nga ata atdhetarë që kishte luftuar për të krijuar Shqipërinë Etnike. Ai nuk ishte për shpalljen e pavarësisë në një copë Shqipëri. Më mirë Shqipëria të ishte një shtet i varur nga një shtet i madh, por të ishte e plotë, sesa një Shqipëri e pavarur dhe e cunguar.Varësinë, si shumë atdhetarë të tjerë, ai e shikonte tek Austria. Ai e dinte se pavarësia nuk funksionon në një shtet të ndarë dhe të copëtuar, siç edhe nuk ka funksionuar në të vërtetë. Kur e kishin pyetur një herë sesa e donte Shqipërinë të madhe, Elez Isufi ishte përgjigjur: "Unë nuk e due Shqipninë as të madhe e as të vogël, por aq sa e ka krijue Zoti; unë e due Shqipninë deri aty ku shqiptarët janë popullsi e vetme ose me shumicë dërmuese; unë e due Shqipninë deri aty ku tregohen përralla, gojëdhana dhe legjenda shqip, deri aty ku flitet gjuha shqipe, deri aty ku bukës i thonë bukë dhe ujit i thonë ujë. Shqipnia nuk bahet e madhe edhe me këto kufij që them unë, por bahet e fortë, jo për të mbajtë të tjerët nën sundim, por me ia prujtë qentë prej vetes dhe mos me i lanë të kacafyten me njani-tjetrin." 11) Esenca e mendimit të tij ka të bëjë me politikën e ruajtjes së ekuilibrit në Ballkan. Sipas tij, këtë mund ta bënte vetëm një Shqipëri e plotë dhe e fortë, që nuk kishte ambicie për të pushtuar të tjerët, por as t'i linte të tjerët që të turbullonin paqen dhe qetësinë, një Shqipëri që do të rrezatonte vlera dhe do të ishte model për t'u ndjekur, një Shqipëri që do të krijonte stabilitet dhe do ta ruante paqen në Ballkan, një Shqipëri që do t'u vinte frerin orekseve të sllavëve dhe grekëve. Me copëtimin e Shqipërisë Europa ia shtoi telashet vetes, se dëmtoi dhe shkatërroi atë komb dhe atë popull që historikisht nuk ka lakmuar as një pëllëmbë tokë të huaj.

Austro-hungarezët e dinin që në Dibër kishte një prijës të autoritetshëm, të cilit i peshonte shumë fjala. Por ata ishin ushtarakë, jo diplomatë. Udhëzimet si të silleshin me shqiptarët i kishin marrë. Po ushtarakët i bien shkurt, gjithçka duan ta zgjidhin me dhunë. I tillë ishte edhe gjenerali austriak që dha urdhër që djemtë e Dibrës, që kishin mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, të thirreshin ushtarë për ushtrinë austro-hungareze. Populli u ngrit në këmbë për ta kundërshtuar. Gjenerali, më në fund, kur e pa veten pa rrugëdalje, iu lut Elez Isufit që ta mësonte si të vepronte.

Elez Isufi i tha: "Nëse ju doni të silleni si pushtuesit serbë, na e thoni se edhe ne do t`iu përgjigjemi siç u jemi përgjigjur atyre: me armë. Nëse ju doni ta zgjidhni gjithçka me mirëkuptim dhe me arsye, bisedojmë për të gjetur zgjidhjen e duhur. Unë jam i pari që do t`ia japë djemtë Austrisë, populli vjen mbas meje. Por djemtë nuk do t`i jap për ushtarë, por për të mësuar në shkollat austriake, për t`u bërë oficerë, doktorë, mësues për të cilët ka shumë nevojë ky vend. Ne jemi popull i vogël dhe nuk mund ta mbajmë Austro-Hungarinë me ushtarë." Gjenerali i ushtrisë së huaj hoqi dorë nga detyrimi ushtarak në Dibër. Një javë më vonë, Elez Isufi bashkë me ushtarakun e lartë, gjoja si rastësisht, shkoi për të bërë një vizitë në shkollën e Sllovës, ku nxënësit, si një trup i vetëm, u përgjigjën kështu: "Miqtë i presim si miq, Shqipëria është e shqiptarëve!" 12) Edhe ky ishte inskenim i Elezit për t`ia vënë një farë kufiri Austro-Hungarisë. Kjo ishte një diplomaci e shprehur në terrenin konkret. Elez Isufi kërkoi nga austro-hungarezët që të ndiqnin parime të tjera nga ato që kishin ndjekur pushtuesit serb, duke u njohur shqiptarëve simbolet e veta kombëtare, si flamurin, himnin, gjuhën, kulturën, shkollën, traditat etj. Dhe këtë Austro-Hungaria e bëri në mënyrën më të mirë. Elez Isufi ishte një nga krerët e parisë shqiptare që shkuan në Vjenë për t`u takuar me Franc Jozefin me kërkesën e këtij të fundit. Albanologët austriakë ia kishin bërë të njohura oborrit perandorak kanunin, doket, zakonet, traditat dhe kulturën e popullit tonë. Ata kishin treguar me fakte sesa rol të madh kishin në jetën e këtij vendi krerët e parisë, prandaj një besatim dhe marrëveshje me ta nuk ishte pa rëndësi. Perandori atëherë ishte shumë i moshuar, por, nëpërmjet pretendentit për fronin perandorak, donte t`u fliste, por edhe t`i dëgjonte krerët e parisë shqiptare. Paria shqiptare kishte mjaft njerëz të ditur dhe të kulturuar, disa kishin kryer shkolla të larta në Austri. Megjithatë, ajo bëri si zëdhënës të saj Elez Isufin, i cili i kërkoi Franc Jozefit që ndaj shqiptarëve të ndiqte një politikë bashkëpunimi dhe ndihme, duke pasur një plan të studiuar mirë për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të këtij vendi të vogël në Ballkan. Elez Isufi nuk njihte dhe nuk dinte përvoja botërore, kur një vend i vogël dhe i pastabilizuar zhvillohet nën protektoratin e një vendit të madh dhe të zhvilluar. Ai s`e kishte përvojën e kolonive britanike ose franceze, por kishte vizionin dhe largpamjen e vet, një intuitë diplomatike të pagabueshme. Ai ishte një manovrator i madh historik në kushtet dhe rrethanat e atëhershme nëpër të cilat kalonte Shqipëria.

Elez Isufi mbrojti interesat e Shqipërisë. Fjala e tij përshkohej nga disa ide që ai i paraqiti jo vetëm rrjedhshëm dhe të sistemuara, por edhe me logjikë të fortë. Ai prezantoi shkurt dhe qartë se gjatë procesit të copëtimit të Perandorisë Osmane dhe krijimit të shteteve kombëtare, në Ballkanin Perëndimor veproi ligji i forcës, pa zbatuar asnjë parim sipas të cilëve bëhet ndarja e shteteve të vegjël nga një perandori që shpërbëhet. Prej moszbatimit të parimeve ndërkombëtarisht të njohura, Shqipëria u nda dhe u copëtua në disa shtete dhe konkretisht tokat e saj i ka marrë me shumicë Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia në jug. Shqipëria e mbetur brenda kufijve të vitit 1913, është shumë e cunguar në krahasim me Shqipërinë Etnike. Por Shqipëria nuk do të kishte mbetur edhe aq sa është sot, po të mos kishte pasur ndihmën dhe përkrahjen e Perandorisë suaj të lavdishme."

Nënvizimi i këtij fakti që Elez Isufi e bëri në masën dhe me taktin e duhur, kishte një rëndësi të madhe dhe ishte çelësi për të kërkuar mbështetje të re nga Austro-Hungaria. Elez Isufi, sikur të ishte një njeri me disa universitete, theksoi se kontributi i Austro-Hungarisë për Shqipërinë nuk lidhet vetëm me ndihmën që dha për pavarësinë e Shqipërisë. Interesi i saj për Shqipërinë ka nisur shekuj më parë kur dijetarët austriakë kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për historinë, kulturën, tradita, zakonet, gjuhën etj., e popullit shqiptar që nga muzgu i historisë deri në ditët tona.

(Vijon në faqen 22)

*) Shprehja "Gjenerali me shajak" që nga botimi i shkrimit tim, ka kaluar gojë më gojë e shkrim më shkrim, si titull për tekste këngësh e poezish. E vërteta është se ajo ka këtë burim: Xhafer Martini: "Gjenerali i veshur me shajak", "Ushtima e Maleve", Peshkopi, më 25. 06. 1980.

Rruga e Arbërit nr. 71
debat

Vazhdon debati për vendin ku u zhvillua Beteja e Torviollit. Në numrat e ardhshëm shkrime të tjera me të njëjtën temë nga studiues të historisë

BETEJA E TORVIOLLIT E 29 QERSHOR 1444

Vendi ku u zhvillua dhe simbolika e veçantë

Nga: **ALI HOXHA**

Për figurën dhe veprimtarinë kombëtare, luft arake e diplomatike të Skënderbeut, një figurë me përmasa evropiane madje dhe botërore, kanë folur e shkruar historianë dhe amatorë tash 500 vjet me radhë dhe do të flasin edhe në të ardhmen. Vet fakti që shumë studiues nga krahina të ndryshme të Shqipërisë janë munduar të nxjerrin origjinën e tij nga vendlindja e tyre, apo ndonjëri ka tentuar që edhe origjinën e vet ta lidhë me prejardhje nga Skënderbeu, jo vetëm këtu në Shqipëri, por edhe nga të huajt, siç ka qenë rasti me një spanjoll të vetëquajtur Alardo Kastrioti, në shek. XIX, apo edhe të tjerë, këtu në Shqipëri ku tani, në ditët tona, nuk ka asgjë për t'u çuditur, sepse edhe vet sistemi shoqëror botëror i këtij shekulli, quhet sistemi i ekonomisë së tregut dhe pikërisht për tregti të tilla politike, etnike etj (v.o: tregti nuk bëhet vetëm në ekonomi, por edhe në fusha të tjera) edhe kryetari i Komunës së Himarës, minoritari grek Vasil Bollano, arrin deri aty sa të bëjë grek edhe Skënderbeun duke e quajtur Jorgos Kastriotos, pasi oreksi i tij nuk është ngopur me ndërrimin e emrave të emigrantëve shqiptarë të këtyre viteve, për helenizimin e tyre, por dëshiron të helenizojë edhe Gjergj Kastriotin – Skënderbeun. Ëndrra të tilla me sy hapur në mes të ditës me diell, të shovinistëve fqinjë, sidomos të atyre grekë, nuk ka pse të na habisin, pasi tashmë jemi mësuar me ta, sepse nëpërmjet ëndrrash të tilla ata duan të përligjin pretendimet e tyre territoriale për të copëtuar Shqipërinë sërish, ashtu siç bënë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, kur Shqipëria etnike u rrudh në kufijtë e sotëm shtetëror duke u copëtuar tokat shqiptare në 5 (pesë) shtete.

Njëri nga pretenduesit e kohëve të fundit për pasardhës direkt nga trungu i Skënderbeut, shtetasi italian Xhorxhio Kastriotas (Gjergj Kastrioti i ri), erdhi me bashkëshorten në Shqipëri në në muajin maj të vitit të kaluar, 2011, dhe bëri një vizitë edhe në Sinë të Dibrës, në Muzeun e Kastriotëve, për të njohur më nga afër trojet e të parëve të vet. Pas ceremonisë mikpritëse që u zhvillua në Pallatin e Kulturës në qytetin e Peshkopisë, në bisedë direkte me të unë i transmetova (sigurisht nëpërmjet përkthyesit), këtë mesazh:

"Nëse jeni me të vërtetë trashëgimtar (brezi i 15-të) i gjakut të Skënderbeut dhe nëse do të keni mirësi për të ardhur edhe ndonjëherë tjetër në Shqipëri, atëherë për përkthyes të keni njërin nga djemtë tuaj".

* * *

Çështja e lokalizimit të vendit ku u zhvillua beteja e parë e Skënderbeut kundër forcave osmane, më 29 qershor 1444, e cila është njëherësh edhe fitorja e parë e Skënderbeut kundër superfuqisë më të madhe të asaj kohës, në botë dhe që në historiografi njihet me emrin **Beteja e Torviollit**, është ajo gjë, për të cilën historianët kanë pas kontradikta për saktësimin e vendit konkret, të terrenit ku është zhvilluar ajo betejë, ndonëse që **të gjithë ato**, duke filluar që nga M. Barleti, historiani i parë i Skënderbeut e deri tek **historianët e studiuesit** e ndryshëm të kohës sonë, **bashkohen në një pikë, që ajo është zvilluar në Dibër të Poshtme**, pasi, së pari këtë informatë e ka dhënë **Marin Barleti dhe të gjithë të tjerët janë vërtitur rreth të njëjtit toponim, në Fushën e Torviollit në Dibër të Poshtme, por me ndonjë kontradiktë anësore ndërmjet tyre,** kur ka ardhur fjala gjatë përshkrimit të terrenit të Fushës së Torviollit, duke quajtur ndryshe njëri ndonjë lum, apo tjetri quan ndryshe ndonjë kodër, që kufizohet në Fushën e Torviollit etj., gjëra këto tepër anësore, për të cilën do të thoja, për momentin, nuk ia vlen ta ndalemi në ato hollësira të vogla. Por këtu po përmend vetëm emrat e disa autorëve që janë marrë me përshkrimin e terrenit të fushës, ku u zhvillua "Beteja e Torviollit" si Marin Barleti [1] në veprën e vet, të botuar midis viteve 1508-1510; prifti italian **Xhomario Biemmi** në veprën e vet kushtuar Skënderbeut, botuar më 1742, i cili thotë se të dhënat i ka marrë nga një dorëshkrim i shkruar nga një bashkëluftëtar i Skënderbeut, nga Tivari, të shkruar në vitin 1480, pra rreth 30 vjet para veprës së M. Barletit, por që ai dorëshkrim ka humbur [2]. Lidhur me këtë, aty thuhet: **"Skënderbeu u drejtua për në Dibër të Poshtme, dhe këtu e vendosi ushtrinë në Fushën e Torviollit,** që është e gjerë rreth 3 milje dhe e gjatë 7 milje, e rrethuar prej malesh, brigjesh dhe pyjesh nga të gjitha anët (por sot nuk ekziston një toponim i tillë) dhe përmes saj kalonte lumi Skampanio (Shkumbin)"[3].

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, që mund të konsiderohen si të vetmet burime historike lidhur me këtë betejë, nuk mund të ketë një lokalizim që të mos shkaktojë diskutime e debate dhe për më tepër kur të dhënat e Biemmit janë vënë në dyshim nga shumë studiues të periudhës së Skënderbeut [4].

Të nisur nga disa mospërputhje për çështje të vogla anësore, me ndonjë toponim, qoftë edhe për ndonjë "lapsus" (gabim shtypi) siç është rasti kur gabimisht përmendet lumi Shkumbin (Scambino) në vend të lumit Drini, i cili kalon përmes gjithë trevës së Dibrës, studiues të ndryshëm të kohës sonë, kanë shfaqur pikëpamje të ndryshme të cilat janë shumë larg së vërtetës lidhur me lokalizimin e vendit ku u zhvillua Beteja e Torviollit. Kështu studiuesi **Dilaver Radeshi**, për të mbështetur hipotezën e vet se Beteja e Torviollit e vitit 1444 është zhvilluar në vendin ku sot quhet "Fusha e Domosdovës" afër Prrenjasit në rrethin e Librazhdit, ku, për pasojë, qysh prej viteve '60, aty është ngritur edhe një lapidar kushtuar asaj beteje, ai arrin në një absurditet tjetër, kur lumin "Drin i Zi" e quan si kufiri ndarës ndërmjet dy Dibrave, duke quajtur, sipas tij, Dibër të Epër trevën që ndodhet në anën lindore të Drinit, kurse Dibër të Poshtme quan trevën që shtrihet në anën perëndimore të Drinit, pra duke e shtrirë territorin e Dibrës së Poshtme deri në Fushën e Domosdovës në Prrenjas të Librazhdit.

Për të kuptuar se sa e pabazë shkencore është një hipotezë e tillë, po përmendim "argumentet" më saktë hamendjen mbi të cilat është mbështetur D. Radeshi për hipotezën e vet:

"... Sipas Barlecit, kjo betejë u zhvillua në Dibrën e Poshtme dhe sipas Tivarasit në Torvioll, i cili ndodhej po në Dibrën e Poshtme. Por nuk ka qenë përcaktuar as deri ku shtrihej Dibra e Poshtme dhe as ku gjendej Torviolli.

Gjon Muzaka, një bashkëkohës i Skënderbeut thotë se Çermenika dhe Gryka e Shkumbinit ka qenë pjesë e Dibrës së Poshtme...

Duke u mbështetur tek Barleci dhe te Muzaka mendohet se gryka e Shkumbinit, nga qafa e Thanës dhe deri në Elbasan ka qenë pjesë e Dibrës së Poshtme". (Dilaver Radeshi, "Beteja e Torviollit", Ylli, nr. 6, viti 1966, f. 20).

Por pas njohjes me "Defterin emëror (kadastral) të Vilajetit të Dibrës të vitit 1467", hipoteza e lartpërmendur e D. Radeshit se gryka e Shkumbinit, Qafa e Thanës etj., paskan qenë pjesë e Dibrës së Poshtme në kohën e Skënderbeut, një hipotezë e tillë rrëzohet katërcipërisht dhe, për pasojë, çdo përpjekje nga kushdoqoftë për të lokalizuar Betejën e Torviollit të 29 qershorit 1444, në Fushën e Domosdovës apo në çdo vend tjetër jashtë territorit të Dibrës së Poshtme të sotme, e thënë me një term sportiv, është "pozicion jashtë loje", d.m.th. është shumë larg së vërtetës, pasi ashtu siç përcaktohet në Defterin turk, edhe sipas traditës, kufiri ndërmjet dy Dibrave, janë kodrat e Çenokut, në anën lindore të lumit Drin dhe Gurra e Mazhicës, në anën perëndimore të Drinit të Zi, kështu Dibra e Poshtme përfshin pjesën veriore të saj, e cila shtrihet deri në Reç, që kufizohet me Mirditën dhe me Lumën (Kuksin).

Për pasojë në të njëjtin gabim kanë rënë edhe dy studiuesit dibranë, Selim Alliu e Hilmi Sadiku, të cilët Betejën e Torviollit të vitit 1444 e kanë lokalizuar në Fushën e Bulqizës [5], në kundërshtim me burimet historike, M.Barletin e G. Biemin, të cilët e kanë përcaktuar qartë se Beteja e Torviollit është zhvilluar në Dibër të Poshtme, si edhe në kundërshtim me vetveten, përderisa, vet ata, S. Alliu dhe H. Sadikaj, si kufi natyror ndarës ndërmjet dy Dibrave, duke u mbështetur me traditën, kanë përcaktuar "Qafën e Qenokut", në afërsi të fshatit Dovalan. Një gjë është me të vërtetë e pakuptueshme për ne, se si është e mundur që dy autorët dibranë të lartpërmendur, të bijen në një lokalizëm aq meskin, përderisa vetë ata pranojnë: "të dhënat se beteja e zhvilluar në Dibër të Poshtme është e mjaftueshme për të përligjur faktin që kjo fushë duhet kërkuar diku brenda kufijve të Dibrës" [6]., në një kohë që po në atë shkrim të njëjtët autorë pohojnë:

"Duke iu përgjigjur pyetjes se "Ku gjendet Torviolli", një argumentim logjik, bën historiani Kristo Frashëri. Sipas tij, kjo betejë duhet lokalizuar diku në fushën e Peshkopisë, por se ku konkretisht akoma as ky nuk e ka përcaktuar". Dhe më tej ata (S. Alliu, H. Sadiku) vijojnë:

"Edhe Instituti i Historisë për këtë betejë jep sa vijon: "Të dy ushtritë u rreshtuan ballë për ballë në fushën e Dibrës", por se ku është konkretisht vendi, nuk e përcakton. Edhe në librin e botuar në vitin 1967 (tekstin e historisë – A. H.) nuk jepet një mendim i prerë... "Të dy ushtritë u rreshtuan ballë për ballë në një fushë të quajtur fusha e Torviollit, lokalizimi i së cilës për ne sot është i pamundur; disa e vendosin në Dibër e disa në Domosdovë" – përfundojnë ata [7].

Pra, **të kërkosh për të gjetur jashtë Dibrës së Poshtme fushën ku u zhvillua Beteja e Torviollit e 29 qershorit 1444,** si në rastin e Domosdovës dhe të Fushës së Bulqizës, në një **kohë që të gjitha burimet historike për atë betejë flasin vetëm për në Dibrën e Poshtme,** ajo **është një ndërmarrje jo vetëm tepër subjektive e meskine, por diçka më tepër, një diçka e stisur, e sajuar, jo shkencore, ata janë gjykime emocionale.**

Në kushte të tilla, përpjekjen e parë për ta kërkuar fushën e Betejës së Torviollit brenda territorit të Dibrës së Poshtme e ka bërë Kristo Frashëri, në një shkrim me titull "Ku gjendet Torviolli?", botuar në revistën "Shkenca dhe Jeta" nr. 3 (1975), f. 61, por ai mjaftohet vetëm me një pohim të papërcaktuar duke thënë se beteja e Torviollit u zhvillua në Dibrën e Poshtme, diku në fushën e Peshkopisë [8].

Unë, shkruesi i këtyre radhëve, duke qenë autor i një studimi "**Mbi vlerat historike të Defterit emëror të Vilajetit të Dibrës të vitit 1467",** që e kam referuar një kumtesë në "Konferencën e Parë Studimore-Shkencore të kulturës popullore dhe të historisë së rrethit të Dibrës" më 13-14 dhjetor 1976, në të cilin studim**, konstatohet dhe konfirmohet se ndarja natyrore e dy Dibrave, e Dibrës së Epër dhe e Dibrës së Poshtme,** ashtu si në traditën popullore, edhe në vitin 1467, **pra në kohën e Skënderbeut përputhet plotësisht me ndarjen e sotme të Dibrës,** ku Dibra e Poshtme shtrihet në të dy anët e Drinit të Zi, në rrjedhjen e poshtme të Drinit, në pjesën veriore të luginës së Drinit të Zi, ku si kufi natyror ndërmjet dy Dibrave, shërbejnë Kodrat e Qenokut, për anën lindore të Drinit dhe Gurra e Mazhicës në anën perëndimore të Drinit të Zi. Pra, duke u mbështetur në atë dokument historik "Defteri emëror i vilajetit të Dibrës i vitit 1467", unë kam hedhur poshtë çdo tentativë për një ndarje tjetër të Dibrës mesjetare në dy pjesë, të Dibrës së Epër nga Dibra e Poshtme, të ndryshme nga ndarja e sotme territoriale, siç ishte përpjekja e D. Radeshit pwr ndarjen e dy Dibrave me kufi ndarës ndërmjet tyre Drinin e Zi. Për pasojë ky dokument nxjerr jashtë loje dhe hedh poshtë si të pabazë çdo përpjekje që mund të bëhet për të kërkuar jashtë territorit të Dibrës së Poshtme të sotme Fushën e Torviollit, në të cilën u zhvillua beteja [me të njëjtin emër] nga Skënderbeu kundër ushtrisë turke të komanduar nga Ali Pasha, më 29 qershor 1444. Prandaj në studimin për këtë çështje, me titull "Mbi lokalizimin e Fushës së Betejës së Torviollit" [9], të botuar, së pari, në revistën shkencore të Akademisë së Shkencave "Studime Historike" nr. 3, 1979 (f. 229-236), pas parashtrimit të argumenteve të mia, unë kam shprehur mendimin se:

"Dëshmitë e Barletit dhe të Biemmit (nënkupto Tivarasin) janë të mjaftueshme për të krijuar bindje të plotë se Torviolli është në Dibër të Poshtme (të sotme). Duke u mbështetur në Defterin emëror të vilajetit të Dibrës të vitit 1467" dhe në disa të dhëna topografike, gjeografike dhe të dhëna historike të tërthorta mendojmë se, fusha në të cilën **u zhvillua beteja në tërësi është fusha në bregun lindor të Drinit të Zi, tek Ferra e Pashës,** pranë Urës së Lushës, territor i cili aktualisht quhet **Fushë-Çidhën ose Fusha e Çidhnës"**.

Theksojmë se "Fusha e Çidhnës" një pjesë e së cilës më saktë një fshat i zonës së Çidhnës deri në vitin 1974 ka qenë njohur me emrin Fushë-Alije, bile banorët vendës, çidhnakët e kanë quajtur vetëm me emrin thjeshtë "Fushë", pa asnjë përcaktor. Sqarojmë se edhe Fusha e Kastriotit me kuptimin më të gjerë të fjalës, është pjesë përbërëse e Fushës së Çidhnës, gjë të cilën edhe njohja e saj me emrin tjetër "Fusha e Thatë", pa përcaktorin e Kastriotit, për analogji, ashtu siç thirrej fshati i lartpërmendur thjesht "Fushë", pa përcaktorin "F. e Alie", vërteton faktin se ato të dyja janë pjesë e një të tëre, pra të Fushës së Çidhnës.

Argumentet e plota në mbështetje të mendimit tonë, ne **i kemi trajtuar** gjerësisht në studimin tonë të lartpërmendur qysh më 1979, ku për pasojë **edhe Instituti i Historisë dhe Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, Betejën e Torviollit të 29 qershor 1444, e ka përcak-**

studim

Të kërkosh për të gjetur jashtë Dibrës së Poshtme fushën ku u zhvillua Beteja e Torviollit e 29 qershorit 1444, si në rastin e Domosdovës dhe të Fushës së Bulqizës, në një kohë që të gjitha burimet historike për atë betejë flasin vetëm për në Dibrën e Poshtme, ajo është një ndërmarrje jo vetëm subjektive, por e stisur, e sajuar, jo shkencore, ata janë gjykime emocionale.

Instituti i Historisë dhe Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, Betejën e Torviollit të 29 qershor 1444, e ka përcaktuar në një terren të tillë që përputhet plotësisht me territorin që e kemi përcaktuar ne, me territorin e Fushës së Çidhnës, duke mos përjashtuar këtu as Fushën e Kastriotit, as atë të Shumbatit, pasi beteja në tërësi është zhvilluar në gjithë Dibrën e Poshtme

tuar në një terren të tillë që përputhet plotësisht me territorin që e kemi përcaktuar ne, me territorin e Fushës së Çidhnës, duke mos përjashtuar këtu as Fushën e Kastriotit, as atë të Shumbatit, pasi beteja në tërësi është zhvilluar **në** gjithë **Dibrën e Poshtme,** por kulmi i saj, vendi ku u shpartallua ushtria turke e komanduar nga gjenerali turk, Ali Pasha, i cili shpëtoi gjallë duke u fshehur në një ferrë, **është pikërisht te Ferra e Pashës,** prandaj edhe ai toponim quhet me atë emër, pikërisht në përjetësim të atij akti, të shpartallimit dhe mbetjes së ushtrisë turke nëpër ferra. Pra, këtu po përmend shumë shkurt vetëm disa nga argumentet që përforcojnë mendimin tonë për këtë çështje:

1) Defteri i Vilajetit të Dibrës i vitit 1467, në të cilin vërtetohet ndarja e Dibrës mesjetare në dy pjesë: në Dibër të Epër dhe në Dibër të Poshtme, d.m.th ndarja e vitit 1467 përputhet plotësisht me ndarjen e sotme të Dibrës, përjashton katërcipërisht zhvillimin e betejës së Torviollit jashtë territorit të Dibrës së Poshtme të sotme dhe hedh poshtë çdo hipotezë tjetër për këtë gjë jashtë këtij territori.

2) Po të vështrojmë nga afër **terrenin, Fushë-Çidhna,** ose Fushë-Alie, së bashku me fshatrat Laçes e Blliçe, ku mendojmë se është zhvilluar epiqendra e betejës së parë të Skënderbeut kundër ushtrisë osmane më 1444, jo vetëm që i **plotëson të gjitha kushtet për zhvillimin e një beteje mesjetare me kalorës e këmbësorë** prej dhjetëra mijëra luftëtarësh për secilën palë, por **ka edhe ngjashmëri të plotë me terrenin që përshkruan M. Barleti dhe Biemmi** (nënkupto Tivarasi). Fusha e Çidhnës shtrihet në bregun lindor të Drinit të Zi. Po të kemi parasysh edhe fshatin Arras, në anën perëndimore të Drinit, ajo zonë është një fushë e gjerë në formë rombi, që i plotëson të gjitha përmasat dhe përshkrimet që i bën M. Barleti, terrenit ku u zhvillua Beteja e Torviollit e qershorit 1444. Fusha e Çidhnës rreth e qark është e mbrojtur nga kodrina dhe male të veshura me dushqe.

3) Nëpër Fushën e Çidhnës kalojnë e kryqëzohen të gjitha rrugët për në Peshkopi e Dibër të Madhe, nga Lura, Zall-Dardha, Sllova e Luma. Nga Fushë-Çidhna kalohet drejtpërdrejtë në Mat e prej atje në Krujë edhe nëpërmjet rrugës që kalon nëpër Sinjë, në Maje të Vâgut, në bjeshkën e Pllajut, e cila lidhet me Stelushin e pastaj kalon në Luginën e Matit, **prej nga ku dilet në Krujë.** Fusha e Çidhnës ka qenë kryqëzim rrugësh edhe në lashtësi, nëpërmjet të cilave lidhej Dibra me Mirditën, Lumën, Kukësin e Kosovën. Përmes Fushë-Çidhnës kalon "Rruga e Madhe" e cila lidhte Dibrën me Lumën e Kosovën.

4) Të gjitha këto argumente lejojnë të arrijmë në përfundimin se **ushtria osmane** e komanduar nga Ali Pasha, **në qershor të vitit 1444, ka hyrë në Dibër të Poshtme nga ana e Kosovës dhe e Lumës** dhe ka rënë fshehurazi nëpërmjet "Rrugës së Madhe" në luginën e Drinit të Zi, **në Fushën e Torviollit,** më saktë **në Fushë-Çidhnën e sotme, në Dibër të Poshtme** (Por nuk përjashtohet mundësia e ardhjes edhe nga lugina e Radikës).

5) Mbi të gjitha duhet të kemi parasysh se **në Trevën e Çidhnës është edhe vendlindja e vendbanimi i Skënderbeut dhe i parardhësve të tij.** Toponimia shumë e dendur e kësaj zone që lidhet me emrin e Skënderbeut dhe të kastriotëve, si në asnjë krahinë tjetër, që dihet nga i gjithë populli i Dibrës, si: Kastriot, Fusha e Kastriotit ose Fusha e Thatë, Kalaja e Gjonit, Kroi i Kastriotit, Kroi i Skënderbeut, Thana e Skënderbeut, guri i kalit të Skënderbeut etj., përbëjnë argumente të pakontestueshme që vërtetojnë origjinën dibrane të Skënderbeut... Kjo përforcohet edhe nga fakti se në realizimin e fitores së çlirimit të Krujës nga Skënderbeu dibranët luajtën rol kryesor qysh kur e shoqëruan Skënderbeun gjatë kthimit nga Turqia, ashtu edhe me mbështetjen që mbarë popullsia e krahinës së Dibrës i dha Skënderbeut, si Zot i Dibrës dhe i Matit (dominus Dibra et Mati). Edhe **Kristo Frashëri,** në studimin e tij të fundit në vitin 2002, kur flet për përgatitjet e Skënderbeut për "Betejën e Torviollit" ai thekson se "Në fund të majit (1444 - A. H.) ushtria shqiptare prej rreth 10 mijë vetash, në pjesën më të madhe e rekrutuar nga zotërimet e Kastriotëve qe gati për të hyrë në luftë".

"Rasti për t'u ndeshur me ushtrinë turke erdhi shumë shpejt. Në qershor 1444 një ushtri osmane prej rreth 25 mijë vetash e komanduar nga Ali Pasha, u nis nga Shkupi në drejtim të Shqipërisë, marshoi në luginën e Radikës doli në Rahonik (sot qyteti i Dibrës) dhe pastaj duke marshuar nëpër luginën e Drinit të zi, doli në Dibër të Poshtme, ku **sulltani mendonte se Skënderbeu kishte bazën territoriale të forcës së vet ushtarake**[10]. Dhe më pas duke perifrazuar M. Barletin dhe G. Biemin, **vijon:**

"Skënderbeu i lajmëruar për afrimin e turqve u doli përpara me ushtrinë e re shqiptare. Të dy ushtritë shqiptare u rreshtuan ballë për ballë diku në trevën e Dibrës së Poshtme. Më 29 qershor 1444, sipas planit të Skënderbeut, ushtria shqiptare e ndarë në tri pjesë, manovroi me mjeshtri dhe u tërhoq sikur të ishte e thyer, deri sa e futi ushtrinë turke në fushën e ngushtë të Torviollit të rrethuar me male e pyje. Kur Ali Pasha kujtoi se i kishte zënë shqiptarët në kurth, ai u gjend papritmas i rrethuar nga forcat ushtarake shqiptare që ishin fshehur në pyje, të cilët i sulmuan turqit nga të gjitha anët deri sa i shpartalluan plotësisht.

Sipas G. Biemmit turqit lanë në fushën e betejës 7000 të vrarë dhe 500 robër në duar të shqiptarëve. Kurse shqiptarët patën afërsisht 4000 të vrarë dhe të plagosur, ndonëse M. Barleti jep shifra më të larta (22 mijë turq të vrarë dhe 2000 robër), kur edhe ato shifra që jep G. Biemmi janë padyshim të fryra (të zmadhuara)".

Dhe pasi analizon përputhjet dhe mospërputhjet e të dhënave historike të M. Barletit dhe të G. Biemmit për Betejën e Torviollit, lidhur me toponimin Mokër dhe me lumin Shkumbin, në vend të Drinit, Prof. Dr. Kristo Frashëri e mbyll mendimin e tij kështu:

"Në rast se këtu kemi të bëjmë me një lapsus – "Shkumbin për Drin", i cili me të vërtetë kalon pranë Peshkopisë, atëherë kontradikta zhduket. Si rrjedhim, sipas tij, beteja e 29 qershorit 1444 duhet të jetë zhvilluar në fushën e Shumbatit" [11].

Por në qoftë se ushtria turke ka ardhur nga Shkupi nëpër luginën e Radikës dhe ka rënë në Dibër, ashtu siç pohon Prof. Kristo Frashëri, atëherë, nisur nga logjika e taktikës luftarake të Skënderbeut, se ai me një ushtri të vogël nuk mund të ndeshej ballë përballë me një ushtri dy-tre herë më të madhe në një fushë kaq të hapur siç është Fusha e Kastriotit, nuk na lejohet që të arrijmë në përfundimin që ajo të ketë arritur deri në Fushë të Shumbatit. Skënderbeu me manovrimin e tij taktik e ka tërhequr ushtrinë kundërshtare në një terren më të ngushtë, dhe pasi e ka futur atë në kurth duke e rrethuar në të katër anët, e ka shpartalluar ushtrinë turke në Fushë-Çidhën tek Ferra e Pashës, buzë Drinit. Ndërsa nga Fusha e Shumbatit mund të ketë filluar beteja vetëm në qoftë se ushtria osmane do të ketë ardhur në Dibër duke u nisur nga rruga Shkup-Tetovë-Gostivar-Lumë dhe pastaj në Dibër të Poshtme, në luginën e Drinit të Zi, ashtu siç e kemi përshkruar në studimin tonë të vitit 1979[12].

Sidoqoftë Beteja e Torviollit, siç e kemi thënë është zhvilluar në gjithë territorin e Dibrës së Poshtme që nga Përroi i Xhelagjoshtit në jug të Fushës së Kastriotit e deri në Rrafshet e Shumbatit, [pra në Fushë të Kastriotit, Fushë-Çidhën etj,] por goditja përfundimtare që iu dha nga Skënderbeu, kurthi që iu ngrit ushtrisë turke të Ali Pashës më 29 qershor 1444, është pikërisht tek Ferra e Pashës në Fushë të Çidhnës, pranë Urës së Lushës mbi Drinin e Zi.

Prandaj mbështetur në gjithë sa sipër, dhe kryesisht për faktin se Çidhna është vend origjina e Skënderbeut dhe e Kastriotëve (edhe sot e kësaj dite, në gojën e pleqve të Çidhnës një burim gojor i ardhur nga Selim Noka, qarkullon mendimi se Fisi Gjini i fshatit Kastriot është i një origjine me Kastriotët e me Skënderbeun) është një nga argumentet bindëse që vërteton se nuk ka qenë aspak i rastit kthimi i **Sulltan Mehmetit të Dytë, në gusht të vitit 1466,** gjatë tërheqjes për në Stamboll, një kthim i rrugës nga Elbasani e të vinte në Dibër, madje në skajin më veri-perëndimor të Dibrës së Poshtme, në Çidhën e të bënte një masakër të tillë, që në histori ka hyrë me emrin **Masakra e Çidhnës, duke vrarë mbi 10.000 gra, fëmijë e pleq të strehuar në Çidhën të Poshtme** në qytetin e Çidhnës, me qëllim që të hakmarrej drejtpërdrejt mbi Skënderbeun dhe të afërmit e tij të gjakut, me synim që të zhdukte trojet dhe gjakun e Kastriotëve, pasi aty, siç dëshmohet edhe nga Defteri emëror i vilajetit të Dibrës i vitit 1467, kishte njerëz të fisit të Skënderbeut, si p.sh. Dimtër Kastrioti, në Sinjë të Poshtme etj.

Përfundimisht, duke përforcuar mendimin tonë të shprehur qysh më 1979 se **beteja e parë e ushtrisë shqiptare të komanduara nga Skënderbeu,** ushtria e shtetit të parë kombëtar shqiptar të dalë nga Kuvendi i Lezhës, **i 2 marsit 1444** dhe **e zhvilluar më 29 qershor 1444 në Dibër të Poshtme është pikërisht në Fushën e Çidhnës, tek Ferra e Pashës,** ku u shpartallua ushtria turke e komanduar nga Ali Pasha, i cili shpëtoi gjallë duke u fshehur në një ferrë, pra aty ku u zhvillua ajo betejë që në histori njihet me emrin Beteja e Torviollit, e cila shënon fitoren e parë të ushtrisë kombëtare shqiptare, njëherësh edhe thyerjen e parë të ushtrisë së superfuqisë më të madhe të asaj kohe, **u propozoj organeve kompetente shtetërore** që në kodrën e quajtur **Suka e Arrasit**, në bregun e Drinit të Zi, nën rrezen e së cilës shtrihet gjithë fusha e Dibrës së Poshtme, ku ngjitur me të është dhe Ferra e Pashës edhe Fusha e Kastriotit, **të ngrihet një përmendore, në kujtim të asaj beteje.** Ndërsa përmendores që është në Fushën e Velikardit t'i ndërrohet pllaka, që shënohet emri i Betejës së Torviollit, dhe të zëvendësohet me një pllakë tjetër ku të shkruhet një nga betejat e tjera që është zhvilluar nga Skënderbeu në atë vend (me ato të vitit 1465).

Nuk mund ta përfundojmë fjalën tonë për figurën e Skënderbeut dhe nuk mund të heshtim, kur për Heroin tonë Kombëtar ndeshemi me vlerësime të tilla skandaloze si ai që individë të caktuar, me origjinë etnike të përzier, të papastër, pra, jo tërësisht shqiptare, dhe me synime të caktuara antishqiptare, në kundërshtim me të vërtetën dhe me faktet historike, arrinë deri aty sa që edhe për themeluesin e shtetit të parë kombëtar shqiptar, në Kuvendin e Lezhës të 2 marsit 1444, simbolin kryesor kombëtar shqiptar, kanë shpifur në mënyrën më të paskrupulltë, siç ka bërë Ben Blushi në librin e tij "T jetosh në ishull", kur ka shkruar për Skënderbeun duke e minimizuar në maksimum veprën e figurën e tij. As më shumë dhe as më pak, një veprim i tillë është një atentat dhe krim që i bëhet historisë sonë kombëtare. Pa vijuar më tej me debate të tilla me autorë të huaj si J. Shmidt etj., qëllimet antishqiptare të të cilëve janë të kuptueshme nga gjithkush.

* * *

Meqenëse jemi në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, pa u ndalur në numrin e madh të 16 betejave të Skënderbeut të zhvilluara në trevën e Dibrës, shtojmë se pikërisht këtu në Dibër e kanë nismën edhe shumë beteja të tjera të popullit shqiptar në luftën e tij për liri e pavarësi, jo vetëm kundër pushtuesve osmanë, por edhe kundër pushtuesve të tjerë të mëvonshëm në vitet e Luftës së Parë Botërore, sidomos ata kundër shovinistëve fqinjë serbo-sllavë, të cilët e dogjën tri herë gjithë Dibrën, si dhe pati dy shpërngulje masive të përmasave biblike (1913 dhe 1920), të ngjashme me shpërnguljen e kosovarëve në vitin 1999 nga genocidi serb.

Edhe në vitet e Luftës së Dytë Botërore, rezistenca e popullit të Dibrës jo vetëm kundër pushtuesve nazifashistë, por edhe kundër diktaturës komuniste, ka pasur veçoritë e veta dalluese.

Është për t'u theksuar fakti se gjatë Luftës së Dytë Botërore janë djegur vetëm dy krahina në Shqipëri: Borova në Krahinën e Korçës nga gjermanët, kurse Fushë-Alia e Laçesa dhe një lagje e Blliçes, në Dibër të Poshtme është djegur nga partizanët.

Lufta e klasave në Dibër, veçanërisht në Dibër të Poshtme i ka pas tejkaluar edhe të gjitha caqet e veta të përcaktuara në ligjet e Diktaturës së Proletariatit. Por ajo që është e pakuptueshme për shumë kënd, është fakti se edhe tash 22 vjet të demokracisë Dibra ka mbetur zona më e prapambetur e Shqipërisë. Ndaj natyrshëm lind pyetja: Cili mund të jetë shkaku që këto 60 vjetët e fundit nga të gjitha qeveritë shqiptare, krahina e Dibrës, veçanërisht Dibra e Poshtme, është parë gjithnjë me syrin e njerkës?!

A mos vallë është ndjekur një politikë spastruese, në mënyre që populli i Dibrës te detyrohet t'i braktisë trojet e veta etnike, për të legalizuar në mënyrë "paqësore" projektin e Skavicës, duke asgjësuar kështu njëherë e mirë gjithë pellgun e Dibrës, me historinë dhe qytetërimin e saj, veçanërisht të gjithë fushën (truallin) ku u zhvillua "Beteja e Torviollit" e 29 qershorit 1444. Atë që nuk e bënë dot qindra vjet me radhe pushtuesit e huaj, kërkojnë ta bëjnë sot politikanët tanë!

Prandaj bëjmë pyetjen: A do t'ua falim Dibrën të tjerëve, që ta përdorin atë thjesht për bizneset e tyre?!

Kumtesë e mbajtur në Sesion Shkencor në Peshkopi, më 06 maj 2008

---

1 M. Barleti, "Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut" (Përkthyer nga St. Prifti), Tiranë, më 1967, f. 107.
2 G. Biemmi, "Storia di Giorgio Castriota ditto, Scander-Vegh, Breshia,, 1742.
3 F. S. Noli "Historia e Skënderbeut", Boston Mass, 1921, f. 120.
4 A. Buda "Fytyra e Skënderbeut në dritën e studimeve të reja", "Buletini i Institutit të Shkencave", seria e shkencave shoqërore Tiranë, nr. 3-4 (1951)
5 Selim Alliu – Hilmi Sadiku: "Mbi lokalizimin e disa betejave të Skënderbeut" kumtesë në "Konferencën e Parë Studimore – Shkencore për kulturën popullire në Dibër", mbajtur më 13-14 dhjetor 1976, dhe botuar në "Dibra dhe dibranët" peshkopi 1981, f. 42-45.
6 (S. Alliu, H. Sadikaj, po aty f. 42)
7 S. Alliu – H. Sadiku, po aty, f. 45
8 K. Frashëri, "Ku gjendet Torviolli", "Shkenca dhe jeta", nr. 3 (1975) f. 61.
9 Ali Hoxha, "Mbi lokalizimin e Fushës së Betejës së Torviollit" në "Studime historike" nr. 3, Tiranë 1979, f. 229-236 dhe ribotuar në vëllimin "Studime për epokën e Skënderbeut", Tiranë 1989, Vëll. II, f. 564-572
10 Kristo Frashëri "Skënderbeu jeta dhe vepra" tianë, 2002, f. 138-141
11 Kr. Frashëri, vep. e cituar f. 141
12 A.Hoxha, vep.e cituar.



Gjergj Kastrioti Skanderbeu duke mbajtë fjalim të vetëve. Gravurë gjermane nga Jost Amman.

Skënderbeu në artet figurative

Figura e Skënderbeut u bë një nga temat qendrore tëarteve figurative shqiptare qysh në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Krahas portretit tradicional kthyer në profil të piktorit nga Korça Gjergj Panariti (1883), figura e plotë e heroit mbi kalë dhe në sfond beteja, u trajtua më 1889 nga Anastas N. Ballamaçi dhe Theohar Gjini (1880-1956). Ballamaçi u ndihmua nga tabloja e piktorit francez T. Zheriko.

Nga: **XHELAL ZEJNELI**

Figura e Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe bëmat e tij janë pasqyruar prej kohësh në vepra të pikturës, të skulpturës dhe të gravurës në vende të ndryshme të botës.

Pjesa më e madhe e veprave me vlera artistike dhe historike, si tipare karakteristike, japin një profil të veçantë me sy të gjallë dhe hundë shqiponjë.

Portreti më i hershëm që njihet ndodhet në galerinë Ufici (Uffizi) të Firencës. Mendohet se është mbështetur në vizatimin të bërë drejtpërdrejtë nga natyra, të piktorit venecian Xhentile Benini. Në këtë portret, Heroi Kombëtar i shqiptarëve është paraqitur në moshë të shtyrë, si duket kur e ndërmori udhëtimin e tij të fundit në Itali në vitin 1466.

Vlen të përmendet edhe portreti i shekujve XV-XVI i zbuluar në Shkodër si dhe portreti i galerisë në kështjellën Valdbeng, një riprodhim i të cilit ndodhet edhe në Muzeun e Krujës.

Një portret i hershëm që paraqet rëndësi për tërë ikonografinë e Gjergj Kastriotit, ndodhet në botimin e parë të veprës madhore të humanistit dhe të historianit shqiptar Marin Barletit – "Historia de vita et rebus gestis Scanderbegi" , Romë, midis 1508 dhe 1510 (Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut).

Portretin në gravurë e kanë realizuar edhe mjeshtrit gjermanë si Jang Breu (1533) dhe Jost Aman, po i shekullit XVI. Amani heroin shqiptar e paraqiti me një sfond kështjelle.

Gravura mbi Skënderbeun, më 1577, ka shtypur edhe një piktor tjetër gjerman Sigizmund Fejgrahent. Paraqitja epërkrenares dhe e shpatës së heroit jepet për herë të parë (1539-1552) në portretin të bërë nga Tabias Shtimer.

Në qindvjeçarin XVII e këndej u krijuan portrete të Skënderbeut për t'i ilustruar veprat letrare ose historike. Piktori francez N. Auronks është autor i portretit që u botua në poemën e Bysjerit (1658). Në vitin 1662, kjo poemë u ribotua, por tani me portretin të bërë nga piktori Blanshet. Ndërkaq librin e Biemit, të botuar në vitin 1672, e ka ilustruar piktori italian F. Zuçi (Zucci). Një gravurë në dru bëri I.B. Skotin.

Në vitin 1743 vepra e Barletit u botua në Zagreb në gjuhën kroate. Këtu tani e kemi gravurën në dru të Vajcit (Weitzi). Galerinë e Skënderbeut, me veprat e tyre e kanë pasuruar edhe piktorë të tjerë si Andrea Bianki, J. Fontana, Domeniko Kusto, A. Oslovski.

Për Skënderbeun një numër veprash krijuan edhe piktorët arbëreshë në Itali, si G. Konforti, A. Skurra etj. Një afresk i shekullit XVI ndodhet në një kishë të Monreales në Sicili. Duhet theksuar se në kishën katolike të Prizrenit, në vitin 1878, kur u krijua LidhjaShqiptare e Prizrenit, janë pikturuar me grizaj në dy medaljone, komandanti ushtarak hungarez Jan Huniadi (1387-1456) dhe Skënderbeu.

Figura e Skënderbeut u bë një nga temat qendrore tëarteve figurative shqiptare qysh në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Krahas portretit tradicional kthyer në profil të piktorit nga Korça Gjergj Panariti (1883), figura e plotë e heroit mbi kalë dhe në sfond beteja, u trajtua më 1889 nga Anastas N. Ballamaçi dhe Theohar Gjini (1880-1956). Ballamaçi u ndihmua nga tabloja e piktorit francez T. Zheriko.

Nga plejada e piktorëve që punuan mbi bazën e modeleve, shkoi më tej piktori autodidakt Spiro Xega (1876-1953), autor i një cikli romantik-heroik prej më se tetë veprave. Midis tyre edhe"Skënderbeu" (1913). Me fjalë të tjera, prej tij ruhen mbi dhjetë tablo me figurën e Skënderbeut, disa prej tyre të fillimit të shekullit XX.

Në vitin 1937, në bazë të një gravure evropiane, edhe ikonografi nga rrethi i Korçës Vangjel Zengo (1877-1938) pikturoi disa herë portretin e Skënderbeut, tablonë "Beteja e Skënderbeut me turqit" që ndodhet në Muzeun e Krujës.

Linjën kryesisht origjinale e përbën tabloja "Skënderbeu në betejë" e pikturuar në vitin 1915-1916 nga piktori shkodran Simon Rrota (1887-1961), i cili, në vitet 1910-1915, kishte studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura në Milano. (Mësimet e para për pikturë, S. Rrota i mori nga piktori shkodran Kolë Idromeno, 1860-1939, autor i njërës nga kryeveprat e pikturës shqiptare, portretit "Motra Mone"). Edhe piktori shkodran Ndoc Martini (1880-1917)portretin e heroit e punoi në disa variante – "Skënderbeu".

Në fund të shekullit XIX dhe konkretisht në vitin 1917, pasqyrimit të figurës së Skënderbeut në skulpturë iu çel rruga me bustet e skulptorit dhe të poetit Murat Toptani (1868-1917).

Shprehja figurative e heroit, do të ngrihet më pas në një nga majat më të larta krijuese me bustin sintezë, heroik e legjendar, të punuar nga figura kryesore e skulpturës shqiptare në vitet '20-'80, të shkolluar në Torino të Italisë - Odhise Paskalit (1903-1985). Busti i Skënderbeut, i ngritur në Kukës në vitin 1939, është një kryevepër monumentale, ku format e hiperbolizuara të heroit krijojnë shoqërim përfytyrimesh simbolike. Odhise Paskali, bashkë me skulptorin Andrea Mano (1921-2000) si dhe me skulptorin Janaq Paço (1914-1991), në vitin 1968 realizuan monumentin e Skënderbeut në Tiranë. Me vërtetësi deri në hollësi, siluetat e japin heroin në një lëvizje parade, me shpatën mbështetur anash dhe kokën energjike të ngritur si luftëtar dhe burrë shteti.

Ndër veprat më të shënuara të artit shqiptar pas vitit 1945 me këtë temë, janë statujat ekuestre në Krujë dhe në Tiranë, që mishërojnë realizimin e një dëshire të hershme të popullit shqiptar për ta parë të ngritur në monument figurën e Heroit Kombëtar.

Në pikturën e pas Luftës së Dytës Botërore, në tablotë kompozicionale, me nota emocionale, trajtohet lidhja e ngushte e heroit me masën, epërsia shqiptarëve liridashës. Skënderbeu dhe bashkëluftëtarët e ngushtë të tij, pasqyrohen gjerësisht në artin figurativ shqiptar. Në veprat e Muzeut Historik Kombëtar dhe nëMuzeun Kombëtar – Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në Krujë, afresket, shtatoret, grupi skulpturor e pasqyrojnë heroin si luftëtar, udhëheqës popullor, burrë shteti dhe figurë e pavdekshme e heroizmit popullor.

Në vitin 2001, monumenti i Heroit Kombëtar, vepër e skulptorit Janaq Paço, u vendos në Prishtinë. Ndërkaq, në vitin 2003, shtatorja e heroit, vepër e skulptorëve Muharrem Turkeshi dhe Agim Sela, u vendos në Dibër. Në vitin 2006, monumenti i heroit, vepër e skulptorit Thoma Thomai u vendos në Shkup. Busti i heroit është vendosur edhe në oborrin e gjimnazit "Skënderbeu" të Preshevës.

Monumenti i heroit, vepër e skulptorit italian Romano Romanelli (1882-1969), i ngritur në vitin 1940 ndodhet edhe në sheshin Albania të Romës. Bustit i Skënderbeut ndodhet edhe në Vaccarizzo Albanese – fshat i Kozencës në Kalabri. Në vitin 2008, busti i heroit u vendos edhe në Civita të Italisë.

Në vitet '60 të shekullit XX, emigrantët shqiptarë në Belgjikë paraqitën kërkesë për ta vendosur monumentin e Skënderbeut në Bruksel. Kjo u realizua në vitin 1968. Monumenti u vendos pranë parkut Josafat të komunës Schaerbek në Bruksel.

Monumentet, përkatësisht bustet e Heroit Kombëtar ndodhen edhe në Vjenë, në Budapest, buzë liqenit të Gjenevës, në Detroit etj.

Përmendorja e Skënderbeut në Miçigan të SHBA-së është përuruar në vitin 2006, në prani të mijëra vetëve, përfshi kryepeshkopin e Detroitit - Kardinalin Adam Maida dhe presidentin e Shqipërisë - Alfred Moisiun. Monumenti është vendosur në hyrje të oborrit të Kishës katolike shqiptare Shën Pali në Roçester Hills, rreth 40 kilometra në veri të Detroitit. Përpos monumentit të heroit, në këtë shtet federal ndodhet edhe përmendorja e Nënë Terezës.

(Fryma)

Oferta dhe çmime
të lira çdo muaj

Blloku "Gintash", Laprakë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

etnokulturë

Kanuni me ... këmesë(!)

Nga: **HAKI PËRNEZHA**

Për shkak të aktivitetit të madh kanunor, të mënyrës dhe formave të larmishme në ndarjet kanunore nga pleqtë e krahinës, në Çidhën, janë përdorur emërtime të çuditshme për ti identifikuar a dalluar ato nga moria e varianteve kanunore të përdorura në këtë Krahinë. Emërtime të tilla janë përdorur për disa nga momentet më pikante në historinë e së drejtës zakonore në Çidhën si kanuni në "kalë"; kanuni i "shekës së kosit" apo i "këmesës" etj etj. Këto "pleqërime" që mbajnë vulën e pleqve të Çidhnës, për shkak të origjinalitetit dhe teknikës së përdorur për dhënien e drejtësisë kanë çarë muret e shekujve dhe kanë mbërritur deri në ditët tona. Ato kanë zënë vend në memorien e krahinës duke u bërë hërë pas here objekt diskutimesh apo pjesë e bisedave të ndryshme. Përveç kanunit në "kalë" në të folurën e përditshme të zonës së Çidhnës, dëgjon edhe shprehje të tilla si: "*e ndau me këmesë*" ; "*i ra me këmesë*" apo edhe "*këmesa e Lushës*". Të gjitha këto lidhen me kanunin e bërë nga plaku i Lushës në Çidhën. E veçanta e këtij kanuni është se ky kanun është e ndikuar nga e drejta isalme. Rasti që iu paraqit Lushës për të bërë drejtësi ishte i tillë:

Shumë kohë më parë, në Çidhën një çidhnak kish bërë 15-16 vjet i martuar por nuk kish fëmijë. Shumë miqë e këshilluan që të merrte dhe një grua tjetër. Kështu ai filloi të kërkojë për të gjetur një grua për të "mos shkretë hisen", për të bërë ndonjë fëmijë. Ndryshe këto martesa thirreshin "martesë për hall" dhe shpesh gruaja e dytë që sillej në shtëpi, quhej "grua halli". Ai kërkoi shumë gjithandej dhe më në fund e gjeti një grua e cila ngaqë ishte e plogtë dhe jo shumë e zhvilluar, ishte me të vërtetë grua halli. Gruaja e parë nuk e priti mirë këtë veprim. Çidhnaku ndenji 1-2 muaj në shtëpi dhe hallet ekonomike e detyruan që të marrë rrugën e kurbetit duke lënë në shtëpi dy gratë. Kurbeti asokohe bëhej në Anadoll dhe ishte i vështirë pasi zgjaste 5-10 vjetë. Sapo çidhnaku iku për kurbet, frenat e shtëpisë i mori gruaja e vjetër. Gruaja e re e njoftoi shoqen se ishte shtatzënë. Gruaja e vjetër, inatçore, u hoq sikur u gëzua, por në kokë filloi të ndërtojë një plan. I tha gruas së re se ti do të rrish të bësh punët brenda shtëpisë ndërsa unë ato jashta dhe askuj nuk do ti thuash se je shtatzënë dhe se këtë fëmijë vërtet do ta bësh ti por do të jetë i imi, do ta rris vetë... E reja pranoi. Jeta rrodhi për shumë kohë e qetë. E vjetra filloi të ngjeshë për trupi stela e lecka për tu dukur shtatzënë. Të gjithë që e shihnin e uronin për këtë shtatzëni pas kaq e kaq vitesh. Pas 9 muajsh lindi një djalë. E vjetra ia hoqi nga gjoksi fëmijën duke i thënë se do ta rriste vetë. Djali u rrit dhe së vjetrës i thërriste nënë ndërsa gruas së re "lore". E vjetra e rriti dhe e ushqeu djalin me ndjenjën e urrejtjes për të renë, duke i thënë se " kjo është budalle", "është e trashë" etj,etj. Sa më shumë rritej djali aq më shumë shtohej ndarja në mes grave. Ato u armiqësuan aq shumë sa filluan të gatuajnë veç e veç. Pas 8 vjetësh u kthye nga kurbeti burri i cili përveçse i gjeti gratë në luftë të ashpër me njëra tjetrën, u përballë edhe me një problem të veçantë: secila nga gratë pretendonte se ishte nëna e djalit. Burri u ndodh keq dhe nuk dinte kuj t'i besonte. E vjetra thoshte, e dinë të gjithë se ky është djali im. Ai dëgjonte edhe djalin që i thoshte gruas së parë "nënë". Gruaja e re, me gjysmë zëri, i deklaronte se djali ishte i saj. Burri vendosi që t'i shkojë deri në fund sqarimit të kësaj situate dhe njëra nga gratë duhej të largohej nga shtëpia. Për këtë arsye iu drejtua pleqëve të krahinës. Lusha e mori përsipër zgjidhjen e këtij konflikti familjar. Ai njoftoi të afërmit e secilës grua dhe ditën e caktuar ata ishin të gjithë në dhomën e të zotit të shtëpisë. Lusha kish marrë me vete stërplak Raskën me të cilin kishin përcaktuar se si do të vepronin. Plaku Lusha, pyeti të dyja gratë të cilat secila tha se djali ishte i saj. Atëhere plaku iu kerkoi grave të ulen aty pranë burrave dhe të ndjekin zhvillimin e "gjyqit". Plaku i kërkoi të zotit të shpisë t'i sillte një këmesë dhe një grihën (gurë starlli për të mprehur veglat). I zoti i shtëpisë ia solli dhe plaku filloi të mprehë ngadalë këmesën. Pasi e mprehu mirë e mirë, e provoi me gisht tehun e saj dhe iu drejtua babait të djalit, i cili ishte në dijeni të veprimve të mëtejshme të plakut, duke i thënë: meqënëse gratë tuaja e pretendojnë secila djalin, unë jam i detyruar që t'ua ndaj djalin përgjysmë e secila të marrë nga një pjesë. Stërplaku dhe babai i djalit kapën djalin i cili nuk kuptonte se çfarë po bëhej me të. Lusha u ngrit më këmbë, mori këmesën, e provoi edhe njëherë tehun e saj dhe u drejtua të gjithë pjesëmarrësve: Tani unë do ta presë djalin në dy pjesë dhe secila nga gratë do të marrin nga një pjesë. Në këtë moment, gruaja e re, mjaft e shqetësuar për atë çka mund t'i ndodhte djalit, kërceu më këmbë dhe i kapi këmesën Lushës duke i thënë: **Aman mos e pre djalin, le ta mbajë kjo tjetra, veç mos e pre!** Në këtë kohë plaku lëshoi këmesën në tokë, u ul dhe iu drejtua pjesëmarrësve: djali është i gruas së re pasi ajo pranoi që fëmijën ta mbajë e vjetra vetëm e vetëm që djalit t'i shpëtojë jeta dhe këtë e bën vetëm ajo që është nënë. Problemi mori zgjidhje, e vërteta e mbuluar apo e manipuluar prej shumë kohësh, doli në shesh. Kanuni mbaroi, burrat u shpërndanë ndërsa gruaja e vjetër iku me njerëzit e saj.

Nga ajo kohë shumë ujë ka rrejdhur por kjo formë zgjidhjeje e dhënë nga Lusha bëri jehonë në Krahinë dhe ka mbërrit e freskët deri në ditët tona. Nëpër odat e krahinës, shpesh përdoret shprehjet që lidhen me historinë kanunore të sipërshënuar si "këmesa e Lushës", "e ndau me këmesë" etj. Këto thënie përdoren në ato raste kur dikush don të tregojë për një veprim të pamundur, që nuk mund të bëhet. Sipas kësaj logjike, aq sa mund ta priste Lusha djalin me këmesë aq mund të bëhet edhe kjo punë.

Ka ndodhur nje ngjarje? Keni ndonje shqetesim

per te ndare me komunitetin?

Keni ndonje propozim per zhvillimin e zones suaj?

Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Të nderuar bashkëpunëtorë

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se **5 faqe të daktilografuara** (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat). Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në Word, me fontin **Times New Roman**, të **madhësisë 12pt dhe me hapësirë 1.5.** Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat "ë" dhe "ç".

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: **www.rrugaearberit.com.** Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: për gazetë dhe për internet.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën < rrugaearberit@gmail.com >

Redaksia.

Rruga e Arbërit nr. 71

mjedis



Anëtarë të federatës së pyjeve Dibër gjatë një inspektimi në pyllin e një fermeri privat

Çdo tentativë për të vazhduar mbajtjen peng të pyllit do të thotë vazhdim i shkatërrimit

Pylli i fermerit ka zot fermerin

Pylli ka qenë dhe mbetet pjesa dominuese e fermës dhe burimi kryesor i të ardhurave të banorëve rural nga toka. Deri më tani juridikisht, në rrugën drejt modernizimit, popullsisë sonë nuk po i jepet shansi për tu pronësuar, punësuar, duke kontribuar për të ringritur një sistem menaxhimi, për të prodhuar nga toka e destinuar për pyje e kullota, që aktualisht zë gjysmën e territorit të vendit.

Nga: **HAKI KOLA**

Oferta e Qeverisë për ti gjetur të zotin pyllit

Pyjet shqiptare u shkatërruan, pasi qeveritë shqiptare ndoqën politika te gabuara të pronësisë, dhe shumicën e lanë jashtë menaxhimit në 50 vitet e fundit. Kjo politikë e gabuar i la shqiptarët më të varfër, shkatërroi pyllin e tokën. Fermerit në zona kodrinore e malore i përgjysmoi për më se 50 vjet të ardhurat, pasi i mohoi menaxhimin e pyllit të tij, duke e hequr pyllin nga peshorja e të ardhurave kombëtare. Debati per shkatërrimin e Pyjeve, shkaqet, pasojat shtrihet pothuaj në gjithë hapësiren shqiptare. Kjo dëshmon për ndjeshmërinë që ka shoqëria jonë për këtë pasuri të kombit, që nga mënyra se si është trajtuar historikisht e pamja që ka e dallon krahinën nga krahina, apo fshatin nga fshati, por dëshmon edhe evolucionin e kulturen e cdo komuniteti apo ndërverpimin e kulturës me natyren. Për momentin jetojme një konfuzion të madh kombëtar, si me termin pyll, konceptin e pronësise, te mbarështrimit apo të dëmtimit. Të gjithë janë kundër të gjithëve, e dashur pa dashur fermeret e zonave rurale dhe institucionet pyjore, trajtohen si shkaktarët dhe viktimat e gjëmës që i është shkaktuar natyrës së kombit. Qeveria ka dhënë një sinjal që po i ndjen përmasat e fenomenit të shkatërrimit, e po kërkon rrugëzgjidhjet e mundëshme. Është moment i duhur që qytetarët e hapësirës shqiptare të përfshihen në këtë debat, për ta ndihmuar qeverinë, që të ndërmarrë reformën e duhur. Kjo mund të bëhet duke analizuar ato që i kemi bërë në shekullin e fundit dhe pasojat që i kanë sjelle, tokës, pejsazhit e jetesës. Por duhet edhe të kuptojme me qetësi potencialet dhe pasurinë apo vecorite e saj në cdo pjesë të vendit, traditat dhe gatishmërinë e komuniteteve për të kontribuar për ti rikthyer veshjen drusore tokës tonë.

Toka, natyra e popullsia rurale, gjithmone janë përpjekur për tu pajtuar e bashkëvepruar me zgjidhje te qëndrueshme. Shoqëria jonë, ashtu sic do shoqëri tjeter, ka evoluar në këtë bashkëjetesë me natyren, tokën e druret, si bazen e ezkstences e të ardhmes se saj, duke kombinuar bilancin mes atyre që merr, inputeve sic janë energjia, oksigjeni, ushqimet, lëndët e para, dhe të atyre që mbeten, sic jane mbeturinat, gazi karbonik apo jashtëqitjet, me vetite e sistemeve pyjore për tu rinovuar në mënyrë ciklike. Asgjë e re nuk është thënë, kur pohohet se ata që merren apo inputet, vijnë përgjithësisht nga industritë primare, si bujqësia, pylltaria, apo energjia, e kjo duhet të mbështetet si parakusht, për tu bërë shoqëri e qëndrueshme. Kjo fjalë është mbipërdorur vitet e fundit, por pikërisht pyll i fermerit është një sistem e teknike mijra vjecare plotësisht e qëndrueshme. Për pjesën lindore nga Kopliku në Leskovik, në pjesën më të madhe të familjeve rurale, që nga lashtësia e deri më sot, ferma pyjore, e për labërine ferma kullosore, kanë qenë historikisht më të rëndësihme për jetesën se sa ferma bujqësore. Ndersa ferma bujqesore ne prefekturen e Kukësit, raportohet 0.52 ha per familje, nese do legalizohej bashke me pyjoren e kullosoren do i kalonte tre hektar, ne Puke ferma bujqesore zen rreth 10-15 % te asaj pyjore, ne prefetkuren e Dibrës, ferma bujqesore legale 0.58 hektarë, nese do legalizohej pylli i fermerit siperfaqja e fermes per familje do i kalonte 2.5 hektare.

Pra pylli i fermerit, ka qenë dhe mbetet pjesa dominuese e fermes dhe burimi kryesor i të ardhurës së banorëve rural nga toka. Përkundrazi deri më tash juridikisht, në rrugën drejt modernizimit, popullsisë sonë rurale nuk po i jepet shansi për tu pronesuar, punësuar, duke kontribuar per te ringritur një sistem menaxhimi, për të prodhuar, nga toka e destinuar per pyje e kullota, që aktualisht zën gjysmen e territorit të vendit. Për shkak të shtetit pylli i fermerit, si sistem tradicional, u hijezua e me pas humbi pikërisht në 50 vitet e fundit, bashke me objektet e kultit, e tradita e zakonesh te lashta të popullit, dhe po për shkak të injorancës e papërgjegjësisë së shtetit, shfrytezimi i kësaj pasuri ka disa 10 vjecarë që bëhet spontan e shkatërrues, duke zbuluar, degraduar e eroduar token. Institucionet shkencore e ato administrative si në regjimin diktatorial ashtu edhe më pas, të orientuara përgjithësisht drejt pylltarisë moderne, nuk u angazhuan per ta njohur pyllin e fermerit apo paralajmëruar pasojat e rrëzmit të ati sistemi e shfrytëzimin spontan e në anarshi të plotë të pyllit.

Është e nevojëshme një analizë e reflektim se sa kemi humbur, si dhe të vendosim për të ndaluar degradimin galopant të mjedisit, që po shoqërohet me pasoja të rënda mbi sistemin prodhues të energjise elektrike, atë rrugore, rezervat ujore, me reflektim tepër serioz në të gjithë spektrin e jetës, shoqërore e me dukuri negative që po shtohen progresivisht në vitet e fundit. Jo vetëm që nuk merret biomasë, por pas prerjes drurëve ka filluar degradimi e shkatërrimi i tokës. Kjo po ndodh në sy të të gjitheve, në stadin kur pretendojme se kemi hyrë në rrugën e një shoqërie të zhvilluar e moderne. Ka një mungese e c'orientim total, si për shkaqet, ashtu edhe për zgjidhjet. Ne shkalle kombetare, kemi humbur instrumentin qe e lidh njeriun me trajtimin e kesaj pjese te tokës, prej ku njeriu punësohet e fiton, toka rigjallërohet e prodhon. Toka e gërryer me bimë të sakatuara ka nevojë për dorën e njeriut, me të cilin ka ardhur deri më këtu në një bashkëjetesë mijra vjecare. E që të ringjallet duhet të bëhet e vlefshme për njeriun.

Edhe në angazhimin aktual te qeverise e ne debatin që po e pason, ndërmjet rrjeshtash kërkohet pronari legjitim, pra pronari që ka dokumenta, duke u lënë të kuptohet se pjeses së pyllit që nuk i del pronar me dokumente juridik, do te studjohet që të gjëndët në forma të tjera pronari!!!!???

Shumica jonë është dëshmitare që banorëve që jetojnë në zonat rurale, bashkëudhëtar shekullor me pyllin e kullotën, nuk u është njohur ndonjëherë e drejta ligjore, për të menaxhuar tokën e tyre pyjore e kullosore. Ky nuk është slogan. Ky është fakt, që Shqiptarët banorë të zonave rurale e marrin pothuaj të gjithë drurin për ngrohje, pa sistem menaxhues për të prodhuar këtë mall, si dhe pa leje, me fjalë të tjera, në formë pothuaj ilegale, në mes të ditës, atje ku mundin, pasi pothuaj për cdo fshat apo familje, pronari i pyllit që pas luftës dytë botërore është vetëquajtur shteti, ai qëndror, apo lokal, i cili asnjëherë nuk ka deklaruar , nje plan, se kush ku, sa e si te prodhojë drurin për ngrohje apo gatim . Banorët ruralë e kryejne kete pune ilegale, te sulmuar nga shteti, media, polici gjykatësi apo eksperti, sit ë ishin pushtues të tokës ku banojnë. Ajo pak sasi e pyllit, që shitet në sistem nga shërbimi pyjor i shtetit, shitet me tender. Sasia vjetore e shitur ne 20 vitet e fundit ka qenë për të mbuluar rreth 10% të nevojave të popullsisë. Nuk besoj se e kundërshton njeri argumentin me të cilin u fillua: tokën pyjore shqiptare, që përbën gati gjysmen e atdheut tonë, e kemi aktualisht në përdorim spontan jashtë cdo, kujdestari, sistemi menaxhues apo legal.

Pylli i fermerit - sistem i lashtë silvopastoral

Drurët që i ka falur natyra tokës tonë, janë të shumtë e fort të mësuar për të bashkëjetuar me agresivitetin e njeriut mesdhetar. Ata e popullluan tokën tonë miliona vite para nesh. Më pas erdhen njerëzit. Ata i ngritën banimet e tyre pikërisht rreze drurëve, kryesisht dushqeve, por në rrethana të caktuara edhe me te tjerë. Drurët iu përshtatën ashtu si edhe kafshët e zbutura, kërkesave të njeriut. Ndryshe nga reflektimet e banorëve urban pas prerjes së cdo druri, që gjërësisht e gjykojnë si vdekje të tij, cdo kush që thellohet e ka dije elementare mbi ripërtëritje vegjetative te pyllit e kupton që media ka dhënë lajm të pareferuar qartë, nëse prerja është bërë në pyllin faror apo vegjetativ, druri i pyllit të fermerit, rilind, bile me ritëm të shpejtë rritje, menjeherë pas prerjes, kur është nën kujdesin e pronarit. Banorët lokalë , ndoshta autorë të këtij adoptimi, i mësuan shpejt këto sekrete e lëshime që u bënte natyra, dhe filluan sipas vendit e burimeve natyrore që dispononin, të përshtateshin. Hap pas hapi ata mësuan që llastarët që dilnin, nga cungu ti linin te rriteshin deri në atë dimension që u duhej, duke e ndarë pyllin ne pjese, për të patur për te prerë e lënë per të rritur, ashtu sic ndanin edhe kulloten apo gjerat bazike të ekzistences.

Mrekullia qëndron në faktin, që rrënjët e këtyre drurëve, apo më sakte llojet drusor përbërës të këtyre pyjeve, janë pothuaj ata që e kanë populluar që nga fillimi tokën tonë, pra janë lloje natyrore e autoktone, pasardhës të pyllit të virgjër, që vuri në trajtim njeriu primitiv. Ky pyll ka ndryshim esencial, nga pyllëzimet që ka bërë shteti, psh me pishë, akacie apo plep, pasi në këto raste është mbjelle dhe eshte imponuar për tu rritur një lloj pyjor që nuk e ka patur më përpara vendi, ashtu sic mbillet përshembull misri apo patatja, që janë të ardhur nga kontinentet e tjera.

Këto sisteme u përshtatën, në përputhje me rrethanat e vend banimit, si thjeshtë për prodhim materiali drusor, me rotacione, sasi e dimensione të deshiruara, ashtu edhe duke kombinuar, prodhimin e drurit, me bazën ushqimore e kullotjen e blegtorisë. Këto sisteme menaxhuese kanë arritur deri në ditët tona. Duket si detaj shpjegimi i tyre, por vetë konfuzioni dhe moskuptimi nga politikë bërësit e bën të domosdoshëm tregimin e këtyre detajeve, jo fort të deshiruara, shpesh fort të kritikuara si kasaphana, nga administrata dhe ekspertet e pyjeve. Ky sistem prodhues, për banorët ruralë, ngjante me një fabrikë të thjeshtë, që harxhon kohë për tu ngritur e më pas prodhon në vazhdimësi. Ishtë një projekt shumë fleksibël, që cdo familje, e adoptonte lehtë, duke tentuar që për cdo vit të punonte në nje pse të territorit (shpesh një te treten), që i ishte pranuar nga fqinjët bashkëfshatarë, ku sipas rretanve kishte vënë edhe kufinj, të cilët sot e kësaj dite qëndrojnë në tokë, por nuk janë legalizuar apo njohur nga shteti.

Si u ngrit pylli i fermerit?

I bazuar në manipulimin me prerje vegjetative, varësisht kushteve ekologjike, pjellorisë së tokës, llojit të drureve, e nevojave të fermerit, sistemi merrte, emertimet përkatëse si kashnjet, hamalle, prozhem, zabel, ograjë, kojrie, mal. Në esencë synimi ishte që materiali drusor te prodhohej për cdo vit, si gjatë ngritjes ashtu edhe pas stabilizimit të sistemit i cili ishte shume fleksibel e dinamik. Ajo që druri i sapoprerë len trashëgim janë llastaret që dalin nga cungu apo rrënjet e prindit. Që në lashtësi fermeri e dinte këtë dhe në mvartësi të qëllimit që kishte, nëse do bënte vend për kullotje, bazë ushqimore për dimër e prodhim

cyan magenta yellow black



© Foto: Rexhep Ndreu

druri, i duhej që pas tre viteve që u linte llastareve për tu rritur, ti rrallonte ata fort, duke marre prodhimin e parë, e duke lënë një numër të caktuar për të shkuar në lartësi. i rikthyer në këtë vend pas tre vitesh të tjera, kur druri "për mbarë" kishte mbushur 6 vjet, fermeri përseri bente prerje të gjithe llastareve të rritur gjatë trevjecarit, poshte "drureve të lënë për mbare". Tani ishte e mundur që, edhe "drurëve për mbare" tu bëhej trajtim, duke u prerë deget e krijuar nyjet prodhuese, që te fillonin prodhimin në disa kate, përgjithësisht mbi lartësinë një bojë njeriu, për të prodhuar dege e gjeth periodikisht në cdo tre vite.

Në momentin e sapo prerjes, i gjithë ndricimi i diellit në pranveren pasuese arrinte në toke, duke stimuluar celje të shumë barërave e llastarëve drusor, duke u shëndrruar në kullotë për gjithe llojet e blegtorise. Për kafshet e egra, gjitare, zogj e të tjerë, dukej tepër e preferuar, pasi në hapësira të ngushta krijonte celtira e vend strehime si dhe ushqim shumëllojesh. Ndricimi vente në pakesim deri në vitin e trete, ku tashme prodhimi sigurohej nga "druret permbare" që ishin rritur e me prerjet e bera ishin imponuar per te krijuar, arkitekture special të kurores në disa kate, me disa gunga prodhuese ku takoheshin e ndaheshin druri i ri që vilej periodikisht, me te vjetrin që në një anë prodhonte për pronarin në tjetren rriste katet e dimensionet e trupit te tij, që lidhte tokën me diellin, një system qe jepte kullote për cdo vit, e biomase per ushqim e energji ne cdo tre vjet. Në dimër gjethi ushqente në grazhd blegtorinë, pjesa e drunjte digjej ose përdorej për nevoja të tjera të fermës. Ky sistem primitiv prodhues, që kërkonte përkushtim të përvitshëm e volum të konsiderueshëm pune, nga ana tjeter siguronte shumicën e drurit për ngrohje e nevoja të tjera për shumicën e familjeve të zzonave kodrinore malore, ka funksionuar në shumicën e zonave rurale me dimër të ftohët e me borë, që kur njeriu filloi të ushtronte parabujësine primitive, që studimet arkeologjike ne evrope e datojnë mbi 6000 vjet e deri në vitet 1950-1980, kur shteti filloi kolektivizimet, zhdukjen e trashëgimise fetare, si dhe të traditave e zakoneve të vjetra të jetesës, duke e futur për fat të keq edhe këtë system në listen e zezë, ndoshta ngaqë ishte rregulluar me kanunet e maleve që konsideroheshin të papranueshëm!!!??? e duke i dhënë goditijen finale me tufëzimin e blegtorisë dhe centralizimin e gatimit të bukës së fshatit. Për fatin e keq si të fermerit ashtu edhe te pyllit, në të shumtën e herës si shtëpinë ashtu edhe tokën e pyllit, kolektivizivimi apo tufëzimi, ia gjeti pa dokumente ligjore. Meqenëse shtepia nuk arriti të tufëzohet, shtepia shpëtoi, ndërsa blegtoria pothuaj u zhduk e rikrijua, për pyllin kalvari vazhdoi, dhe sistemi ashtu si në heshtje u fut në listen e zezë të traditave e zakoneve prapanike. Evropa e pati përdorur këtë sistem deri në shekullin e XIX, si për shkrirje mineralesh, ngrohje e vende vende blegtori, zbulimi i qymir drurit, e gazsjellesat e konkuruan ne treg, e pylli u pershtat per të prodhuar lëndë punimi, leter, ajër e uje. Te gjithe pyjet vegjetative apo cungishtet kanë një gjë të përbashkët, -ata priten në mënyrë të përsëritur, me pritjen e arsyeshme që drurët do të rriten përsëri pa ndihmën e askujt, me kushte mos dëmtohen filizat që celin nga cungu. Nëse kjo gjenerate që fillon menjeherë rritjen vjen nga llastari i cungut, i rrënjës apo fara, kjo nuk është esenciale, esenciale është që mbulesa e re formohen në kohë të shkurtër, dhe për pjesën dërmuese vegjetative, e vetmja punë që harxhohet është vjelja e prodhimit drusor. Procesi është deri në infinit i përsëritshëm. Ka territore ne Europe që jane ricunguar për periudha shumë të gjata, të jetës së tyre shpesh për qindra apo mijra vite. Në cungishte e menaxhuara, për cdo vit priten 0.5-10% të sipërfaqes, ndërsa tek pyjet e lartë natyror 0.5-2% të tyre. (Buckley 1992). Në Shqipëri, me shtimin intensive te popullsise ne shekullin e kaluar, si dhe per mungese te gazit natyror, apo alternativa të tjera për ngrohje, kerkesa ne treg është shtuar me shume se kurre. Sistemi i krijuar nga fermeri, prodhon shpejt e lire, pasi është afer, nuk harxhon lëndë djegëse për transport, drurët janë të holle e priten me lejtë. Shaktërrimi e abondonimi i sistemit, e orientoi kërkesan e lartë për dru për ngrohje drejt pyllit të larte e vecanërisht Pyjeve të ahut. Ky i fundit i menaxhuar historikisht me objektiva krejt të ndryshme e me afate te gjata kohore, u pre dhe u shkatërrua pothuaj totalisht.

(Vijon numrin e ardhshëm)



Rruga e Arbërit nr. 71
kujtesë



Dikush tha se i ka marrë një anije e huaj. Dikush thotë se janë burgosur në një vend të huaj. TVSH tha se ekspertët shqiptarë më 18 mars kanë shkuar në Itali për të ndriçuar ngjarjen.
Që atëherë heshtet...

Prokuroria e rrethit Vlorë ka nisur procedimin penal për këtë çështje të cilën e ka pezulluar në 10 tetor 1996. Personat që kanë luajtur rolin e sekserëve në grumbullimin e njerëzve, janë amnistuar në vitin 1997 nga presidenti i asaj kohe.

Kronika nga dhimbja e dibrane e 9 marsit '96

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

LAJMI I ZI

Lajmi i zi arrin në Maqellarë. Ko misariati i Vlorës njofton komisariatin e Peshkopisë se një djalë i ri nga Maqellara e Dibrës është gjetur i vdekur në breg të detit, nxjerrë nga valët e ftohta të tij.

Njerëzit e familjes, me dhimbjen e madhe për njeriun e tyre të dashur nisen për të marrë djalin e vdekur. Në Vlorë mësojnë se kufoma nuk është gjetur në brigjet e detit shqiptar por në anën tjetër të detit, në brigjet e Otrantos.

Në Maqellarë të Dibrës është hapur mort. Familja Qoku pret e përcjell njerëz, pret të vijë djali i tyre i shtrenjtë.

Por në Maqellarë tmerri i vdekjes është më i gjerë, më i madh, i pranishëm në dhjetëra familje. Kjo lidhet me faktin se njëkohësisht me djaloshin Qoku janë nisur në drejtim të Vlorës, e më tej me gomone në drejtim të Italisë, tre mikrobusë me djem të rinj, rreth 30 vetë. Deri tani për ta nuk ka asnjë lajm, asgjë që të qetësojë zemrat e ngrira nga tmerri të nënave, baballarëve, motrave, grave, fëmijëve, të afërmve të këtyre familjeve.

Një djalë i ri është gjetur i vdekur në brigjet e detit italian. Dhjetëra djem të tjerë nuk dihet ku janë, nuk dihet në se kanë arritur në brigjet e ëndrrës së tyre për një jetë më të mirë apo i kanë përpirë dallgët e zeza të detit. Familjet pranë zyrave të postë telekomunikacionit pyesin në adresa të ndryshme në shtetet fqinj dhe nuk marrin përgjigje.

Duke uruar që djemtë të kenë arritur shëndosh e mirë në Itali e familjet e kësaj zone të mos shohin gjëmë e kob, Maqellara kërkon të hidhet zyrtarisht dritë mbi këtë ngjarje të rëndë, të qetësohen zemrat e ngrira të prindërve.

Peshkopi, 13 mars 1996

KU JANË DJEMT E DIBRËS?

Lajmi i kobshëm, ardhur nga brigjet e Otrantos në komisariatin e Peshkopisë më 11 mars 1996 helmoi së pari familjen e Zaudi Qokut në Kllobçisht të Maqellarës. Djali i tij është gjetur i vdekur në brigjet e Otrantos. Me preokupimin e njerëzve të gjakut e në veçanti të deputetit Agron Qoku, trupi i pajetë i Sulejmanit u soll në Maqellarë për tu prehur në tokën mëmë. Por ndryshe nga dymbëdhjetë viktimat e tjera që këto vite me vdekjen e tyre në një moshë fare të re kanë përcjellë lot e dhembje në familjet e dhe të afërmit e tyre (djem nga Kllobçishti, Katundi i Vogël, Maqellara, Grazhdani etj.) vdekja më e re përcolli një dhimbje të padëgjuar ndonjëherë. Flitej se së bashku me Sulejmanin, të shtunën e zezë të 9 marsit, nga brigjet e Karaburunit ishte nisur një skaf me rreth 30 djem nga Maqellara dhe fshatra të tjerë të komunës së Melanit, Tominit etj.. Lajmi konfirmohej nga disa djem të rinj që nuk kishin mundur të udhëtonin me skaf ditën e parë. Në pritje të skafit pasi, kishin marrë vesh lajmin e humbjes së tij, ishin kthyer pranë familjeve për ti qetësuar.

Lajmi u përcoll nga disa gazeta. Vetëm gazeta dhe media zyrtare heshtën (!)

Njerëzit me mjetet dhe rrugët e tyre u vunë në kërkim të djemve të humbur. Telefonat, në drejtim të Italisë dhe Greqisë nuk reshtën ditë e natë. Në këtë kërkim u përfshinë drejtues të pushtetit lokal, ministra e deputetë. Shqetësimi iu bë prezent edhe një ekuipazhit të një helikopteri të IFOR-it që zbriti në qytetin e Peshkopisë për të sjellë ndihma për spitalin pediatrik.

Heshtjen që përsëriste lajmet e ndryshme e theu më në fund ajo që duhet ta kishte thyer e ndjekur ditë për ditë, që nga 9 marsi e në vazhdim.

Ministria e brendshme më 27 mars njofton se më 19 mars në bregdetin e Otrantos, është gjetur kufoma e një djali tjetër, i pa identifikuar, njeri prej 29 dibranëve të larguar në drejtim të Italisë më 9 mars.

Lajmi ka tronditur Dibrën. Shpresat e përcjella në lajm se djemtë e Dibrës kanë përfunduar në Korfuz të Greqisë është venitur.

Lajm më të kobshëm, dhimbje më të madhe Dibra nuk ka përjetuar ndonjëherë.

Urojmë që ai të jetë i rremë dhe djemtë e saj të kthehen tek nënat, motrat, nuset, fëmijët, të dashurit e tyre që i presin me lot në sy.

Peshkopi 28 mars 1996

MOS JENI ATO TË 9 MARSIT?

14 marsi, dita kur fëmijët bëjnë ritet e Ditës së Verës, kur nuset dhe vajzat e reja sjellin në shtëpi ujin e kristaltë të krojeve, ky 14 mars, këtë vit, fushën e Maqellarës e gjeti nën dëborë. Poshtë saj nxinte toka e mbi të rëndonte i plumbtë qielli...Por më i zi e i rëndë se plumbi erdhi në familjen e Ziaudin Qokut në Kllobçisht lajmi i kobshëm se djali i tij 20 vjeçar, Sulejmani, i sapomartuar, humbi jetën në det, duke kaluar me skaf për në Itali...

Djemtë e Maqellarës, mjeshtra në bujqësi e punëtorë të fronteve më të vështira në minierë e gjeologji, mbetur pa punë, u janë drejtuar rrugëve të kurbetit, rrugëve të Maqedonisë, Greqisë, Italisë. Vetëm në një vend në rrethinat e Napolit punojnë më shumë se njëmijë maqellaras. Vendi ku punojnë më shumë thirret Santa Maqellara, se sa me emrin e vet, Santa Maria.

Dhe ndodhin ngjarje të kobshme...

E prapë emigrimi vazhdon. Rendin të rinjtë maqellaras drejt shpresës së madhe si fluturat drejt dritës, ndonëse si fluturat edhe digjen. Mjaft prej tyre kthehen me ndihmat e bashkëkombësve, me ndihmat e qytetarëve të mirë italianë. Listat, me emrat e njerëzve nga e gjithë Shqipëria, lexuar nën lotët çurkë para varreve, sa vijnë e shtohen. Djemtë kthehen në arkivole druri e metali. Ndodh që nuk kthehen as të vdekur...

Trupi i pa jetë i Sulejmanit u preh në gjirin e vendlindjes.

Për djelmoshat e tjerë, 29 a më pak, kryesisht maqellaras, që ishin në të njëjtin skaf, asnjë lajm, asnjë shenjë. Dikush tha se i ka marrë një anije e huaj. Dikush thotë se janë burgosur në një vend të huaj. TVSH, tepër thatë, dy javë më pas njoftoi vdekjen e S. Qokut dhe të një viktime të pa identifikuar. Tha se ekspertët shqiptarë më 18 mars kanë shkuar në Itali për të ndriçuar ngjarjen.

Që atëherë heshtet...

Ankth dhimbjeje dhe pritjeje, vegim shprese në familjet e 2 vëllezërve në Burim, të 2 vëllezërve Elezi në Vojnikë, të njerëzve të një gjaku e të një moshe në Kllobçisht, Majtarë, Burim, Vojnikë, Maqellarë, Grevë, Melan, Trepçë, Rashnapojë, Brezhdan...

Dhembje pritjeje e pranishme në çdo familje dibrane...

Emigrantët në Itali pyetjen e parë për ikanakët e kanë "Mos jeni ato të skafit të 9 marsit..."

Maqellarë 15 maj 1996

PAS NËNTË VJETËSH... KAFE E HIDHUR NË BREZHDAN

Ministri i Rendit Publik, Igli Toska, ka shkuar sot paradite në Maqellarë të rrethit të Dibrës, për të informuar familjarët e 29 personave të humbur në 10 mars të vitit 1996 në detin Adriatik, mbi përfundimin e hetimeve të bëra nga strukturat e Policisë së Shtetit mbi fatin e këtyre personave.

Në përfundim të hetimeve rezultoi se të 29 shtetasit nga Maqellarra e Dibrës dhe tre personat që drejtonin skafin nga Vlora janë mbytur. Nga kontrolli i dokumentacionit përkatës rezultoi se në vitin 1996 Policia Italiane ka njoftuar Policinë e Vlorës për gjetjen e dy kufomave me emrat Sulejman Qoku dhe Petrit Qoku nga fshati Kllobisht i Maqellarës dhe më pas edhe katër kufoma të tjera të cilat nuk mund të identifikoheshin për shkak të dekompozimit.

Prokuroria e rrethit Vlorë ka nisur procedimin penal për këtë çështje të cilën e ka pezulluar në 10 tetor 1996. Personat që kanë luajtur rolin e sekserëve në grumbullimin e njerëzve, janë amnistuar në vitin 1997 nga presidenti i asaj kohe.

Sot ministri i Rendit Publik shkoi në familjen e Abdulla Hakorja, i cili ka humbur djalin në këtë ngjarje tragjike, ndërsa u ka dhënë familjarëve lajmin e hidhur ka qenë i pari që i ka ngushëlluar sipas zakoneve të vendit. Ministri Toska ka premtuar në emër të qeverisë se do të shihen të gjitha mundësitë për të ndihmuar financiarisht fëmijët e viktimave.

Tiranë, 29.03.2005

(Shkëputur nga libri në dorëshkrim "Tragjedi dibrane")

Otranto, port i dhimbjes dhe shpresës

Një këngë beratase Kushtuar të rënëve të Dibrës....

Një fjongo të kuqe ia vura detit
Mbi kaltërsi dallgësh
dhimbja e kuçedra m'u shfaq.
Një nënë dibrane mes odës lëshon piskamën
Kurorë e blertë
s'ka e s'ka duar foshnjërisht ta mbajë.
Një foshnje luan symbyllur me vdekjen
Nga gji i ftohtë thith jo tambël, por gjak.
Baladë vërtet e gjallë.
Dramë e tragjedi moderne me valle vdekjen mbi dallgë.
Një burrë krahët zgjat
e nuk mundet të ndihmojë vëllanë sadopak.
Otranto e Zezë.
Ti, Port i Dhimbjes, ti, Port i Shpresës, ti, Port i Valëve.
S'e dinim që më ëndërr makabre
do të na shfaqeshe një ditë, një çast.
Otranto e zezë.
Otranto e blertë që na veshe në zi.
Për vdekjen u ktheve në djep
Oi...oi...oi...
Pas nëntë malesh
Kullë më kullë Dibra mortin dhëmbë shtrënguar e hap.
Këngëligjet
me çarçafë të zinj bjeshkët e dheun e ugarit mjegullojnë.
E marsi i Otrantos
lule rudine, e gjeth, e drurë gjer në palcën e rrënjës i than.
E valët e Shpirtit
brigje të rinj këngësh symbyllur kërkojnë e kërkojnë.
Pranverë me lule mollësh
donin të na i linin me Dimrin nga mot përqafuar.
Në ca udhë mërgimtare
mbi Fushë të Korabit u rizgjoka malli i patretur
Bëjeni një lapidar të blertë
në mes të detit, me stërkala ëndrrash plaguar si zjarr i pashuar.
Në librin e Historisë dibrane
Monumentit të kujtesë le t'i përulemi dhe sot dhe nesër.
O zot, mos më keq!
Mos të pafsha më, o Ditë e marsit në Otranto!

NAMIK SELMANI, shkrimtar

sociale

15 Marsi "Dita Botërore e Konsumatorëve"

Nga: **HAJREDIN TOCA**



Më 15 mars 1962 ish-Presidenti amerikan John F. Kennedy ka thënë: "Konsumatorët nga përkufizimi përfshijnë të gjithë ne. Ata janë grupi më i madh ekonomik, duke ndikuar dhe ndikohen nga pothuajse çdo vendim publik dhe privat ekonomik. Megjithatë ata janë grupi i vetëm i rëndësishëm ... pikëpamjet e të cilit nuk janë dëgjuar shpesh". Dhe John F. Kennedy formuloi katër të drejta për konsumatorët:

-të drejtën për siguri,
-të drejtën për t'u informuar,
-të drejtën për të zgjedhur,
-të drejtën për t'u dëgjuar.

Në përkujtim të kësaj ngjarje, kjo ditë festohet si Dita Botërore e të Drejtave të Konsumatorit, qëllimi kryesor i së cilës është të nxjerrë në pah të drejtat e konsumatorëve dhe të dyja sëbashku, atë në mes të konsumatorëve dhe bizneseve.

Por 15 Marsi është dhe Dita Evropiane e Konsumatorëve!

Këtë vit, për herë të parë, Komisioni Evropian, filloi një nismë për të festuar 15 Marsin si "Dita e Konsumatorit Evropian", si një mjet për të diskutuar dhe promovuar mundësitë e ofruara nga anëtarësimi në BE për konsumatorët.Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe nxitja për rritjen e mirëqenies së tyre, përfaqësojnë vlerat themelore të Bashkimit Evropian, ndërsa një nga qëllimet kryesore të mbrojtjes së konsumatorit është të lehtësojë përdorimin aktiv të mundësive në dispozicion të konsumatorëve në tregun e brendshëm.

Për të realizuar këto të drejta të konsumatorëve u themelua në vitin 1960 Federata Botërore e të drejtave të konsumatorit "Consumers International" (CI) me qendër në Londër. Sot ka 220 shoqata anëtare të saj, nga 115 vende të botës të cilat shërbejnë si zë i vetëm i pavarur dhe me autoritet botëror për të drejtat e konsumatorit.

Dhe me punën e saj 50 vjeçare CI i çoi në tetë të drejtat themelore të konsumatorit, të cilat janë:

1. E drejta e plotësimit të nevojave themelore - të kenë ushqim të mjaftueshëm, veshmbathje, strehim, kujdes shëndetësor, arsim, shërbime publike.

2. E drejta për të qenë të sigurtë - për t'u mbrojtur kundër produkteve, proceset e prodhimit dhe shërbimeve të cilat janë të rrezikshme për shëndetin ose jetën.

3. E drejta për t'u informuar - për të marrë faktet e nevojshme për të bërë një zgjedhje në bazë të informacionit, dhe për t'u mbrojtur nga reklamat e pandershme ose mashtruese dhe etiketimin.

4. E drejta për të bërë zgjedhje - të jetë në gjendje për të zgjedhur nga një gamë e produkteve dhe shërbimeve, të ofruara me çmime konkuruese me sigurimin e cilësisë të kënaqshme

5. E drejta për t'u dëgjuar - në bërjen dhe zbatimin e politikave qeveritare, si dhe në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve.

6. E drejta për t'u dëmshpërblyer - për të marrë një zgjidhje të drejtë jo vetëm të kërkesave, apo për prezantimin e rrejshëm të mallrave dhe të cilësisë së ulët ose shërbime të pakënaqshme, por duke përfshirë edhe kompensimin, dëmin e shkaktuar.

7. E drejta për t'u arsimuar- të fitojë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të bërë të mundur marrjen e informacionit, për të bërë zgjedhje të sigurt për mallra dhe shërbime, duke qenë të vetëdijshëm për të drejtat themelore të konsumatorit dhe përgjegjësitë dhe se si të veprojnë me to.

8. E drejta për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm- pra të jetojnë dhe punojnë në një mjedis që është jo-kërcënues për mirëqenien e brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Edhe në vendin tonë që në vitin 1990 filloj lëvizja për mbrojtjen e konsumatorëve e përfaqësuar nga "Shoqata e Konsumatorit Shqiptar"."ShKSh", është themeluar në vitin 1990 nga Dr. Islam Cani dhe një grup nismëtarësh që e njihnin lëvizjen për mbrojtjen e konsumatorit. Është shoqatë e pavarur dhe ka si mision dhe qëllim të saj, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorëve shqiptar.

Nga Tetori i vitit 1993, SHKSHja është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Konsumatorit (CI) dhe ka bashkëpunim me organizata të tjera të përafërta në vend si dhe me ato homologe në botë.

Gjatë 22 viteve SHKSH ka ngritur zërin për të mbrojtur konsumatorin që t'i plotësohen të drejtat, ka zgjidhur mosmarrveshje në mes konsumatorëve dhe bizneseve dhe ofruesve të shërbimeve.Ka punuar në të gjithë vendin për edukimin e konsumatorit që ai të dijë dhe të kërkojë plotësimin e të drejtave. Dhe me kontributin e saj sot kemi "Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit" të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 1997.

Tema për Ditën e të Drejtave të Konsumatorit Botëror (WCRD) në vitin 2012 është:

"Paratë tona, Të drejtat tona: fushatë për marrëveshjen më të mirë në shërbimet financiare".

Më 15 mars 2012 lëvizja globale e konsumatorëve do të jetë e bashkuar për të kërkuar shërbimin më të mirë dhe me kosto sa më të ulët për konsumatorët në fushën e sistemit financiar.

Të kërkosh të zgjedhësh, është një e drejtë themelore e konsumatorit.

Konsumatorët në mbarë botën janë duke u përballur dhe janë duke marrë marrëveshje të këqija nga shërbimet financiare.

Për shembull, konsumatorët shpesh kanë vështirësi të kuptojnë produktet e ndryshme financiare, qoftë për shkak të mungesës së informacionit apo dhe për shkak se vetë produktet janë shumë komplekse, ose të dyja së bashku.

Gjithashtu edhe thjesht se nuk ka institucione të mjaftueshme financiare në treg për të siguruar një konkurencë që për konsumatorët do të bëhej më mirë.

Kjo është e vërtetë edhe për vendin tonë për të gjitha llojet e shërbimeve financiare - nga llogaritë bankare, kreditë si dhe për transfertat e parave.

Kush ka një llogari bankare konstaton se paguan shumë komisione në një kohë që sot duhet të gjithë të veprojnë me bankë dhe jo me para të thata në dorë.Bankat vendosin në ambjentet e tyre lloj lloj fletëpalosjesh ku bëjnë thirrje klietëve që të marrin këtë shërbim apo atë shërbim.Por kur janë pyetur konsumatorët se nëse i kuptojnë këto fletpalosje pjesa më e madhe janë përgjigjur jo.Në to shkruhet vetëm reklamë kurse pjesa e komisioneve të llogarive në disa banka ose institucione financiare vendoset në stenda dhe me shkronja të vogla që mezi lexohen, në disa të tjera duhet të shkosh të pyesësh një specialist të bankës. Ne konstatojmë se jo të gjithë klientët kanë formimin e duhur arsimor për të kuptuar se si veprohet me një llogari bankare rrjedhëse apo depozite.Prandaj një thjeshtësi dhe qartësi për komisionet e llogarive duhet në nivelin e konsumatorit.

Edhe në rastin kur klienti ka informacionin e duhur dhe kërkon të lëviz fondet e tij nga një bank në një bank tjetër i duhet të paguaj një komision të lartë, dhe konsumatorit i duket më me leverdi t'i marrë ato në dorë dhe t'i dërgojë ato po në dorë tek banka ku ka një veprim për të kryer.Në këtë rast ne konstatojmë se ka shkuar dëm gjithë puna e bërë nga Banka e Shqipërisë për të zvogluar përdorimin e parasë jashtë bankave.Por konsumatori rrezikohet shumë dhe nga pasojat që mund t'i vijnë nga kjo lëvizje me para në dorë që vjen nga komisioni i lartë që aplikojnë bankat.

Kush merr një kredi, (në e marrtë dhe atë), pak informohet, si për komisionet dhe për ndëshkimet që e presin në rast mosplotësimi të pikave të marrveshjes së kredisë. Interesi i kredisë më larti se kudo e krahasuar kjo dhe me vendet e rajonit, kushti i monedhës në të cilën jepet kredia është një element tjetër që rëndon konsumatorin sepse të ardhurat i ka në lek dhe kredia i afrohet në euro, dhe garancia për kredinë është aq e madhe sa duhet edhe shtëpia e komshiut për të marrë me kredi shtëpinë tënde.

Pastaj kemi transfertat e parave me të cilat jetojnë një pjesë e madhe e shqiptarëve dhe sidomos konsumatori që me atë dërgesën që i vjen kalon muajin.Dhe dëmi është i familjes këtu se dërguesi i parave është antar i kësaj familje.

Por dhe kush bën një transfertë parash nga Shqipëria për në çdo vend të botës, për fëmijën që e ka për studime, për një të sëmurë që e do jetën e familja e do atë, ai, pra konsumatori shqiptar, paguan më shumë se pjesa më e madhe e të gjithë vendeve të botës.

Transfertat e quajtura të shpejta në Shqipëri bëhen nga dy shoqëri "Western Union" dhe "MoneyGram". Po japim një shembull: Që të dërgosh nga Shqipëria për në çdo vend tjetër të botës 200 euro duhet të paguash një komision nga 16-22 euro ose sa 8-11% e shumës së dërguar.Ndërsa nga Britania për t'i sjell në Shqipëri për 200 euro paguhen vetëm 9.9 euro ose 4.95% e shumës që do të arrij.

Dhe diferenca është 2 herë më shumë për një shqiptar. A nuk është shokuese për nivelin e konsumatorit shqiptar që dëshiron të shkollojë fëmijën në perëndim, që dëshiron t'i shpëtojë jetën njëriut, të afërm të tij.

Dhe vetëm kaq mjafton për të kuptuar se sa dëmtohet konsumatori shqiptar nga mungesa e konkurencës si dhe nga mungesa e mbikëqyrjes së tregut transfertave.Për këto e shërbime të tjera SHKSH ka marrë rreth 60 ankesa nga konsumatorët si për mbajtjen jo mirë të llogarisë, llogaritje jo sakt të interesave dhe ndryshim intersi pa njoftim, shkelje të kontratave, mosdhënjekredie, komisione të larta etj.Për pjesën më të madhe kemi kërkuar sqarimin dhe zgjidhjen e ankesës tek operatorët e tregut financiar të cilët jo gjithmonë japin zgjidhje siç duhet.

Pra për t'ju përgjigjur pyetjes se si po e pret 15 Marsin Konsumatori Shqiptar, detyrohemi të themi se përveç krizës, që edhe më fanatiku tani e ndejn mbi kurrizin e vet, ka dhe mangësi të theksuara në fushën e shërbimeve bankare dhe se është shumë larg me standartet e vendeve europiane ku ne po shkojmë.

Prandaj ne konsumatorët shqiptarë t'i bashkohemi kësaj lëvizje botërore në Ditën e Konsumatorit për të ndikuar tek Banka e Shqipërisë dhe Mbikëqyrësit e tregut financiar që të ulen komisionet me qëllim që konsumatori ti afrohet sistemit financiar më shumë dhe t'i largohet përdorimit të parave në dorë.

Ne duhet t'i bashkohemi objektivit të G8 që për transfertat e parave deri në nivelin e 200 eurove komisioni të jetë në nivelin e 5% të shumës së transferuar.

Shoqata e Konsumatorit Shqiptar do të ngrej zërin pranë Qeverisë, Bankës së Shqipërisë, Institucioneve Mbikëqyrëse,për ankesat e konsumatorëve ndaj operatorëve në tregun e shërbimeve financiare.Si dhe do të kërkojmë përmirësimin e paketës së shërbimeve në të gjithë teritorin e vendit pasi zonat larg qendrave të qyteteve nuk marrin shërbim financiar.

** Specialist për problemet financiare pranë SHKSH*

B A S H K Ë P U N O E D H E T I
< r r u g a e a r b e r i t @ g m a i l . c o m >

Mësimet dhe dështimet e UNMIK-ut për shtetformimin e Kosovës

Nga: **Prof. Dr. BASHKIM RAMA**

Kur shtetet perendimore "e derguan" NATO-n ne lufte per Kosoven, donin qe misioni i administrates nderkombetare te ishte i suksesshem. Per kete arsye***, bashkesia nderkombetare investoi ne Kosove 25 here me shume para dhe dergoi 50 here me shume trupa, se sa dergoi,gjate te gjithe kohes, ne Afganistan.*** Por, megjithe perkushtimin, perpjekjet dhe investimet, ne disa ceshtje, bazuar ne standartet, qe kishte percaktuar vete, misioni deshtoi. Per kete, kerkohet nje shpjegim.

Ndoshta, ambiciet e Misionit nderkombetar ishin jorealiste, ne fillimet e veta. Teorite argumentojne se, pas nje konflikti nderetnik, eshte shume e veshtire te rikonstuohet nje shoqeri multietnike. Kjo ndodh per vete faktin e presences se pozicioneve te ngurtesuara te roleve, qe luajne palet ne konflikt, pasi eshte e veshtire "te behen per vete" perkrahesit e konflikteve etnike. Luftetaret per ceshtje etnike nuk i ndryshojne lehte bindjet e tyre. Ne rastin konkret, ashtu si shqiptaret mbeten ne bindjet e veta, serbet perseriten po te njejten gje. Me fjale te tjera, lideret e nje komuniteti nuk gjejne motive per t'ju afruar komunitetit tjeter. Ne Kosove, per vete "humneren e thelle" midis serbve dhe shqiptareve, pak lidere e ndjenin se ishte e nevojshme te punohej me lideret e komunitetit kundershtar etnik. Sigurisht, per kete, pengonte dhe fakti i pranise dhe te "rezervave" nga koleget e vet, te cilet mund t'i akuzonin si bashkepuntore te grupit rival etnik. Megjitheate, teoria sipas te ciles, "*pas nje konflikti nderetnik eshte e veshtire te rikonstuohet nje shoqeri multietnike,"* nuk e perjashton mundesine, e tejkalimit te ndarjeve etnike, aq me pak, mbi bazen e nje politike gjithperfshirese, *kur te gjithe te ndjehen te barabarte, apo me krijimin e nje identiteti te perbashket mbietnik,* qe mund te jete produkt i *nje shoqerie, ne te cilen dasite"e vjetra" jane me pak te rendesishme se interesat " e reja" te perbashketa*. Po ashtu, nje teori e tille nuk merr parasysh rendesine e ndikimit te madh nderkombetar, i cili *mund te veproje nepermjet presioneve diplomatike, financiare dhe ushtarake.* Ajo, po ashtu, nuk llogarit "aksese" te tille te rendesishem, si *ndertimin e nje shteti demokratik, apo perspektiven e integrimit europian*.

Ne rastin e Kosoves, keta faktore, ishin "karrota," qe i bindi lideret e niveleve te ndryshme per te pranuar dhe per ta bere te mundshme, *shumeetniken*.

Se dyti, ka teori te tjera, qe argumentojne se, *qe nje konflikt "te prodhoje" demokraci, duhet, medeomos, te ekzistoje nje shoqeri civile substanciale*.

Qe ka ekzistuar nje berthame e shoqerise intelektuale, ne Kosove, e cila ka drejtuar sistemin paralel te arsimit dhe te shendetesise, eshte nje fakt i padiskutueshem, ndonse kjo veprimtari nisej nga motive patriotike dhe nga nje fryme proteste, pa arritur te kthehet ne nje program te vertete politik. Problemi ishte se, kjo berthame reale e shoqerise civile, ne Kosoven e pushtuar nga serbet, mbeti e pazhvilluar, pasi ishte nen kontrollin e *rrepte* te policise serbe dhe te administrates shqiptare te regjimit serb. Nje pjese e madhe e intelektualeve shqiptare u persekutuan, u perzune, madje u vrane e u masakruan, nga forcat serbe te sigurise, si ne rastin e Ukshin Hotit e te Fehmi Aganit.

Megjithate, duhet thene, se bashkesia nderkombetare ne Kosove, kishte mundesi te bente me shume gjate viteve te pasluftes, per te kultivuar dhe per te perkrahur nje shoqeri civile konstruktive, duke nderhyre ne tregun e ideve, duke perzgjedhur dhe duke mbeshtetur lideret e moderuar e progresive.

Se treti, lufta e shqiptareve kunder sunduesit serb, i acaroi, gati ne ekstremitet, ne menyre artificiale, ndarjet e theksuara brenda vete komunitetit shqiptar. Nderkombetaret, qe kishin ardhur ne Kosove me idene "per te pajtuar serbet me shqiptaret", u tronditen me amiqesine e eger midis LDK-se dhe PDK-se dhe me kontestet e tjera brendashqiptare. Nisur nga ky fakt, sipas mendesise se tyre, Kosova duhej te kalonte nepermjet nje faze te nje procesi te konfrontimit te brendshem, per t'u bere kompakte, qe, pas kesaj, te ishte ne gjendje, te behej shtet. Si "argument" per nje konceptim te tille, ata perdornin faktin se, shume shtete me gjendje te qendrueshme, kane kaluar nepermjet konflikteve te brendshme te dhunshme, per te ardhur ne stabilitetin e sotem.

Ku deshtoi bashkesia nderkombetare ne Kosove dhe cilat jane mesimet e dobishme, per misionet nderkombetare, ne te ardhmen?

Administrata nderkombetare ne Kosove beri nje varg deshtimesh teknokratike, per arsye se drejtimi i saj ishte i percaktuar nga vete karakteri i nderlikuar i bashkesise nderkombetare, *ne momentin e marrjes se vendimit*. Ne Kosove, bashkesia nderkombetare ishte vene ne levizje me kombinimin e vecante te disa kushteve, qe *u kondicionuan nga momenti historik*, i cili duhej te bashkonte ambiciet e medha, nga njera ane, me kufizimet dhe pikat delikate, qe i kushtezonte ky moment, ne anen tjeter.

Ne radhe te pare, deshtimi erdhi nga konceptimi i gabuar i synimit te misionit. Bashkesia nderkombetare vendosi te intervenoje ne Kosove, per te ndaluar shkeljet masive te te drejtave te njeriut dhe mendoi se nje gje e tille do te arrihej me largimin e forcave serbe te sigurise. Ajo nuk kuptoi se konflikti i Kosoves, ne fund te viteve '90-te, ishte kapitulli i fundit i nje lufte te gjate, midis serbve dhe shqiptareve, per zoterimin e territorit.

Duke keqkuptuar natyren e konfliktit, aktoret nderkombetare, te angazhuar ne Kosove, ne menyre te natyrshme, zgjodhen nje kendveshtrim te gabuar per t'i zgjidhur problemet. Keshtu, KFOR-i ishte i orientuar per mbrojtjen e kufijve te Kosoves, kunder agresionit nga Serbia dhe beri shume pak per ruajtjen e rendit ne Kosove, pas largimit te forcave serbe te sigurise.

Administrata nderkombetare beri disa vleresime te gabuara, lidhur me pozicionin dhe kapacitetet e institucioneve lokale ne Kosove. Partite politike kosovare konsideroheshin dhe trajtoheshin njelloj sikur te ishin partite politike perendimore: nje grup me mendje te hapur, i bashkuar rreth perkushtimit te perbashket ndaj parimeve te caktuara ideologjike. Nga ana tjeter, bashkesia nderkometare investoi shume ne OJQ-te lokale, duke mos pare se shume prej tyre, nuk kishin perkushtim "per vlerat demokratike". Kishte paqartesi dhe mosnjohje per te kaluaren e Kosoves dhe te shoqerise se saj bashkekohore. Pa kete njohje, bashkesia nderkombetare nuk mund te formatonte te ardhmen e Kosoves, sic e kerkonte ajo.

Momenti i dyte lidhet me deshtimin e ideologjise. Arsyeja e moskuptimit te problemeve ishte hezitimi per t'u treguar qytetareve te Kosoves se, si do te ishte shoqeria e tyre dhe si duhej te silleshin ata, per ta arritur kete. Me gjithe paqartesite lidhur me mandatin e UNMIK-ut, qellimi ishte i qarte*: te ndalej dhuna dhe te parandalohej rikthimi i saj*. Kjo do te thoshte se Kosova duhej te behej nje shoqeri e tille, qe nuk kishte qene asnjehere me pare. Natyrisht, nuk mund te ishte "fotokopje" e shoqerive perendimore, por duhej te braktiste agresivitetin dhe dhunen, si menyre per zgjidhjen e problemeve, dhe te perqafonte sundimin e ligjit. Keto ndryshime qe te ishin efektive dhe te qendrueshme, duhej te ishin ne sherbim te qytetareve, ndersa lideret politike te kishin me shume pergjegjesi qytetare. Sigurisht, arritja e ketyre ndryshimeve do te sillnin nje realitet gjitheperfshires te shoqerise se Kosoves. Por nderkombetaret nuk deshen dhe nuk e moren kontrollin mbi mjetet, me te cilat formesohej sjellja publike dhe qytetare. I ushqyer me iluzione, misioni nuk beri perpjekjet e duhura per te perdorur levat e pushtetit te bute: reformen arsimore, kontrollin e medias, publicitetin, qe permes tyre, te transformonin sjelljet publike. UNMIK-u, asnjehere, nuk beri perpjekje per te depolitizuar sistemin arsimor. Mediat u lejuan te bejne dallime etnike. Simbolet ndarese etnike u lane te lira te qarkullojne.

Flitet shume se nje nga difektet e administrates nderkombetare te UNMIK-ut ishte *mosvendosja e demokracise ne Kosove*. Mendoj se ketu kemi te bejme me nje keqkuptim. Eshte e paargumentuar, te presesh vendosjen e demokracise nga misionet paqeruajtese te OKB-se. Misione te tilla kane si objekt, ndalimin e luftes dhe vendosjen e paqes, demokracia eshte ceshtje e brendshme e secilit vend. UNMIK-u, si mission, nuk ishte i trajnuar per te bere nje gje te tille. Supozojme, se do t'i lihej atij ta "ndertonte" demokracine ne Kosove. Shtrohet pyetja cilin "model" te demokracise do te "perdorte"? UNMIK-u nuk kishte as kapacitete, as objekt, as model per te vendosur demokracine. UNMIK-u ne veprimtarine e tij mundte dhe duhej te pergatiste me mire kushtet, ne baze te te cilave, te lindte dhe te rritej demokracia.

Momenti i trete, lidhet me mungesen e unitetit. Qendrimet divergjente per Kosoven, u duken, qe ne deshtimin per te siguruar nje mandat te OKB-se. Me nenshkrimin e marreveshjes se Kumanoves, pas nderprerjes se sulmeve te NATO-s, mendohej se do te ishte mire, qe protektorati te administrohej nga SHBA-ja, por kjo e fundit, nuk ishte e gatshme ta merrte persiper, e vetme, kete projekt kaq te nderlikuar. Pervec kesaj, Milloshevici insistoi qe mandati per protektoratin te vinte nga Keshilli i Sigurimit i OKB-se, me qellim, qe te siguronte mbrojtjen nga aleatja e vjeter e Serbise - Rusia, e cila "posedonte" ndikimin e saj te njohur te Keshilli i Sigurimit.

Vendosja e vetos te Rusise, ne KS do te thoshte nje mandat formal protektorati, qe misioni te kishte nje objekt te kufizuar, me e rendesishmja, nuk do te mundte, kurrsesi, te shprehej lidhur me statusin perfundimtar te Kosoves, pas vendosjes te themeleve te paqes. Duhet thene se, UNMIK-u u krijua pa ndonje qellim apo strategji te qarte dhe e kishte te ndaluar te merrej me shkakun e luftes.

Pasi OKB-ja mori mandatin per drejtimin e misionit, nisur nga fakti se Departamenti i OKB-se per Operacione Paqeruajtese (DOOP), nuk kishte kapacitete ta merrte, i vetem, pergjegjesine, ftoi ne bashkepunim si partnere, Komisariatin e Larte per Refugjatet te OKB-se (UNHCR), OSBE-ne dhe BE-ne.

Realisht, nje nga shkaqet, pse objektivat e pergjithshme nuk u permbushen ishte rivaliteti midis ketyre agjencive. Nje shembull per ta ilustruar kete fakt, ishte vonesa per krijimin e kurseve per trajnimin e administrates civile te Kosoves, per me shume se dy vjet. Arsyeja ishte kontesti midis Shtylles, te udhehequr nga OKB-ja per administrate civile dhe Shtylles, te udhehequr nga OSBE-ja, e cila ishte pergjegjese per demokratizimin dhe ndertimin e institucioneve. Po kjo arsye e pengonte Misionin te kishte nje njesi, qe te merrej me zgjidhjen e konflikteve.

Duke patur kater institucione, "nen nje cati", UNMIK-u vuante nga fakti se kishte shume "zoter shtepie." Problemi me i madh qendronte tek shperndarja e vartesise ne disa qendra. Keshtu, krijuesit dhe drejtuesit e larte te Misionit ishin ne vartesi te Sekretariatit te OKB-se dhe KS.- institucioni, qe i kishte derguar ne Kosove. Mirepo, pervec OKB-se, ne mision ishin prezente dhe institucionet e BE-se: Parlamenti Europian, Komisioni, Drejtoria e Pergjithshme, qe merrej me marredheniet nderkombetare, Sekretariati i OSBE-se ne Vjene dhe zyra e Havier Solanes, (Perfaqesuesit te Larte te BE-se, per Politike te Jashtme dhe Siguri), te cilet merrnin raporte te rregullta nga Misioni ne Kosove, ndonse shumica e zyrtareve financoheshin nga shtetet e tyre. Pervec kesaj, ne Kosove ishin dhe perfaqesuesit e shteteve nacionale, te grupuar si ne rastin e Grupit te Kontaktit, apo si perfaqesues diplomatike, prane Ambasadave te shteteve te tyre. Ne kete situate, Kryeadministratoreve te Kosoves j'u duhej shume kohe dhe energji, "per te bere per vete" te gjithe keto "zoter shtepie". Prandaj nuk duhet te na befasoje fakti, se UNMIK-u vepronte ngadale dhe kishte nje shkalle te larte inkoherence.

Momenti i katert, lidhet me problemet e struktures. Ne nje kohe kur, ushtaraket ishin te pergatitur, perpara se te hynin ne Kosove, sipas nje plani te perpiluar, kohe me pare, ku secili ushtarak e dinte vendin dhe rolin e tij, (per te cilin ishte trajnuar), ku logjistika, planifikuesit dhe oficeret e intelegjences ishin te gatshem per te vepruar, (madje te gatshem edhe per ndryshime ne castin e fundit, sipas detyrave te specializuara), pergatitja e

pjestareve te misionit civil ende nuk kishte filluar dhe gjendja ishte dramatike, krahasuar me ate te ushtarakeve. Nje nga arsyet e mungeses se pergatitjes te "ushtrise civile" te misionit ishte se nuk mund te planifikohej misioni, perpara se Keshilli i Sigurimit te miratonte Rezoluten 1244, pasi do

te konsiderohej se paragjykohej vendimi. Ne te njejten kohe, nuk ishte normale qe te planifikohej struktura e misionit, ne menyre te fshehte, pasi do te ishte e pamundur, te mbahej "sekret" planifikimi i misionit, te nje organizate, qe praktikisht, ishte e shtrire ne tere boten. Gjerat u bene aq me nxitim, sa Kryeadministratorit te pare te UNMIK-ut, Sergio Vieira de Mello, i mbeti vetem nje jave kohe, per te pergatitur ekipin e tij dhe per te shkuar e "te merrte pushtetin,"ne Kosove. Vetem pas raportit "Brahimi", ne OKB, zyrat e zbrazta te UNMIK-ut ne pritje te punonjesve, nisen t'i plotesonin vendet e lira te punes.

Nje problem tjeter ishte, se megjithese misioni kishte punesuar diplomate, inxhiniere, afariste, juriste e profesioniste te tjere, te cilet, ne kushte organizimi normal, do te arrinin rezultate konkrete, kultura organizative e OKB-se*, nuk bazohej ne cilesine e punes dhe te arritjeve, por ne respektimin e procedurave*. Si rezultat, ndersa UNMIK-u bente perpjekje te shndrrohej ne nje regjim te organizuar mire, njerzit brenda misionit u bene pasive. Per pasoje, UNMIK-u e *humbi aftesine, per te projektuar veten te shoqeria, te cilen duhej ta transformonte*.

Gjendja e misionit, ishte e pashprese, persa i perket kontrollit ne sferen e sigurise. KFOR-i perbehej nga kontigjente nacionale, qe mbronin interesat e kryeqyteteve te vendeve te tyre, prej te cileve, merrnin edhe komandat, secili, ne baze te specifikave te vendit te tij. Rasti kur, gjate trazirave te marsit te vitit 2004, "rregullat e Berlinit" i lane forcat gjermane te KFOR-it, jashte intervenimit ne kaosin qytetar te Prizrenit, si dhe "simpatite politike" te Frances per serbet, e lane kontigjentit francez te KFOR-it jashte detyrimit per te mbrojtur rendin dhe sigurine ne Mitrovice, tregojne mungesen e vullnetit, per te kryer detyren dhe se siguria, e ruajtur nga KFOR-i, ishte e pasigurt. Forca policore e OKB-se, pervec se nuk kishte kontigjente te mjaftueshme, kishte ne mesin e vet, shume police te papervoje ne luftimin e krimeve, ne kushtet e veshtira te nje terreni te huaj postkonfliktual. Asnjeri nga policet nuk fliste shqip dhe ndodhte shpesh, qe ata te ishin viktima te perkthyesve te paafte, te zgjedhur me ngut. Perderisa, praktikisht, policia nuk dispononte kapacitete per te hyre ne "net-worket" e krimit per te depertuar ne linjat kriminale, strukturat e UNMIK-ut, ishin "te zbuluara" perpara te gjithe paleve te interesuara. Kjo disbalance, ne favor te elementit kriminal e shkaterroi rende besueshmerine e UNMIK-ut ne fushen e pazevendesueshme te intelegjences.

Probleme te tilla, u nderlikuan me teper,

opinion

me mungesen e autoritetit te Kryeadministratorit, mbi te gjithe misionin dhe veprimtarine e tij. Kur kryeadministratori urdheroi, ne vitin 2002, nje te katerten e UNMIK-ut, te dislokohej ne Mitrovicen e Veriut, "per t'u bere me interesante" per serbet dhe per te hapur vende pune ne qytet, urdheri i tij u refuzua nga OKB-ja dhe

OSBE-ja.Vetem nje pjese e BE-se u pajtua te dislokohej ne veri. Problemi ishte se Kryeadministratori nuk mund t'i pushonte vartesit e vet, as edhe per mosbindje, pasi ishin selite qendrore te OKB-se, OSBE-se dhe BE-se, qe kontrollonin disiplinen dhe emrimet ne detyre. Rezultati ishte, se *shume zyrtare nuk i pershtateshin punes qe kryenin, si dhe shume nga punet qe duheshin kryer, nuk u pershtateshin nevojave te Kosoves*. Megjithese, plot zyrtare profesioniste kishin pervoje, te perfituar nga puna dhe normat e shoqerive te stabilizuara e te qendrueshme, pak prej tyre, kuptuan se si duhej "shendoshur" dhe zhvilluar nje shoqeri e shtypur dhe e varfer.

Momenti i peste lidhet me pamjaftushmerine e vullnetit. Mund te thuhet, pa e tepruar, se te metat dhe dobesite, qe kam permendur, deri tani, nuk do te ishin lejuar, nese shtetet udheheqese te projektit nderkombetar per Kosoven, sidomos, Grupi i Kontaktit (SHBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe Rusia), do te kishin treguar vullnet te mjaftueshem politik, per te mos lejuar ose, te pakten, per kapercimin e ketyre mangesive, e te metave dhe gabimeve. Perkundrazi, bashkesia nderkombetare i perdori keto veshtiresi, si arsyetime per te moslejuar veprimet e guximshme, duke i kthyer ato ne nje retorike te guximshme. Rezultati ishte tretja e fjaleve, zotimeve, angazhimeve e veprimeve te shteteve perendimore. Nje gje e tille *ndikoi tek qytetaret e Kosoves, te shqiptaret edhe te serbet, te paret te beheshin cinike, kurse te dytet, skeptike, ndaj bashkesise nderkombetare*.

Me kalimin e kohes, UNMIK-u prodhonte, gjithnje e me shume rregulla, per te cilat, ndermerrte, gjithnje e me pak, veprime, per t'i zbatuar. Komisioni i mediave shqiptonte denime, te cilat rralle, shlyheshin. Tabelat e qarkullimit rrugor, nuk zbatoheshin, deri kohet e fundit, nuk denoheshin fajtoret.

Edhe, pa perdorur dhunen fizike, UNMIK-ut nuk i mungonte autoriteti dhe fuqia, per te imponuar disipline tek institucionet e Kosove dhe per te zbatuar ligjjet nga qytetaret, por ky autoritet dhe kjo fuqi, nuk u perdor, ne masen dhe ne kohen e duhur. Asnjeri nga Kryeadministratoret e Kosoves, nuk

pati perkrahjen e Keshillit te Sigurimit, per t'i pushuar zyrtaret e paafte e kokeforte edhe atehere kur ato shkelnin Kornizen Kushtetuese. Disa rezoluta te Kuvendit te Kosoves u shfuqizuan me urdher te PSSP-ja, por nuk u shoqeruan me sanksione percjellese, madje zyrtaret e dinin se kur deputetet miratonin vendime jashte mandatit te tyre, kjo nenkuptonte nje proteste te re per misionin nderkombetar.

Momenti i fundit, lidhet me mosperputhjen ne kohe. Korporata e madhe amerikane " Rand ", ne nje studim ambicioz lidhur me perpjekjet e ndertimit te shtetit, konstatonte se kohezgjatja e nje administrate nderkombetare ishte faktori me i rendesishem dhe vendimtar per arritjen e suksesit. Si rregull, zgjatja e kohes se qendrimit te nje administrate nderkombetare, pas zgjidhjes te nje konflikti, eshte ne vartesi te vullnetit politik, i cili eshte ne raport te zhdrejte me zbehjen e "kujtimit" te konfliktit. Ndersa, "horizontet" politike te atyre, qe vendosin per kohezgjatjen e administrates nderkombetare, varen nga ciklet buxhetore te burokracive te tyre, qe, pergjithsisht, jane te shkurtra, ne nje kohe kur, procesi i trasformimit te nje shoqerie te dale nga lufta, ne nje shoqeri paqesore e demokratike, kerkon shume me teper kohe.

Ne fakt, kjo eshte mosperputhja klasike e zgjidhjeve afatshkurtera per probleme afatgjata. Kjo mosperputhje perkeqesohet ne nje paradoks. Nese misioni i administrates nderkombetare behet i suksesshem, eshte e veshtire per lidershipin politik te arsyetoje angazhimin e metejshem te fondeve aty, ne nje kohe kur kriza te reja akute "japin alarmin", per vemendje. Nga ana tjeter, nese ne misionin e administrates nderkombetare, pas disa vjetesh, ende vazhdojne veshtiresite, kercenimet dhe destabiliteti, eshte e veshtire te argumentohet derdhja e fondeve tek "e keqja".

Vullneti politik per te vazhduar misionin nderkombetar ne Kosove vuajti nga te dy keta faktore: kur tema e Kosoves "binte" nga faqet e para te gazetave dhe nga lajmet "numer nje" te masmedias, aktoret politike nderkombetare nuk ndjenin presion per t'u perqendruar te Kosova, aq me teper, kur vemendja spostohej tjeterkund, si ne rastin e 11 shtatorit 2001.

Ndryshe, ndodhi pas shperthimit te trazirave te marsit 2004, kur politikanet e Qendrave te medha nderkombetare, u frikesun se mund te kishte shperthime te reja, me te fuqishme, ne Kosove, gje, qe mundesonte te ishin reference, per cfardolloj deshtimi te politikes se jashme.

Sigurisht, eshte e veshtire te gjesh zgjidhje evidente per dilema te tilla. Ne rastet e obligimeve per nderhyrje nderkombetare, ne vendet postkonfliktuale per vendosjen e paqes dhe te stabilitetit, per t'i transformuar keto vende ne zona paqesore, si ne rastin e Kosoves, votuesit ne vendet dhe shtetet me te fuqishme duhet t'u jepnin mundesi liderve te tyre te zgjedhur, te rrezikonin dhe te mbeteshin sa me gjate ne keto vende, derisa konflikti te shuhej plotesisht. Por, me sa duket, demokracite priren t'i njohin rreziqet ngadale dhe te lodhen shpejt.

Nuk ka dyshim, se UNMIK-u ka zbatuar funksione praktike, administrative dhe te ndertimit te institcioneve, ne menyre efikase e rezultative per kohen. Lista e arritjeve, e ndryshimit dhe e permirsimeve eshte mjaft e gjate: si rimekembja e Kosoves pas luftes, ndertimi i rrugeve dhe banesave, ngritja e institucioneve, zgjedhje te lira e demokratike, nje kod te ri ligjor, ngritja e

sistemit parlamentar funksionues, te gjykates, te valutes se re etj.

Eshte e natyrshme, se kishte edhe shume veshtiresi, si p.sh. administrimi i KEK-ut (organizates energjitike) me veshtiresi e probleme te perhershme, ku nderkombetaret, kishin aq kontroll, sa per t'i akuzuar ata, per defektet dhe kishin aq para, sa per te bere riparime afatshkurtera, te dyja mundesit, te pamjafteshme, per te bere nje zgjidhje afatgjate. Po ashtu, eshte fakt, se megjithe perpjekjet e perseritura, me apo pa deshire, UNMIK-u, nuk arriti asnjehere te shtrije autoritetin e vet, ne pjesen veriore te Kosoves. Por, mund te thuhet se defekti me pasoja me te renda i administrates se UNMIK-ut lidhet me *deshtimin e perpjekjeve per ta bere Kosoven nje demokraci multietnike europiane,* qe te respektonte sundimin e ligjit. Pas gjashte vjetesh te protektoratit nderkombetar, kultura politike e Kosoves ndryshoi pak dhe shume ngadale. OSBEj-a, e ngarkuar per demokratizimin, ne prag te largimit te saj, i la partite politike, ne vend, pa spekter politik te dallueshem, pa demokraci te brendshme dhe pa filozofi politike specifike. Funksionimi organizativ i partive ishte kaotik dhe me prirje te rritjes te presionit politik, brenda vete forcave politike.

Pritej, qe BE-ja te krijonte kushtet per aplikimin e nje ekonomie moderne liberale, por pas gjashte vjetesh, dy te tretat e popullsise ishin te papune dhe shumica e tyre jetonin me ndihmat e kusherinjve te tyre nga diaspora. Shumica e produkteve ushqimore baze importohej, me gjithe potencialin e madh bujqesor te Kosoves.

Deshtimi fatal i administrates nderkombetare ishte, se duke mos marre parasysh strukturen demografike dhe shkallen e larte te papunesise, te Kosoves, e cila kishte tendence te shkonte drejt "njeetnikes", nderkombetaret nuk u moren me problemet reale te shoqerise kosovare, (te shqiptareve dhe te serbeve sebashku), por pothuajse te gjitha politikat i vendosen mbi bazen e nje retorike joreale te te ashtuquajturit "kthim te serbve te larguar" nga Kosova.

Misionini i OKB-se duhej te implementonte sundimin e ligjit, por kapaciteti gjyqesor vendor mbeti i pazhvilluar ne nivelin e duhur dhe krimi i organizuar mbeti problematik. Ne vend qe Kosova te shndrrohej ne nje demokraci pluraliste, qe t'i nenshtrohej sundimit te ligjit, per te gjithe qytetaret, bashkesia nderkombetare lejoi, qe pluralizmi te ishte formal dhe te sherbente, vetem si bazament ne funksion te marrjes dhe te alternimit te pushtetit politik.

Si konkluzion, mund te thuhet se UNMIK-u, u'a "dorezoi detyren" institucioneve te pavarura demokratike te Kosoves, pasi kishte arritur shume pak, nga ajo,qe duhej te arrinte, duke e sforcuar, maksimalisht, qeverine dhe shtetin e ri te Kosoves pas shpalljes se pavaresise. Ne kompesim te kesaj situate, institucioneve te reja te Kosoves se pavarur i'u desh te rivleresonin dhe te permiresonin shume objektiva dhe programe, per ta vene vendin ne binaret e prosperitetit, ne kushtet e reja premtuese te shtetit te ri te pavarur.

Fundshekulli i copëtimit të shqiptarëve

Nga: **Bedri TAHIRI**, Kosovë

Gjithmonë e jetës, çfarëdo lloj ndarjeje shkakton dhimbje. Ato përjetohen në mënyra të ndryshme. Ka ndarje të detyrueshme, por ka edhe ndarje miradashtas, me qejf e me pëlqim. Ndarje të përkohshme e ndarje të përjetshme. Ndarje nga vëllai, ndarje nga motra, ndarje nga prindërit, ndarje nga miqtë, ndarje nga shokët, ndarje nga gruaja, ndarje nga vendlindja, ndarje nga jeta...

Dhe, zakonisht, në të tilla raste, nuk mendohet ribashkimi. Jo, ore jo, qofshit me jetë të jetëve, meqë ai nuk është i nevojshëm e as i mundshëm. Përkundrazi, ato ndarje shkojnë vazhdimisht duke u thelluar e duke u degëzuar.

Copëtimi ia kalon ndarjes. Madje, ai është diçka krejt tjetër. Vetë nocioni copëtim reflekton një gjë të tillë. Ai bëhet përdhunshëm, me forcë. Nuk thuhet kot: u bë copë e grimë. Buka që copëtohet nuk ngjitet më. U bë copë e thermi. U bëfsh copë- copë. Të shqeut ujku në njëqind copa. Shembuj kësisoj ka sa të duash. Sidoqoftë, kjo është më e lehtë, ngase kemi të bëjmë me gjësende lëndore.

Po copëtimi shpirtëror e kombëtarë!

Ah, të keqen vëllai, këtu qëndron puna krejt ndryshe. Bota njerëzore është më delikate sa edhe vetë natyra. Edhe veprimet brenda saj janë më të ndërlikuara, më serioze, më të komplikuara. Njeriu, qenia më e përsosur e globit, posedon një botë specifike emotive. Zbërthimi i gjithë misterit të njeriut është thuajse i pamundur. Mendja e tij e stërholluar imagjinative ka arritur të depërtojë në të gjitha shtresimet hemisferike, ka arritur deri në hënë e më larg, por ende nuk e ka shterruar hulumtimin e njohjes se vetvetes. Ka bërë përparime në dije, në shkencë e në teknologji, por nuk ka mundur ta dëshifrojë plotësisht intimitetin ndjenjësor të shpirtësisë se vet. Gjithë universi që na rrethon nuk bën sa një zemër e sa një shpirt njeriu. Në këtë jam mëse i sigurtë. Njerëzorja dhe shpirtërorja nuk peshohen dot në kandar... Ashtu janë edhe familjet, fiset, kombet, e popujt. E po, ato nuk janë gjë tjetër veçse bashkësi individësh. Rravgimet e tyre nëpër zigzakët e mugëtirave të zymta historike, pa dyshim lënë gjurmë të pashlyera.

Dhe, të kthehemi në temë.

Copëtimi shpirtëror e kombëtar rëndojnë më shumë se vetë shkëmbinjtë e vargmaleve tona që puqen me qiellin. Kemi dëgjuar e mësuar për copëtime fisesh, kombesh, popujsh e shtetesh. Për këtë historia mban shënime të sakta dhe dëshmon me shembuj konkret. Ama, sidoqoftë, ai është i riparueshëm. është një proces që në vijimësi evoluon dhe kuron plagët, duke i lëpirë me gjuhën e vet. Rëndom, pas një periudhave të caktuara kohore, herë- herë të gjata e të rënda, herë- herë të shkurtra e më të lehta, bëhet ngjizja, koagulimi, mpiksja, shërimi dhe bashkimi. Më falni se gabova. Jo bashkimi, por ribashkimi. Bashkimi u shkon më shumë atyre pjesëve që asnjëherë nuk kanë qenë bashkë. Ndërkaq, pjesët që kanë dalë nga një tërësi, mund të ribashkohen, ngase bashkë kanë qenë edhe më parë.

Po shqiptarët ç'duhet bërë në këtë fundshekull nopran e tekanjozë! Kjo dihet katërcepërisht: Duhet ribashkuar.!

Populli shqiptar, ndër më të vjetrit në gjithë rruzullin, përherë jetoi në trojet e veta stërgjyshore. Kurrë askujt nuk i ra në qafë, por kurrë nuk e lanë të qetë grabitçarët orekssëmurë. Trojet e tij, të shtrira det me det e deri tej Adriatikut, u tkurrën e u rrudhosen sa mund të mbuloheshin me një gunë bariu. Sekush që erdhi këtejpari, veçan fqinjët e pangopur, serbët, grekët, maqedonët, shqeu nga një copë të shtatit të drobitur nga betejat e luftërat. Dhe, fare në fund, kur të tjerët u paqëtuan brenda kufijve të vet, edhe ky grusht i etnisë sonë që, me mund e sakrificë, mbijetoi zezonat, u copëtua pamëshirshëm. E copëtuan fqinjët lakmiçarë dhe e bekuan vendimmarrësit evropianë e botërorë. Sot, shqipet e lirisë, ashtu të copëtuara, gjallojnë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Serbi, në Greqi...

Dhe, tashmë, kur po mbushet një shekull i plot nga ky copëtim prokrustian, është një rast i volitshëm për ndërgjegjësim të historisë njerkë. Pra, ata që na copëtuan, ata duhet edhe të na ribashkojnë. Një rast, vërtet historik. Mësuesja e jetës duhet t'i vë gisht kokës dhe të mbledh mendjen e të korrigjojë padrejtësitë e djallëzisht që për njëqind vjet na rënduan pamëshirshëm mbi kurrizin e gjakosur.

Pra, fundi i 2012- së, gjegjësisht fillimi i 2013- së, të kurorëzohet me ribashkimin e të gjitha Trojeve Etnike Shqiptare.

-O burra, ta bëjmë Shqipërinë! - do të thoshin rilindësit tanë mendjendritur. As të madhe, as të vogël, as artificiale. Ta bëjmë atë realen: Shqipërinë Natyrale! Atë me katër vilajetet e dikurshme, pa e harruar Çamërinë heroike. Tekefundit, gjaku nuk bëhet ujë. Këtë lë ta dinë të gjithë, ata që na duan e ata që na urrejnë, miqtë e armiqtë, dashamirët e dashakëqinjtë...

Do ta bëjmë Shqipërinë, jo për inat të shqiptarëve, siç thoshte dikur Faik Konica zemërplasur, por për hir të atyre (dëshmorëve) që me gjakun e tyre mbëltuan L I R I N ë.

E ata nuk janë të pakët. Vargoi i tyre zgjatet tej e tej nëpër dekada e shekuj, që nga heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti- Skënderbeu e deri tek komandanti legjendar, Adem Jashari.

Dhe, sot, edhe pse i kemi dy shtete: Republikën e Shqipërisë (28 nëntor 1912) dhe Republikën e Kosovës (17 shkurt 2008), shumë pjesë kanë ngelur jashtë kufijve realë, andaj, shkurt e shqip, një veprim i tillë, korrigjimi i padrejtësive historike ndaj shqiptarëve, shtrohet si domosdoshmëri para diplomacisë evropiane dhe asaj botërore:

Sepse bëmë: Shumë luftëra, shumë beteja, shumë sakrifica, shumë dhembje...

Sepse patëm: Një gjuhë, një komb, një kulturë, një flamur, një ideal...

Sepse ato i karakterizon: Emëruesi i përbashkët dhe synimi përfundimtar: RIBASHKIMI KOMBËTAR!

Dhe, më 28 Nëntor 2012, shpresoj e besoj, nëse drejtësia është drejtësi e demokracia demokraci, do të duhej të festonim me të vetmin urim: Gëzuar RIBASHKIMI KOMBËTAR!

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com".

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

Rruga e Arbërit nr. 71

Një post-Rilindas që sakrifikoi jetën e tij për zhvillimin e arsimin e popullit të vet.

portret

Jashar Erebara, figurë historike e lënë në harresë

Jashar Erebara zhvilloi një veprimtari të llojllojshme atdhetare. U mor me çështjen e shkollave dhe të arsimit. Me iniciativën e tij u hapën mjaft shkolla në Maqedoni dhe në Kosovë. Ka qenë një njohës i mirë i arsimit. Zhvilloi një veprimtari të begatshme arsimore e publicistike. Me sukses udhëhoqi gazetën "Shkupi" të Shkupit dhe "Albania" të Beogradit. Në të dy këto gazeta u shqua për shkrimet e tij analitike dhe me përmbajtje të thukët.Prore qëndroi në anën e popullit që i takoi. Me gjithë kërcënimet që i bëheshin nga armiqtë e popullit shqiptar ai qëndroi i palëkundur. Ishte një trim i paepur. Kurrë nuk iu shmang rrugës së nisur.Punën e çonte gjer në fund. Si njohës i mirë i arsimit dhe si arsimdashës i flaktë, më 1911, arriti të hartonte abetaren e Kumanovës, të njohur me emrin ABC-ja e Jashar Erebarës, e cila u shpërnda edhe në mjedise të ndryshme të Kosovës.

Jashar Erebara hyri në skenën politike shqiptare në fund të shekullit XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XX, pra i takon periudhës së fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Erebara ka qene një personalitet i gjithanshëm që nuk kurseu asgjë për të mirën e kombit. Ai ishte një patriot i rrallë dhe demokrat-revolucionar përmasash të gjera. Shumë herë u angazhua në lëvizjen kombëtare për liri e pavarësi. Ishte i ndërgjegjshëm se për të arritur lirinë, duheshin punë e sakrifica të mëdha, sidomos po të kihej parasysh qëndrimi i Fuqive të Mëdha dhe aspiratat e fqinjëve tanë ndaj trojeve shqiptare. Qysh i ri, si nxënës i Shkollës Normale të Bukureshtit ra në kontakt me personalitetet e njohura të lëvizjes kombëtare shqiptare si Nikolla Naço, Mihal Grameno, Ibrahim Temo, Dervish Hima, Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Mit'hat Frashëri, Bajram Curri, Nikolla Ivanaj, Mehmet Frashëri, Gjergj Qiriazi, Hamdi Ohri, Luigj Gurakuqi, Pandeli Evangjeli, Thoma Avrami, Vëllezërit Frashëri, Dervish Biçaku, Naum Sotiri, Visar Dodani, Hoxha Kadriu, Bedri Pejani, Shahin Kolonja, Mitrush Kuteli, At Gjergj Fishta, Jani Vreto, Kristo Meksi, Hil Mosi,Vasil Zagrafi, Çerçiz Topulli, Toma Çami si dhe me veprimtarë të tjerë të kësaj periudhe me të cilët pati një bashkëpunim tepër të ngushtë dhe mjaft të suksesshëm.

Në kohën e Perandorisë Osmane, Stambolli ka qenë ndër qendrat më të rëndësishme të veprimtarisë politike, atdhetare dhe kulturore-arsimore të rilindasve tanë. Duke u mbështetur në programin e Lidhjes së Prizrenit intelektualët shqiptarë që vepronin në Stamboll në saje të përpjekjeve të parreshtura arritën të formonin "Shoqërinë e të shtypurit shkronja shqip". Kjo shoqëri u themelua më 12 tetor 1879 në Stamboll, dhe shumë shpejt arriti të hartonte alfabetin unik të shqipes.

Idetë e Riindasve përhapeshin me të madhe ndër shqiptarë. Pas shoqërisë së Stambollit në skenë doli edhe shoqëria "Drita" e Bukureshtit e formuar më 10 gusht 1884. Më pas u formuan edhe shoqëri të tjera si "Dëshira " e Sofjes e themeluar natën e vitit të ri 1893, nga disa shqiptarë të jugut. Vlen të theksohet se të gjitha këto shoqëri nxorën organet gjegjëse të tyre, gazeta e revista etj, përmes të cilave i përhapnin idetë patriotike në masat popullore. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajti shtypshkronja "Mbrothësia" e Luarasit, klubi "Bashkimi" i Manastirit, klubi "Arsimi" i Shkupit, klubi i Kumanovës i themeluar nga Jashar Erebara në janar të vitit 1990.

Me gjithë veprimtaritë që zhvilluan këto klube, nuk kishin arritur ende të siguronin një qendër të vetme drejtuese e cila të organizonte, të drejtonte dhe të kontrollonte mbarë lëvizjen shqiptare. Pra vetëm kërkohej një bashkërenditje më e mirë e veprimtarisë së klubeve. Nisur nga kjo nevojë, në vitin 1908 u mbajt një mbledhje në Manastir. Aty morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha klubeve shqiptare. Në atë tubim, klubit të Manastirit iu njohën njëzëri funksionet e klubit qendror. Ky pastaj filloi të bashkërendonte veprimtaritë e tyre. Tani në rradhët e këtyre klubeve vërehet një aktivitet më i organizuar, më i dendur dhe shumë më frytdhënës.

Punë të mëdha në këtë drejtim kryen patriotët dhe veprimtarët e shquar të çështjes shqiptare si Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Jashar Erebara, Hoxh Kadriu etj. Vlen të theksohet se me angazhimin personal të Jashar Erebarës këto klube u hapën edhe degët e e tyre edhe në disa qendra edhe më të vogla si në Kaçanik, Ferizaj, Besianë.

Pos veprimtarisë kulturore-arsimore, këto klube luajtën edhe një rol tjetër të rëndësishëm, siç qenë mobilizimi i masës së gjerë rreth Lëvizjes gjithëshqiptare për Pavarësi, kundërvënia politikës antishqiptare që zhvillohej atëbotë, pjesmarrja në tubimet e ndryshme ndërkombëtare, ku delegacioni shqiptar shtronte kërkesat e tij. Kështu ndodhi në Kongresin Xhonturk të Parisit, pastaj u hartuan dokumenta të ndryshëm si Memorandumi i Bukureshtit (1896), Promemorja- drejtuar Sulltanit (dhjetor1897-janar1898), Memorandumi i "Shoqërisë Kulturore Shqiptare" (1900), Thirrje, Memorandum dërguar Konferencës së Hagës (1907) etj.

Në bazë të dokumentacionit arkivor të kësaj periudhe, si dhe të botimeve të publikuara që u morën me ndriçimin e kësaj çështjeje tejet komplekse, bie në sy se Jashar Erebara ndodhej kudo dhe qe mjaft aktiv në të gjitha këto veprimtari.

Duke përfaqësuar programin politik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe begatimin e tij me idetë demokratike të kohës, të gjithë veprimtarët e kësaj periudhe i dhanë një shtytje të madhe luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi. Atëbotë punohej në shumë fronte, secili ishte i gatshëm të sakrifonte për këtë çështje madhore të popullit tonë.Ata që ishin në gjendje që kontribuonin e bënin këtë si me penë, aq edhe me pushkë. I tillë ishte edhe Erebara.

Jashar Erebara zhvilloi një veprimtari të llojllojshme atdhetare. U mor me çështjen e shkollave dhe të arsimit. Me iniciativën e tij u hapën mjaft shkolla në Maqedoni dhe në Kosovë. Ka qenë një njohës i mirë i arsimit. Zhvilloi një veprimtari të begatshme arsimore e publicistike. Me sukses udhëhoqi gazetën "Shkupi" të Shkupit dhe "Albania" të Beogradit. Në të dy këto gazeta u shqua për shkrimet e tij analitike dhe me përmbajtje të thukët.Prore qëndroi në anën e popullit që I takoi. Me gjithë kërcënimet që i bëheshin nga armiqtë e popullit shqiptar ai qëndroi i palëkundur. Ishte një trim i paepur. Kurrë nuk iu shmang rrugës së nisur.Punën e çonte gjer në fund. Si njohës i mirë i arsimit dhe si arsimdashës i flaktë, më 1911, arriti të hartonte abetaren e Kumanovës, të njohur me emrin Abc-ja e Jashar Erebarës, e cila u shpërnda edhe në mjedise të ndryshme të Kosovës.

Erebara bashkëpunoi me shumë atdhetarë të asaj periudhe. Shumë aksione që u ndërmorrën në atë kohë, ishin të përbashkëta. Andaj është mjaft e vështirë të veçohet dhe të trajtohet veçmas prej rilindasve të tjerë veprimtaria e këtij personaliteti. Në vitin 1900 Erebara, sëbashku me Himën arritën të nxirrnin në Bukuresht gazetën me titull "Indipendentia Albanie". Edhe pse dolën vetëm dy numra ajo mbetet e shënuar si një gazetë mjaft cilësore me informacione të zgjedhura dhe me një fizionomi të lakmueshme.

Sadoqë Jashar Erebara në një periudhë punoi jashtë atdheut, snjëherë nuk i ndërpreu kontaktet me të. Me kujdes ndiqte çdo ngjarje që ndodhte atje. Si të gjithë veprimtarët e kësaj periudhe, edhe ky ishte i lidhur ngushtë me trojet shqiptare. Të ardhmen e popullit shqiptar e shikonte me një optimizëm të matur. Me kohë u vu në mbrojtjen e interesave shqiptare. Atë nuk e friksuan kërcënimet që vinin nga sulltanati. Për aktivitetin që zhvilloi ai, dëshmia më e mirë janë letërkëmbimet e shumta me personalitetet e njohura të kësaj periudhe.

Në periudhën 1911-1912, Jashar Erebarën do ta gjejmë në Shkup. Këtu ai do të nxjerrë gazetën "Shkupi". Ishte kjo e para gazetë shqipe për trevat e Kosovës dhe të Maqedonisë, e cila me një besnikëri të rrallë pasqyroi kërkesat politike, arsimore dhe sociale të kombit shqiptar.

Se Jashar Erebara ishte një personalitet i shquar, dëshmojnë edhe të dhënat se atë në vitin 1913 do ta gjejmë në Qeverinë e Ismail Qemalit. Duke patur parasysh aftësitë organizuese të Erebarës, Ismail Qemali do t'i japë postin e Komisionit Agrar në Fier. Ndërkaq në vitin 1914 ai do të jetë në Durrës.Në këtë kohë sëbashku me një grup shokësh, do të shkojë në Vienë për të shtruar një varg kërkesash që kishin për qëllim pengimin e copëtimit të trojeve shqiptare dhe lejimin e shkollave shqipe, në anën tjetër. Më 1915 Jashar Erebara me një grup atdhetarësh do të botojë organin "Biblioteka zëri i Shqipërisë". Më 1916 Erebarën do ta gjejmë në Prishtinë në postin e Komisarit Qeveritar pranë Bashkësisë së Prishtinës. Më 1918 së bashku me Bajram Currin, Erebara me cilësinë e sekretarit të "Komitetit të Kosovës", do të shkonte në Vjenë për të përfaqësuar "Komitetin e Mbrojtjes së Kosovës". Për aktivitetin që zhvilloi në Prishtinë, Jashar Erebara do të ndiqet nga bullgarët të cilët e zunë dhe e internuan për 18 muaj në Karllovc.

Pas kundërrevolucionit në Shqipëri e deri në vitin 1939, Erebaran do ta gjejmë në Parlamentin Shqiptar si deputet të Dibrës. Gjatë kësaj periudhe do të jetë shumë aktiv. Sidomos qe angazhuar për përmirësimin e bazës materiale të arsimit. Në vitin 1921 ai është anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe anëtar i shoqatës "Djemuria Dibrane", në të cilën ai u përpoq të lehtësonte kushtet e dibranëve të ardhur. Duke çmuar se ekonomia e Shqipërisë ndodhej në një nivel shumë të ulët, ai bëri përpjekje për të rimëkëmbur atë. Për idetë dhe aksionet që mori në Parlament ai la të kuptohej se ishte shumë njohës i mirë i problemeve të ekonomisë. Si duket, tek Erebara do të ketë ndikuar Mitrush Kuteli, me të cilin pati miqësi të ngushtë, i cili ishte një nga njohësit më të mirë në Ballkan.

Si deputet në Parlamentin Shqiptar, Erebara ishte njëri ndër personalitetet më të respektuara dhe më të popullarizuara. Gjithëherë qëndroi në anën e të varfërve dhe të hallexhinjve.Duke reaguar në Parlamentin Shqiptar ai theksoi ashpër se "ata (Kosovarët muhaxhirë) janë vëllezërit tanë, të të njëjtit gjak, të cilët duhet pranuar si vëllazër, pa kurrfarë diskriminimi". Në këtë periudhë kemi një dokumentacion në formën e letër-këmbimit të shumtë përmes të cilit ai mbante lidhje me popullin, sepse njerëzit i drejtoheshin gjithnjë atij për ndihmë.

Erebara i ruajti me xhelozi ato thirrje, protesta, memorandume e peticione drejtuar Stambollit e Fuqive të Mëdha apo edhe letërkëmbimet e shumta që pati me personalitete të shquara të kohës, i cili sot ruhet në Arkivin Qendror të Tiranës. Është kjo një trashëgimi ndër më të të rrallat e me një vlerë të posaçme për njohjen e historisë sonë. Dokumentacioni është i llojllojshëm, i shkruar në shumë gjuhë, gjuhën turko-osmane, angleze, frënge, arabe, shqipe, serbokroate dhe maqedone. Ky fond është sistematizuar në 4500 faqe dhe i ndarë në 134 dosje.

Në vitin 1940 ai pensionohet. Në këtë kohë ai arrin të sistematizojë dokumentacionin e tij të shumtë përmes të cilit hidhej dritë në aktivitetin e shoqatave atdhetare e të tjerave pothuaj në të gjitha trevat shqiptare por edhe në ato vende ku u përqëndrua aktiviteti i tij dhe i shokëve të tij, si në Bullgari, Rumani, Stamboll, Shkup, Prishtinë, Vienë etj.

Pas vitit 1945 e deri më 1953, Jashar Erebara ishte personi më i përbuzur nga sistemi totalitar komunist. Atij iu bë një trajtim jonjerëzor. Ishin çastet më të vështira të jetës së tij. U deturua të shiste libra nga biblioteka e tij përrallore vetëm e vetëm për t'u ushqyer. U shpronësua dhe u ngushtua në shtëpinë e tij. Në këtë kohë filloi një "luftë" për njohjen e meritave të tij, gjë që sistemi herë ia njohu, e herë ia hoqi. Motivacioni: "...ka qenë deputet në regjimin antipopullor të Zogut". Kërkesat e tij për drejtësi qeveria komuniste iu përgjegj:... "nuk ke sjellë ndonjë shpërblim të çmueshëm Atdheut!..."

Kulmi mbërriti në vitin 1950 kur atë do ta nxjerrin me dhunë nga shtëpia e tij në Tiranë dhe do ta vendosin në Berat. Ky urdhër pas shumë ndërhyrjesh u anullua. Shtatori i vitit 1952 do ta gjejë pa kurrfarë mjetesh materiale.(S a e turpshme! Ta mendosh sot!)

Më 24 qershor 1953 ai mbyll sytë përgjithmonë. Varrimi i tij u bë vetëm me 5-6 anëtarë të familjes së ngushtë. Më shumë nuk u lejua nga pushteti i kohës. Sot varri i tij gjendet në varrezat e Teqesë së bektashinjve në Tiranë.

Ishte kjo një jetë me kthesa të mëdha. Me batica e zbatica, me ngadhnjime e zhgënjime, por vepra e tij do të jetojë gjithmonë dhe do të jetë një frymëzim i përhershëm për gjeneratat e reja. Emri i tij është rradhitur në rradhët e Rilindasve tanë, për çka do t'i bëjë nder mbarë kombit shqiptar.

Përgatiti: **Mimoza EREBARA**

Kadri Demri i Allajbegisë, atdhetar në log t'burrnisë



Treva e Dibrës e sidomos ajo e Maqellarës ka nxjerrë gjithmonë në vite e kohë figura të shquara për trojet amëtare, për lirinë e atdheut. Një nga atdhetarët më në zë të kësaj treve është dhe Kadri Demiri i Allajbegisë. Është nder i madh për Maqellarën që në vazhdën e figurave të shquara si Iljaz pashë Dibra, Dine Bej Maqellara, Xhemal Pasha, Fiqiri Dine, Ismail Strazimiri, Adem Aga e plot të tjerë, lindi dhe rriti dhe atdhetarin e shquar Kadri Demiri. Qysh në Allajbegi e deri në Lukan të Katër Grykëve, rrëzë kurorës së Runjës shekullore flasin me nderim për Kadri Demirin. Lindi më 1 maj 1917 në Allajbegi. U edukua me traditat e shquara të kullës e të fisit. Jeta e tij i ngjan një galerie të çmuar me plot minerale.

Në Allajbegi dhe pikërisht në kullën e Kadri Demirit u organizuan takime e mexhlise. Kulla e tij priti me bujari Aqif Lleshin, Myslim Pezën, Abaz Kupin, Sheh Zerqanin, Sheh Bulqizen, etj. Sipas studiuesve dibranë, në kullën e Kadri Demirit e përreth saj u pritën figurat e shquara të historisë si Abdyl Frashëri, Salë Markja, Bajram Curri, Tush Lleshi, Elez Isufi, Halit Lleshi, Ismail Strazimiri, Haxhi Lleshi, Ramadan Daci, Haki Stërmilli, e plot të tjerë.

Qysh në rini Kadri Demiri u lidh me atdhetarë për çështjen kombëtare. E kundërshtoi me forcë pushtimin e vendit nga fashizmi. U arrestua në vitin 1939 sepse krahas kundërshtimit të pushtimit fashist priti në kullë atdhetar të njohur si Aqif Lleshi, Myslim Peza, Abaz Kupi, Kajo Karafili, Qazim Prishtina e plot të tjerë. Pas një rezistence të fortë u la i lirë me kusht që të paraqitej dy herë në ditë në një postë xhandarmërie në Tiranë.

Me tu kthyer në Dibër përsëri ndihmoi lëvizjen nacional-çlirimtare në mars të vitit 1940 me guxim e sakrifica transportoi me dy mushka komunikatat nga Dibra në Elbasan ku pastaj u shpërndanë në të gjitha qytetet e vendit për t'i bërë kështu rezistencë pushtimit fashist.

Në Pezë më 16 shtator 1942, në Labinot Mal më 10 korrik 1943, në njësitin e çetës së Dibrës, në batalionin e më pas në brigadën 18 sulmuese. Së bashku me nënën e tij bujare e me gjithë familjen u bë strehë për prijësit e luftëtarët e lirisë. Edhe sot e kësaj dite të moshuarit në katër Grykë e kujtojnë me respekt e nderim atdhetarin, trimin e lirisë Kadri Demiri. Ai ishte shoku e bashkëluftëtari i trimave të çetës e njësitit partizan si Sulë Muça, Ali Pepa, Bajram Buci, Rrahman Dervishi e të tjerë të cilët me në krye Haxhi Lleshin luftuan me vetëmohim kundër nazi-fashistëve që sulmuan atdheun tonë.

Në vitin 1943-1944 në operacionin e dimrit familja e Kadri Demirit u ndoq nga pushtuesit. U strehua në fshatin Mazhicë tek atdhetari Bajram Cuku. Pasi u çlirua vendi Kadriu filloi punë oficer në Delvinë, në frontin kundër shovinistëve grek. Më vonë arrestohet dhe dënohet me burg për agjitacion dhe propagandë në burgun famëkeq të Gjirokastrës. Lirohet nga burgu pas zbulimit dhe dënimit të veprimtarisë armiqësore të Koçi Xoxes e jugosllavëve. Rikthehet më vonë në vendlindjen e tij Allajbegi dhe i përkushtohet totalisht punës, familjes dhe traditave të bukura dibrane.

Në vitin 1956 kundërshtoi ashpër kolektivizimin dhe doli hapur kundër kooperativave bujqësore si një e keqe e madhe që po i vinte fshatit. Në vitin 1967, vit ky që quhet si viti i prishjeve të objekteve të kultit si kisha dhe xhami, Kadri Demiri do ishte i pari që do ta kundërshtonte. Ai i vetëm mbrojti xhaminë e Allajbegisë që datonte në vitin 1560. U kujdes nëpërmjet ndihmës së profesor Gani Strazimirit që xhaminë e lashtë të Allajbegisë dhe dy kisha të Maqellarës t'i bëj monumente kulture dhe kështu të shpëtojnë nga aksioni i prishjesh. Xhamisë, në padijen e Kadriut, ia hoqën gurët e minares se gjoja na i shikon "armiku" përtej kufirit. Gurët e saj që i ruajti vetë Kadriu u bënë përsëri minare në vitin 1992.

Kadri Demiri është i dekoruar me Urdhërin e Flamurit, Medaljen e Kujtimit dhe të trimërisë. Ai mban dhe një dekoratë e titull shumë të lartë: Njeri i punës, i besës, i sofrës. Ndaj me të drejtë ata që e kanë njohur nga afër dhe dëgjuar për Kadri Demirin e Allajbegisë. Është sot mjaft domethënëse ajo që thonë pleqtë e Katër Grykëve: Kadri Demiri i Allajbegisë, atdhetar në log t'burrnisë...."

MEVLUD BUCI

AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet



Autostrada Tiranë - Durrës, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

Reklamoni biznesin tuaj!

GAZETA "RRUGA E ARBËRIT"
VË NË DISPOZICION
HAPËSIRAT E NEVOJSHME
PËR REKLAMËN TUAJ!

Tel: **(04) 22 33 283**

Email: **rrugaearberit@gmail.com**

Motivet dibrane të poetit vlonjat Ilir Balili

DIBRËS

Drini t'i di hallet, që ec i menduar
I vjen vala turbull, ende pa kulluar
Shkolla jote e hollë, dalluar për mendje
Ç'kanë më shumë të tjerët, para mendjes tënde?
Sa taborrë shkelën, tej Drinit u grinë
Mbenë në istikame, në varre nuk hynë
Labët e Veriut, me sër, me sqimë
Ti e ndjen barutin deri në Janinë...!

Poeti Ilir Balili lindi në Kuç në shtator 1956. Ka mbaruar studimet e larta dhe ka punuar në Dibër, kryetar i Degës së Punëve të Brendshme në vitet '80, më vonë në Krujë e Tiranë. Për shkak të detyrës së tij specifike ka rrugëtuar në të gjitha kontinentet si në Azi, Afrikë, Europë e Amerikë. Është qytet nderi në kryeqytetin Baton-Ruz të shtetit të Luzianës, në SHBA.

Ka botuar disa libra me poezi: "Shërri i reve", "Në faltoren time", "Për shpirt të perëndisë", "Pengu i fjalës", "Shenjtar të dhimbjes". Tre nga këto vëllime janë në Bibliotekën Ndërkombëtare të Aleksandrisë në Egjipt. Është vlerësuar nga kritika e specializuar si një nga zërat e spikatur në poezinë shqipe pas viteve 1990.

E kam lexuar poezitë e Ilir Balilit dhe jam mrekulluar nga poezitë e tij, me mendim filozofik me një tekst të shkurtër e me një nëntekst shumë domethënës që flet në jehonë. Në të gjitha botimet e tij gjen motive nga Dibra, por dhe nga folklori i kësaj treve, dhe nga "meselet" e odave të burave, të cilët poeti i ka veshur me flori artistik.

Si poezia "virtyti dhe vesi", "Ëndrra dhe ambicia", "Kur kthehet fleta" etj., që çdo rresht i poezisë ka filozofinë popullore.

Kur te kafe "Europa" në disa poet pinim kafe erdhi Ilir Balili. Biseduam gjatë, e Iliri shpesh përdorte thënie nga alegoria dibrane e herë herë dhe në të folurit me dialekt dhe atë ditë se Iliri poet është ky Ilir Balili, më njerëzori në pozicionin e në detyrën e tij zyrtare të atyre viteve.

Një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e tij poetike zë dhe poezia me motive nga puna dhe jeta në Dibër, për njerëzit punëtorë e të mençur që ka njohur si poezia e "Dibrës", "Zonja bjeshkë", "Raduç", "Në luginën e..." etj.

"Ilir Balili shkruan një poezi të shkurtër, shkruan Prof. Dr. Shaban Sinani, në të cilën një rol të rëndësishëm e luan nënteksti. Duket se këtu kanë lënë gjurmët e tyre "labët e veriut", dibranët, me të cilët ka punuar për një kohë të gjatë dhe sot i mban dhe e mbajnë mik, dibranët, me alegorinë e tyre të hijshme, të mençur, të hollë dhe të sertë. Këto tri vlera të poezisë shqipe të shkruar e gojore: zgjedhja popullore labe, thellësia e nëntekstit verior dhe teknika poetike bashkëkohëse e vjershërimit.

ILMI DERVISHI

Poezi nga Ilir Balili

BJESHKA ZONJË

Ç'rrjedhin andej e këtej ujërat me jehona
... të tëra në trojet tona
Nuk e do pse
Pranë piramidës në Gramë
Tek një buronjë
Bjeshka ka marrë emrin
Zonjë.

NË LUGINËN E ...

Brezi i butë...
Si brinjë ime
M'u shkel, m'u prek, m'u kafshua
Eh sa herë m'u drodh zemra mua
- Gjurmë nga jashtë-brenda...
Më çahej zemra
Ah, përroi i govatave, sa netë borxh më ke
Të tëra t'i fala, të gjithë për be
Ç'më pushtoi malli sonte për atje!

Portret krijuesi shkencor dhe letrar

Petrit Fetahu ka dhënë kontribut të dukshëm për shkencën e folkloristikës shqiptare dhe atë dibrane, por edhe si krijues artistik, ku ai gjithashtu zë vend të preferuar, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur.

Nga: **ARMOND DURAKU**

Në faqet e gazetave dhe revistave që heret e hasim emrin e Petrit Fetahut, i cili si gjimnazist imponohej me ndonjë poezi romantike apo me ndonjë artikull gazetaresk për çështjet aktuale të kohës që dallohej me impenjimin dhe guximin për të trajtuar probleme të realitetit të përditshëm, por që u bënë më të shpeshtë si student i shkollës së lartë pedagogjike, në degën e gjuhës shqipe dhe letërsisë , që e karakterizon prehtësia dhe syri kritik në trajtimin e problematikave rreth organizimimit të rinisë studentore në jetën shoqërore dhe kulturore, duke paraqitur edhe shumë portrete talentësh dhe aktivistësh të dalluar dhe shkrime me lëmitë tjera, që mbushën faqet e gazetave "Flaka e vëllazërimit" "Rilindja" e "Zani i rinisë". Ndërsa gjatë vazhdimit të studimeve në fakultetin filozofik në Prishtinë punimet e tij marrin dimension hulumtues e shkencor, me vështrime mbi veprat e lëtërsisë shqiptare, me analiza të thukta teorike-kritike. Kështu më 1968 botoi në revistën studentore "Bota e re"shqyrtimin "Tregime të Sterjo Spasses" ku zbërthehen shumë tema dhe ide të tregime dhe të personazheve, që shënon nismën e krijimtarisë studimore të autorit, që do të vinë një pas një pa u ndalur gjer më ditën e sotme.

Si profesor gjimnazi duke vërejtur se folklori i pasur dibran po e humbte , po zhduket ai thesar i lashtë popullor i etnokulturës shpirtërore të anasve etnik dhe modernizmi i kohës po i thjeshtësonte dhe po i tjetërsonte shumë rite tradicionale parakristiane, fetishe yshtje, besime mitologjike, botëkuptime arkaike, poloteiste e dukuri ataviste, këngë lirike të zhanreve të ndryshme, iu përkushtua gjyrmimit dhe evidentimit të shpëtojë sa të mundë prej atyre dukurive dhe fruymëzimeve emocionale foklorike të dibranit. Si rezultat i këtij përkushtimi konsuguent gjurmues të materialit të bollshëm nëpër gojët e plakave, nëpër ambientet e dasmave, nëpër dhomat e vajtimeve dhe nëpër vendet të tjera arriti të mbledhe e të sistemojë shumë prej tyre. Por një kontribut dhe ndihmesë të madhe i dhënë edhe vajzat e seksionit të traditës popullore që arritën të depërtojnë edhe në ato tubime dhe të shënojnë nga krijuesi dibran mjaft këngë dhe adete. Tërë ky materiali bollshëm u përfshi dhe u përmblodh në librin "Lirika popullore dibrane", që përpiluesi e botoi në vitin 2003, ku janë përfshirë afër 60 këngë të rrallla fëmijësh, 340 vargje ninullash, e gjithë ceremonia e dasmës me këngë dhe zakone apostafate, këngë pune me të gjitha llojet e tyre, këngë shoqërore, kurbeti, nizamësh, por ajo që e bën të veçohet këtë libër dhe që e duhet theksuar janë 2000 vargje vajtimesh, që e bëjnë Dibrën të dallohet ndër krahinat shqiptare me intu-



ité të theksuar rënditëse përkrah Shkodrës. Të gjith këto elemente e bëjnë këtë libër të çmueshëm në ruajtjen e traditës letrare e të kulturës shpirtërore të dibranit. Ky libër më vonë u përcoll edhe me studimin shkencor "Studime folklorike dibrane, ku Mr. Petrit fetahu merret me trajtimin hulumtues dhe analizues të të gjithë këtij materiali folklorik të lashtë për të nxjerrë mjaft hipoteza dhe teza të vijueshmërisë tradicionale të kulturës shpirtërore të kësaj treve, që ka zanafillë arkaike që nga periudha pagane, politeiste dhe që sintetizon tërë periudhat e zhvillimit mendor dhe kohor.

Krahina e Dibrës përmendet edhe për historinë e lavdishme të rezistencës dhe të luftës kundër pushtuesve të njëpasnjeshme, osman, sërb, bullgar, fashist, që mundësun të krijohet edhe një epikë e pasur mbi këto ngjarje dhe figura pjesëmarrëse, , që Mr. Petrit fetahu arriti t'i mbledhe e t'i sitemojë kronologjisht duke u përqendruar imanent në çdo betejë dhe pjesëmarrës, t'i zbërthejë përmes analizave të thukta e të dhënave eksplicite me të dhëna të shumta diakronike dhe koherante mbi këngën që veprat "Epika historike dibrane" dhe "Studime folklorike dibrane" i bëjnë ato vepra të rralla hulumtuese për shkencen folkloristike. Shqiptare.

Si vazhdimi studimor këtë vit, më 2012 pritet të dalë vepra tjetër shkencore "Studime folklorike 2" me financim të Minitrisë ë Kullturës të Maqedonisë, ku autori merret me çështje të përgjithshme të folklorit shqiptar që përfshinë një spektër të gjerë tematik, si me ndikimin e folklorit në formimin komplet të individit që nga mosha më e re, me besën si një virtyt sublime kombëtar, me çështjen e dashurisë dhe moralit të femrës sonë, me luftën e saj kundër agresorëve e shumë të tjera me vlera studimore.

Mr. Petrit Fetahu është marrë edhe me vështrime letrare, sidomos në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme nga viti 1972 kur në faqet e gazetës "Flaka e vëllazërimit vazhdimisht e gjejmë emrin e tij ku ai boton një varg kritikash letrare, si mbi veprën e Thoma Kaçorit "Për mëmëdhenë", poezinë e Dritëro Agollit, Ali Abdihoxhës si romansier, Mitrush Kutelit, Resul Shabait e shumë të tjerëve krijues bashkëkohorë dhe dibranë, që mundësuan të botojë veprën me punimet e tilla "Nëpër vepra", ku bën zbërthimin e thuktë e immanent të strukturës së veprës, të karaktereve, duke arritur të depërtojë në shumë elementetë kompozicionit, të zveshë hermetizmin e poezisë moderne dhe të sqarojë simbolikën dhe metaforat e saj, në këtë mënyrë të krijojë lidhje kuptimore midis autorit dhe lexuesit, për ta bërë më praktike.

Petrit Fetahu është provukuar edhe nga frymëzimi letrar dhe ka kultivuar prozën, i cili herë pas here nëpër faqet e gazetës "Flaka e vëllazërit" e pastaj "Flaka" është paraqitur me ndonjë tregim artistik, ndërsa në vitin 1985 në konkursin letrar të saj të shpërblehet me vendin e dytë me tregimin "Lugati i bardhë", ndërsa në konkursin e gazetës "Fakti" do të marrë shpërblimin e parë me tregimin "Ekspedita" ndërsa më vonë do ta shpërbleje gjithashtu me vendin e dytë nga Akademia e Shkencave të Maqedonisqë. , duke lënë gjurmë në prozën bashkëkohore. Në sajë të njohjes së tij dhe të vlerave artistike tregimtare, të njohjes së tij më gjërë, Ministria e Kulturës ai botoi përmbledhjen e tregimeve më 2008 me titull "Pasione kohe", ndërsa në Dibër bëri bujë tregimi "Senja tetë me u".

Mundet puna e tij si pedagog ndikoi të shkruajë edhe për fëmijë. Rregullisht e gjejmë në faqet e revistave për fëmijë "Gëzimi" dhe "Fatosi"dhe atë me tregime dhe me pjesë skenike, por edhe pjesëmarrës në konkurset letrare te ketyre revistave me shpërblime të vendeve të para apo të dyta, ku gjithashtu shihet prirja dhe intuita krijuese për moshat e reja, duke u përqendruar sidomon te dituria si një dhuratë e madhe që u sjell lumturi dhe prosperitet në jetë. . Si rezulltat I kësaj veprimtarie, ai boton dy vepra, si "Bilbili dhe korbi" dhe "Mishmashi".

Pra, Mr. Petrit Fetahu ka dhënë kontribut të dukshëm për shkencën e folkloristikës shqiptare dhe atë dibrane, por edhe si krijues artistik, ku ai gjithashtu zë vend të preferuar, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur.

art

Në foto:
Hamza Halili



Nga: **SAKIP CAMI**

SKULPTORI HAMZA HALILI
Artisti që e bën gurin dhe drurin të buzëqeshë dhe të qajë si njerëzit



Ka shumë artistë që mbeten të panjohur për faktin se punët e tyre i kanë përvetsuar të tjerët dhe janë mburrur me to. Kanë mbetur në hije sepse si edhe në disa fusha të tjera të jetës edhe në letërsi, art dhe muzikë disa të vetëquajtur të mëdhenj vazhdojnë të trumbetohen si të pazëvendësueshëm, si gjenialë, si ata nuk paska të tjerë.

Një nga ata artistë që të magjeps me punët e tij dhe që nuk mburret për to është skulptori Hamza Halili.

Po kush është Hamza Halili?

Lindi në Trebisht të Dibrës më 13 maj 1939. Me mbarimin e shkollës së mesme artistike u vendos në Tiranë ku dhe vazhdon të banojë. Ka shërbyer si specialist për shumë vite në Ndërmarrjen Artistike "Migjeni" Tiranë si dhe në Shkollën e Mesme Artistike "Jordan Misja".

Është autor i qindra punimeve artistike në dru allçi, gurë dhe në mermer. Më 1963 mori pjesë për herë të parë në Ekspozitën Kombëtare të Arteve Figurative në Tiranë me portretin në allçi "Fëmija" , një punim që tërhoqi vëmënndjen e kritikës për shijën e hollë të dhe talentin e autorit. Që atëhere është pjesëmarrës i rregullt në të gjitha ekspozitat kombëtare që janë hapur në Tiranë Më 1990 hapi në Tiranë ekspozitën e parë vetjake dhe më 1996 ekspozitën e dytë.

Skulptori dhe piktori Hamza Halili ka marrë pjesë në grupet e punës për realizimin e shumë veprave madhore të arteve figurative si të monumentit "Nënë Shqipëri", në Tiranë, të monumentit të Pavarësisë në Vlorë etj.

Ndër punimet më të njohura dhe të vlerësuara janë portreti në allçi "Heroi i urave" 1969, kompozimet në dru "Hedhja e farës" 1970, "Fllad rinor" 2005, "Perla e jetës" 2005 etj.

Mjaft nga punimet e skulptorit Hamza Halili kanë zënë vend në galerinë e arteve, në institucione të ndryshme artistike dhe në koleksione të shumta brenda e jashtë vendit si në Itali, Gjermani, Greqi, Maqedoni etj.

Pas një pune 15 vjeçare në studio dhe disa dekadave në veprimtari në dobi të prodhimit ai vendos të dalë me një ekspozitë me punime të zgjedhura. Në sallën "Ibrahim Kodra" në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve u ekspozuan 46 punime të tij, kryesisht në dru, allçi, gur dhe mermer. Këto punime janë të kohëve të fundit, por ka edhe ndonjë peng të vjetër të artistit, të paraviteve 90, që nuk mundi ta ekspozonte në atë kohë, për vetë kohën që ishte. Bie në sy, talenti, individualiteti artistik, mjeshtëria e skalitjes e trashëguar nga ustallarët e Dibrës dhe të Gollobordës që e bëjnë drurin të qeshë dhe gurin të flasë. Më parë ka marrë pjesë së bashku me të tjerët në ekspozita të ndryshme në Galerinë e Arteve Figurative, por tani ka "pushtuar" sallën që mban emrin e të madhit Ibrahim Kodra.

Skulpturat e tij nuk kanë diçitura. Çdokush i shikon, interpreton dhe përjeton sipas perceptimit të tij. Dhe kjo është dëshira ime artistike, shprehet skulptori.

Në këto skulptura ka realizëm, por ka edhe abstraksion, ka traditë, por ka edhe novatorizëm. Pjesën më të madhe të tyre e kanë figurat kombëtare si Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Adem Jashari, Naim Frashëri, artistja e madhe Tefta Tashko Koço etj. Bie në sy kushtimi që i bën autori figurës së femrës shqiptare, të nënave. Do të shohësh edhe një grua të ngarkuar me bucelën e ujit, edhe një nënë që ushqen fëmijën me gjirin e saj, edhe një vajzë që është veshur me rroba plazhi. Janë femra të lindura nga druri, nga guri, i them me dashamirësi skulptorit. Figura e femrës dhe e nënës në tërësi është parë në kompleksitetin e vet, por edhe si krijuese të jetës. Një skulpturë që paraqet një grua të ngarkuar, që mban në shpinë ngarkesa, dru, apo bar për bagëtinë, të duket si fenomen i së shkuarës, por është edhe sot një realitet i hidhur si dikur. Ka akoma gra në zonat rurale që ngarkohen me pesha të rënda dhe kjo duhet të na shqetësojë të gjithë , jo vetëm autorin. Skulptori Halili, më thotë se kjo i përket së shkuarës në zonat e vendlindjes së tij, por unë e kundërshtoj se fatkeqësisht ky fenomen ndodh përsëri. Burrat janë në kurbet dhe gruas i bien të gjitha punët e rënda të shtëpisë.

Skulptori Halili i kushtohet edhe temës së mërgimit. Gollobordasit kanë qenë mërgimtarë brënda vendit të tyre edhe para viteve 90. Ata i ndërtuan pothujase të gjitha veprat më të mira të paraviteve 90. Autori paraqet një kërcu të gdhendur artistikisht, një zgavër të thellë që nuk mbushet, që shpreh një grua që prêt, prêt pafundësisht, burrin, djalin, vëllain të vijë nga kurbeti. Ngjarjet e Otrantos, mbytja e dhjetra shqiptarëve në detin e trazuar e ka shqetësuar autorin dhe e ka shprehur në skulpturat e tij që janë portrete që flasin, që akuzojnë. Po kë ?!

Kur mëson që autori ka punuar në Ndërmarrjen Artistike "Jordan Misja" dhe se nga mendja dhe duart e tij kanë dalë qindra projekte e modele artistike habitesh me thjeshtësinë e tij dhe qetësinë e tij. Ai nuk mburret. Talenti i lindur, ndonëse vetëm me shkollën e mesme artistike, sepse nuk e dërguan në Akademinë e Arteve bënte të mundur që gjërat e dala nga Hamzai të ishin të gjalla si njerzit.

Hamzait i pëlqen të përgatisë vepra skulpturore që vendosen në parqe ashtu si në disa vende të Europës dhe të botës. Ai filloi të pikturojë dhe të përgatisë skulptura që në moshën 17-18 vjeçare kur ishte nxënës në liceun artistik. Që në vitin 1964 ai ekspozoi skulptuirën e parë të titulluar "Portret fëmije, skulpturë që u vlerësua maksimalisht nga skulptori Andrea Mano, i cili do ta merrte Hamzain kudo ku ai punonte në komplekset skulpturore monumentale të vendit. Kështu Hamzai merr pjesë në përgatitjen e veprës "Nënë Shqipëri" , të monumentiut të pavarësisë në Vlorë, në Gjirokastër etj. Ai nuk e nxjer nga duart veprën pa e latuar deri në perfeksion, deri sa ta shëndrrojë në një qënie të gjallë. Jeta e gjallë në krijimtarinë e tij është tipari kryesor që e shoqëron atë. Mjeshtëria artistike, individualiteti, mbështetja në tabanin kombëtar janë pjesët përbërëse të krjimtarisë të këtij artisti të heshtur, por që meriton vëmëndje.



Sot, në vargun e vëllimeve me poezi, që kanë mbushur libraritë shqiptare i shtohet dhe një libër i ri, me autor Jahe Fida.

Një ëndërr e tjerrë në vite e Jahe Fidës

Në vëllimin, "Një ëndërr e tjerrë në vite", të autorit Jahe Fida, gjen poezitë e frymëzuara nga jeta jonë e përditëshme, poezi që shprehin një domethënje të thellë, me figura, detaje e mbresa të gjalla. Ato janë me mendime e ndjenja. Duke njohur mirë ndjenjën, dhe botën e pasur që na rrethon, poezia buron e pastër, me vlera, dhe ide artistike, e orgjinale dhe koherente, gjë që e bënë poezinë të larmishme, dhe tërheqëse. Tek këto poezi të autorit gjen ngrohtësi prej prindi të mirë, vecanërisht atë të gjyshit zemërmadh, që di të hyjë në zemrat e nipërve dhe mbesave, me natyrshmëri e ndjenjë , të zbulojë, e të nxisë, ëndrrat, dhe dëshirat e tyre. Ja si shkruan autori tek poezia, "Pika e mjaltit"

"Te jesh i sigurt nipi im flori,
pikë e parë e mjaltit, për mua je ti!"

Pra motivet në poezi kanë një këndvështrim orgjinal e fëmijëror, janë vargje të bukura që i shkojnë për shtat moshës fëminore.

Janë shumë poezi që i kushtohen nipit, mbesës, babait, bashkëshortes, shokut, mikut, vendlindjes, që kanë fabulën, brenda një frymëmarrje të gjërë. Janë trajtuar mirë me gjetje brenda, që të befasojnë kur i lexon, vargje me ritm, dhe me një mbështetje të madhe, në gurrën popullore.

Poezitë " Boka e bardh", "Kroi i Strahins", "Fluturës", "Rrëshqitja në dëborë", "Fllanxës"," Nënës", "Babait", "Kostumit" etj, janë nga më të ndjerat, sepse janë të lidhura ngushtë me problemet e jetës që i kanë dhënë gjallëri këtij vëllimi.. Po keshtu dhe temat e rendesishme politike e shoqerore, qe zene nje vende te konsiderueshem. Autori edhe pse e ka librin e pare ne poezi , duhet pergezuar per poezine e thjeshte, dhe orgjnale, per poezine e bukur, dhe te ngrohte.

Shpeshherë, poezia në këtë vëllim me forcën e fjalës, e të mendimit dhe figurës, ndikon drejtë për drejtë, dhe shumë shpejtë, tek lexuesi duke përçuar ide dhe veti nga më të mirat, si dashuri për vendlindjen, për natyrën e bukur shqiptare, e aq më tepër për zakonet dhe tradiat e bukura të malësorëve, për njeriun e mirë, për besën , sinqeritetin, dhe patriotizmin, si përshembull, tek poezia "Kroi i Strahinës"

"Vërtet do kërkoja,
Të pi një gllënjkë tani,
tek uji i Strahinës,
Uji për birinxhi...".

Këto vjersha janë të realizuara më së miri, sepse kanë ide e mendime me vlerë , që flasin qartë. Ai shkruan për mikun, shokun, qartë në mënyrë të çiltër e të përzemërt.

Në poezinë e autorit ka dhe vargje që kanë forcë të madhe goditëse dhe demaskuese, që tall dhe demaskon të pabesët, naivët, pseudopatriotët, gjë që shpreh guximin e tij qytetar.

Por dukuri kryesore e këtyre vargjeve, është tematika e gjërë dhe problematika e spikatur, e nxjerrë nga jeta dhe mjedisi ku jetojmë.

Libri i autorit është një shkëndijë e parë që dhe vetë autori e titullon "Ëndërr e tjerrë në vite", por më tepër se gjithçka kjo poezi është një dhuratë për njerëzit, për vendin e vet , që ai njeh dhe ka kaluar një jetë të tërë. Prandaj dhe është një mesazh kuptimplotë shprehet shkrimtari i mirënjohur Z. Bari Myftari. "Asnjëherë nuk është vonë, që të shkruash një libër,dhe është gjë shumë e bukur, që e ke filluar tani poezinë.. ."

KASTRIOT CAKA

Rruga e Arbërit nr. 71

"Gjenerali me shajak"

(Vijon nga faqja 7)

Shqipëria është një vend evropian, shtoi Elez Isufi, sundimi i gjatë osman nuk e ka shuar tek shqiptarët orientimin e tyre properëndimor, nga vendet me demokraci të përparuar. Shqiptarët në pjesën dërrmuese, sot, për nga pikëpamja fetare, janë myslimanë, por këtë konvertim ata e bënë për të mos u thithur dhe asimiluar nga sllavët dhe grekët. "Për të gjitha këto arsye, - përfundoi Elez Isufi, - shqiptarët nuk e shikojnë Austro-Hungarinë si pushtuese, por si një vend i madh dhe i zhvilluar që do të na fusë edhe ne në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit."

Fjala e tij me peshë i la mbresa të veçanta Franc Jozefit dhe përfaqësuesve të trupit diplomatik në Vjenë, që u habitën që një malësor i pashkolluar të kishte një vizion aq të qartë politik e atdhetar për vendin e vet të vogël dhe të panjohur. Elez Isufi u bë mik i perandorit, i cili, me atë rast, e nderoi me dekoratën e lartë të Franc Jozef Orden. 13) Franc Jozefi e deshi sinqerisht popullin shqiptar. Natyrisht, idile fshatarake nuk mund të ketë midis shteteve, por interesa, megjithatë historia ka plot shembuj të marrëdhënieve të sinqerta, të ndihmës efikase për zhvillimin e një vendi të vogël nga një shtet i madh. Austria ishte bërë tërheqëse për popullin shqiptar. Duke u mbështetur mbi këtë bazë, ajo mund ta bënte Shqipërinë një model që duhej ndjekur. Kjo mund të arrihej duke përjashtuar konfrontimin me shqiptarët, duke përshtatur me të një sjellje demokratike në respekt të institucioneve që do të krijoheshin. Austro-Hungaria nuk ishte e tillë që të shndërrohej në një perandori botërore, por me një shtrirje të kufizuar në Ballkan ajo do t'i vinte fre Rusisë dhe do ta ndihmonte zhvillimin në vendin tonë. Por Austro-Hungaria e humbi luftën, e cila nuk solli asgjë të mirë edhe për ata që e fituan atë. Franca humbi shumë njerëz dhe u dobësua aq shumë sa asnjëherë nuk iu nda frika nga Gjermania. Rusia ra në duar të komunistëve dhe e humbi përgjithmonë ndikimin e saj në Europë. Britania e Madhe, megjithëse hyri në luftë, e dinte mirë se nuk do të kishte ndonjë përftim prej saj.

* * *

Elez Isufi kishte simpati edhe për Anglinë dhe ka luftuar dhe punuar për t'u lidhur me të. Elez Isufi kishte bindjen se Anglia mund të jepte një ndihmë të sinqertë në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit. Për sa i përket Shqipërisë, ajo ishte mjaft larg saj, pa asnjë lidhje tokësore dhe detare, dhe se nuk kishte pretendime qoftë edhe për një pëllëmbë tokë të saj. Por këtë pretendim ajo nuk e kishte për asnjë vend të Europës. Kjo kishte lidhje me filozofinë e sigurimit kombëtar, baza nga ku nisej çdo lëvizje diplomatike dhe politike. Henry Kissinger ka shkruar për Anglinë: "Nisur nga koncepti se interesat kombëtare kërkonin ruajtjen e ekuilibrit europian, ajo ishte vendi që nuk donte gjë tjetër për vete, veçse të parandalonte dominimin e Evropës nga një fuqi e vetme." 14) Zhvillimi i ngjarjeve europiane e botërore e bënë Anglinë të lëvizte nga pozicioni i izolimit dhe pritshmërisë dhe t'i jepte tonin politikës evropiane kudo që të ishte e mundur. Qeveria e saj e bindi popullin se politika në lidhje me sigurimin e vendit kërkonte një angazhim të përhershëm dhe jo izolim. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në gjysmën e parë të shekullit XX një politikë e tillë ishte në modë, ajo ndiqej nga çdo shtet të cilit i dëgjohej pak a shumë fjala në Europë. Ekuilibri i forcave ishte parimi bazë i politikës dhe diplomacisë për më se një shekull me radhë. Europa ka hyrë në luftëra pikërisht kur shtete dhe burra shtetesh iu shmangën këtij parimi, i cili është formuluar në këtë mënyrë: "Sa herë që kishte rrezik që një shtet të bëhej dominues, fqinjët e tij krijonin një koalicion-nisur jo nga teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare, por, thjesht, nga egoizmi për të frenuar ambiciet e më të fuqishmit." 15) Ballkanin mund ta mbanin të stabilizuar vetë Fuqitë e Mëdha. Elez Isufi e kishte shpresën tek Anglia, shtet i madh dhe i zhvilluar që, për më tepër, nuk ndiqte një politikë ekspansioniste. Në kohën për të cilën do të bëjmë fjalë, shteti shqiptar ishte krijuar, por ata që hipën në krye të tij nuk kishin një bazë filozofike, që do të shërbente për të shtruar shinat nga do të ecte shteti, si do të zhvillohej dhe të mëkëmbej. Që në fillimet e tij ai qe një shtet i çorganizuar, pa institucione efikase, ku çdo gjë i lihej rastit. Politikanët ambiciozë nuk shikonin interesat kombëtare, por interesat e veta.

Elez Isufi arriti të bëhej mik i ministrit britanik në vendin tonë në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar. Ju dha rasti apo e krijoi vetë, kjo është një çështje e diskutueshme, por njohja e Elez Isufit me Airesin ka ndodhur në mars të vitit 1922, kur kreu dibran, në kuadrin e të ashtuquajturës Lëvizja e Marsit, sulmoi Tiranën, duke iu përgjigjur kështu thirrjes së mjaft deputetëve që i ndruheshin shumë prirjes diktatoriale të Ahmet Zogut në krye të shtetit shqiptar. Në atë kohë kryeministër ishte Xhafer Ypi, por ligjin e bënte ministri i brendshëm, Ahmet Zogu. Kabineti u shpërbë, deputetët ikën nga kryeqyteti dhe mbeti për të organizuar qëndresën ndaj forcave të Elez Isufit vetëm Ahmet Zogu. Mbas tri ditësh luftimesh ndërhyri Airesi për të arritur një kompromis. Elezi iu bind këshillave të tij. Nuk ishte aq i bindshëm Elezi, por ishte diplomat. Mendja e tij aq pjellore e gjeniale mund të bënte çdo lloj inskenimi për të dalë atje ku duhet, për të krijuar kushte të favorshme për lidhje me njerëz të mëdhenj, që i hynin në punë. Elez Isufi edhe të pamundurën e bënte të mundur. Ai e kërkonte kompromisin dhe marrëveshjen edhe atje ku ato nuk ekzistonin. Në lidhje me Lëvizjen e Marsit, Elezi ka thënë se e vetmja e mirë që pati prej saj, ishte njohja dhe miqësia me ministrin anglez, Airesin. Ne kemi të drejtë të besojmë në këtë miqësi, se gjatë dy vjetëve (nga njohja deri në vdekjen e Elezit), Airesi pati kërkesa të vazhdueshme ndaj tij nëpërmjet zonjave Sibil Llojd dhe M. Hazllëk që erdhën në Sllovë njëra pas tjetrës, e para sa ishte gjallë Elezi, e dyta, pas vdekjes së tij. Elezi vdiq, por lidhja e vendosur dhe miqësia nuk vdisnin. Airesi e çmonte shumë Elez Isufin dhe kishte bindjen që ai kishte ndikimi të madh në zhvillimin e ngjarjeve jo vetëm në trevën e Dibrës, por në mbarë Shqipërinë.

Qeveria e Britanisë së Madhe, madje vetë kryeministri Çurçilli, kishin bindjen se Shqipëria nuk duhej lënë pas dore në proceset e ndryshimeve që do të sillte Lufta e Dytë Botërore. Misionarët ushtarakë anglezë ishin ngarkuar me detyrë për të realizuar në praktikë ashtu ndryshimesh politike dhe ushtarake në Shqipëri që të ishin në sinkron me politikën britanike në Ballkan. Në prill të vitit 1943 majori Maklin dhe kapiteni Smajl u futën në Shqipëri nga jugu. Më vonë do të futeshin edhe misionarë të tjerë, njerëz të provuar në luftëra dhe sakrifica, inteligjentë dhe të aftë për detyrën e ngarkuar. Misionarët anglezë kishin një bazë të fuqishme në familjen e Ndreut në Sllovë ku kanë qëndruar mjaft kohë. Ajo bazë ishte krijuar qysh kur ishte gjallë Elez Isufi dhe Aires. Por, siç dihet, në Shqipëri fituan komunistët shqiptarë dhe marrëdhëniet me Anglinë u ndërprenë për më se një gjysmë shekulli. Shkoi kot përpjekja e Elez Isufit për të bërë miq të mëdhenj për Shqipërinë, kurse pasardhësit e tij u persekutuan.

> *Elez Isufi kishte bindjen se Anglia mund të jepte një ndihmë të sinqertë në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit. Për sa i përket Shqipërisë, ajo ishte mjaft larg saj, pa asnjë lidhje tokësore dhe detare, dhe se nuk kishte pretendime qoftë edhe për një pëllëmbë tokë të saj. Por këtë pretendim ajo nuk e kishte për asnjë vend të Europës. Kjo kishte lidhje me filozofinë e sigurimit kombëtar, baza nga ku nisej çdo lëvizje diplomatike dhe politike.*

---

1) Sami Frashëri: "Personalitete shqiptare ne Kamus Al-a`lam", Shkup, 2002, f. 195
2) Xhelal Ndreu: "Nuk ka qetësi në Lisivalle", Tiranë 1994, f. 69
3) Kujtime të Qazim Përnezhës
4) Hilmi Sadikaj: "Qëndresa ndaj pushtuesit bullgar në Dibër gjatë Luftë së Parë Botërore"(Muzeu Historik Dibër)
5) Aty
6) Aty
7) Aty.
8) Henry Kissinger: "Diplomacia", Tiranë 1997, f. 93
9) Aty, f. 143
10) Aty, f. 138
11) Kujtime të Qazim Përnezhës
12) Xh. Martini: "Elez Isufi", Tiranë 1994, shkrimi në kopertinën e pasme.
13) Aty, f. 61.
14) "Diplomacia", cit., f. 221
15) Aty, f. 222

Keq e më keq...

Nga: **HASAN LEKA**

Kjo mesele tregohet kur duam të tregojmë për një fshat, lagje ose shoqërinë në tërësi, ku sundon e keqja, humb morali e njerëzillëku, gjëra që mund të sjellin shkatërrim e anarki.

Fshati B... i kish banesat rrëzë një mali. Banorët e tij për vite të tërë kishin jetuar në harmoni e me kushte të mira jetese. Kishin pyllin mbi fshat, që e ruanin me shumë merak dhe e përdornin vetëm për kullota e prerje gjethi. Me mendim të përbashkët e mirëkuptim ishte vendosur që të mbrohet nga prerjet për dru mbasi rrëketë e shiut dhe orteqet e borës mund ta shkatëronin fshatin.

Po kështu edhe rregullin për ujitjen, për ruajtjen e bagëtive e sebepet i kishin përcaktuar dhe i zbatonin me rregull e mirëkuptim. Kjo traditë kishte ca vite që ishte prishur dhe njerëzit nuk i ruanin më zakonet e vendimet e marra por filluan të bëjnë secili sipas qejfit të vet, pa pyetur për kararet e vendosura e të zbatuara nga të parët... Filluan të presin dru në zonën e ruajtur mbi fshat. Disa të tjerë me dinamit shkatërruan ca shkëmbenj dhe me gurët e nxjerrë ndërtuan shtëpi.

Prishën rregullat e mirëkuptimin dhe kryeplak zgjodhën njërin që siç thuhej ishte dinsëz dhe i hurit e litarit. Kapadai e injorant, bënte ç'të donte mbasi siç thonin, kish krijuar ca lidhje lart në qeveri dhe shteti e mbronte edhe në të padrejtë e bënte ca pazare me të.

Një ditë prej ditësh, në të ngrysur, nga mali u dëgjua një zë i fuqishëm dhe i çjerrë. Thirrja e zërit përsëritej tri herë: Keq, keq... keq... Kjo u dëgjua nga çobanët që po sillnin bagëtitë në fshat, por edhe nga banorët që i kishin shtëpitë më afër pyllit të cilit tani i kishin mbetur vetëm ca lisa rrallë-rrallë e ca cungje të drunjve të prerë.

Ky zë u përsërit përsëri natën e dytë, pak më vonë se radhën e parë. Keq... keq... keq... Një gjuetar që kish zënë pusi për të gjuajtur dhelpra, mbi shkëmbin e zi, fiksoi një zog të zi, të madh dhe klithi dhe nxori zërin e çjerrë...

Kjo ndodhi shqetësoi fshatarët, të cilët në darkë u mlodhën te Lisi i Din Gjelit që ndodhej në mes të fshatit e zakonisht aty mblidheshin burrat e fshatit. Filloi kuvendi. Njerëzit të frikësuar jepnin shpjegime të ndryshme.

-Jemi bërë të ligj e s'merremi vesh me njëri tjetrin. Jemi prishur me Zotin e bërë ibret, duam të hamë njëri tjetrin, foli një plak.

-Nuk shkoni në xhami e nuk jepni lekë për hoxhën, nuk njihni Zot e shpirtin ja keni dhënë dreqit, foli njëri që kish veshur një pallto të zezë e kish vënë në kokë kësulën me çallmë dhe ish bërë hoxhë... Zoti po na lajmëron për ndëshkim...

-Ne jemi bërë të ligj e kemi prishur harmoninë e mirëkuptimin. Kemi prerë pyllin e thërrmuar shkëmbinjtë. Rrëketë po na shkulin shtëpitë, prit kur të bjerë edhe ndonjë ortek e ta çojë gjithë fshatin në greminë... foli mësuesi i fshatit,... Duhet vendosur rregulli për pyllin e për ritet e traditat e të parëve, duhet marrë kredi nga shteti e bashkë me ato të pyjores të ripërtërijmë pyllin sipër fshatit... e mbylli fjalën ai...

Folën dhe të tjerë, foli edhe kryeplaku pasi llafosi me hoxhën.

Shpirtrat e këqinj e dreqi i mallkuar po na kërcënojnë. Ne duhet të marrim masa dhe ta mbrojmë fshatin. Të kërkojmë para nga qeveria e të ripërtërijmë pyllin (Kish ardhur rasti me vjedh ca para!!) Të bëjmë një dua me hoxhën për t'i zbutur inatin shpirtit të keq, prandaj do të paguajë diçka secili dhe të bëjmë kurbane e hallvë (të fitonte edhe ai ca para).

-Çdo natë një burrë për shtëpi, do të dalë te shkëmbi i zi dhe të ruajë derisa të dalë zogu shtrigan dhe t'i përgjigjet atij me fjalët korresponduese: mirë... mirë... mirë, pas çdo klithme keq... keq... keq... të shpirtit të keq... përfundoi fjalën hoxha pas kryeplakut.

U vendos dhe kështu u bë: Çdo natë një burrë për shtëpi dilte pranë shkëmbit. Rrinte aty derisa të dilte zogu i zi që çirrej me thirrjet keq, keq keq... dhe fshatari roje çdo fjale keq i kundërpërgjigjej me fjalët mirë, mirë, mirë.

E keqja ishte se ora e natës, kur dilte nuk ishte fiks. Kish rast që duhej pritur deri duke dalur drita, për tu kundërpërgjigjur. Njerëzit u mësuan me këtë rit dhe nuk bënin asnjë lëshim në radhë, por nga prapësitë e poshtërsitë nuk u tërhoqën. Edhe fondet për pyllëzimin i vodhi kryeplaku me hoxhën e prerja e drujve vazhdoi.

Një natë u kthye nga emigracioni djali i vetëm i nënë Mines që ishte martuar para ca vitesh. Plot mall u përshëndet me nënën e nusen, pa djalin e vogël dhe u ngazëllye nga buzëqeshjet e tij. Mendoi të shplodhet e të flejë me nusen atë natë dhe nesër të dalë të takojë shokë e miq...

Nuk kish mbaruar së piri as kafen e akshamit me nënën, kur ja mbërriti kryeplaku fodull e i kapërdisur... Pa i thënë as mirë se na erdhe .. i këlthet:

-Boll na ke ikur e ke fituar. Ne kemi bë edhe radhën tënde për të ruajtur shpirtin e keq... tani lere atë kafe e shpejt te Shkëmbi i Zi. Prite derisa të dalë shpirti i keq, e përgjigju... Do ta bësh tre netë rresht se e kemi bërë ne për ty kaq kohë... Hajt... shpejt... e mos na bëj naze...

-Po prit more burrë, thuaj njëherë shyqyr që erdhe... Pa ulu e pi një kafe... Po njerëz jemi e malli na ka lodhur. Vazhdoni edhe sonte, sikur keni bërë e nesër mbrëma filloj unë dhe i bëj edhe tri-katër netë.

-Paske llafe shumë ti, foli ashpër kryeplaku... Jeni bërë pareli e kujtoni se ne jemi budallej e na shikoni si miza... Ka rregull këtu.

U përpoq i miri djalë t'ia mbushë mendjen kryeplakut, por ai nuk hante fare pykë.. Me të mirë e me zë të lartë ai nuk reagonte fare. Iku kryeplaku dhe djali u shkoi dy komshijve t'I bënin radhën... por jo. Edhe ata i folën me gjuhën e kryeplakut...

U mërzit sa s'bëhet, që nuk po e

homazh

Madhështia e njeriut të thjeshtë



© Foto: Bujar Karoshi

Hej, Hasan, sa shumë na dhemb vdekja jote, vdekje e parakohshme! Na dhëmb, sepse na u shkul nga vatra një lis me degë të rënda e të gjata, që e mbante krahërorin përherë nga shtërngata! Na dhemb se na u u fshi nga horizonti një buzëqeshje e çiltër, një emër i qartë, një dorë e bardhë dhe një zemër bujare. U shua një flakë për të ndezur mijëra kujtime…

Homazh për mikun tonë të shtrenjtë, Hasan Leka

Nga: **NAIM PLAKU**

Disa ditë, pasi u nda nga jeta fare papritur e pakujtuar miku ynë i përzemërt dhe i nderuar Hasan Leka, se si m'u shtua edhe një herë kërshëria dhe dëshira për ta rilexuar librin e tij të fundit **"Në rrjedhë të jetës",** një testament aq kuptimplotë dhe me vlerë për ne dhe familjen e tij, ku shfaqen dukshëm përmasat madhështore të njeriut të thjeshtë, të njeriut të punës, njeriut të pajisur me vyrtytet më të çmuara të moralit njerëzor, të atij njeriu, që, siç thotë populli, ngado që shkon e kudo që prek, lë emrin e tij të mirë në jetë. Megjithëse librin e përshkon tejendanë modestia që e karakterizonte gjithmonë Hasanin, ai, duke përshkruar me sinqeritet jetën e tij, vendlindjen, mjedisin ku lindi dhe u rrit, familjen e tij, shkollimin e vështirë, por të suksesshëm, karrierën profesionale, ulje-ngritjet e zakonshme që ka çdo kuadër në rrugën e tij të punës, na jep fare qartë profilin e tij njerëzor. Faqja e fundit e këtij libri ka mbetur e hapur… Sigurisht, që na përket neve që jetuam e punuam me të, që e njohëm në të mirë e në të keq, që hëngrëm e pimë bashkë, që qeshëm e qamë tok, që dëgjuam herë larg e herë pranë zërin e njëri- tjetrit, ta shkruajmë dhe faqen e fundit të këtij libri që duhet të mbyllet me urimin e merituar: **Qofsh i bardhë edhe në atë jetë!**

Dibra thotë gjithmonë fjalë të mençura. Ajo ka gjetur fjalë edhe për të uruar lindjen, edhe për të ngushëlluar vdekjen. Por vdekja krasit pa short të mirë e të keq, të bardhë e të zi, të gjatë e të shkurtër, trima e frikacakë, të mençur e budallenj. Kur ta vizaton portretin me tri fjalët**: Fëmijë i mbarë, djalë që i ngjet kohës e burrë që hijeshon konakun,** atëherë dije që të ka vënë në majë të shkëmbit e nuk të zbret kollaj prej andej. Besoj se këtë portret kishte dhe Hasani-cullë, Hasani-djalë dhe Hasani-burrë.

Ky fëmijë i mbarë lindi në familjen e varfër, por të nderuar të Emin Lekës në katundin Shumbat të Dibrës më 3 nëntor 1942. Baba i tij, me një tufë fëmijë mbi supe e një barrë halle mbi shpinë bëri çmos që këtë vatër të mbushur me cicërima fëmijësh ta mbante të ndezur përherë me dritën e dijes. Dhe kështu, falë Zotit, siç deshi, u bë. Fëmijët e tij kush më shumë e kush më pak iu veshën shkollës dhe u arsimuan. Hasani-fëmijë po bëhej dalëngadalë ai djali i urtë me tipare të bukura e fisnike, me fytyrë përherë të qeshur e të gëzuar, me atë shikimin e mprehtë e të zgjuar, që po i ngjante kohës. Mbaron shkëlqyeshëm shkollën fillore dhe, falë interesimit të mësuesve, i sigurohet një bursë studimi për në shtatëvjeçare (atëherë ishte sistemi 7-vjeçar në arsim) dhe vazhdon po me këtë ritëm dhe po në qytetin e Peshkopisë shkollën e mesme Pedagogjike me rezultate gjithmonë të shkëlqyera. Familja kishte shumë nevojë për të dhe Hasani sakrifikon të ndjekë studimet e larta për t'i ardhur në ndihmë familjes. U emrua fillimisht mësues në shkollën 8-vjeçare të Sllovës, e cila në atë kohë numërohej si një nga shkollat më të mira të vendit. Jepte lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë dhe dallohet shpejt si një mësues me talent e pasion të veçantë, punëtor i palodhur e plot vullnet në edukimin e brezit të ri.

Gjatë këtyre viteve pata rastin ta njoh më mirë Hasanin. Të dy filluam studimet me korrespondencë në shkollën e lartë për gjuhë e letërsi dhe kemi udhëtuar shpesh bashkë në sezone provimesh. Bashkë u gëzoheshim rezultateve që merrnim në provime dhe ndihmonim njeri-tjetrin sidomos në sigurimin e literaturës plotësuese dhe materialeve që na kërkoheshin. Duke qenë afër njeri-tjetrit me banim në fshatrat e së njejtës komunë dhe të dy mësues të një profili shkëmbenim përvojën tonë dhe kjo pati ndikuar shumë edhe në arritjet për të patur rezultate të mira në përvetësimin e gjuhës shqipe nga nxënësit. Më vonë Hasanin e angazhuan në punët me rininë dhe në organet e rendit, por ai mbeti tërë jetën një mësues gjuhe dhe letërsie i aftë, i përgatitur nga ana shkencore dhe metodike. Ishte një njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe si i tillë gjeti kohë të merret edhe me problemet e saj, sidomos në fushën e leksikografisë duke ndihmuar në hartimin e fjalorëve terminologjikë dhe në "Fjalorin enciklopedik" ku ishte dhe një nga anëtarët e redaksisë. Ishte një studiues i zellshëm i letërsisë shqipe. Ka shkruar e botuar në organet e shtypit të kohës shumë artikuj studimorë e kritikë për autorë e vepra letrare. Ka filluar të botojë që i ri artikuj problemorë e metodikë për shkollën në gazetën "Mësuesi" dhe "Studime pedagogjike" dhe në organet e shtypit lokal e në revistat e kohës si "Shkenca dhe jeta" Për mbrojtjen e Atdheut", etj. Kështu Hasani vërtet ishte një djalë i plotësuar që i ngjante dhe përmbushte kërkesat e kohës.

Sa keq që këtë djalë të mirë na e rrëmbeu vdekja kaq shpejt e papritur!

Në vitet 1985 -1990 mbaroi studimet pasuniversitare për Filozofi dhe mori gradën shkencore kandidat i shkencave e më vonë doktor në shkencat shoqërore. Vitet e fundit, duke qenë më i lirë pasi doli në pension, u mor me krijimtari të mirëfilltë letrare duke botuar vëllimet dinjitoze "Në kufi", "Foleja e grenxave", "Operacioni merimanga", "Lezeti i muhabetit" dhe librin autobiografik "Në rrjedhë të jetës". Edhe në krijimtarinë e tij në prozë vihet re origjinaliteti dhe gjuha e pasur që përdor në tregime për të shprehur ngjarjet e përjetuara dhe përshtypjet e mendimet për personazhet që njohu në jetë.

Hasani ka punuar në Peshkopi, në Tiranë, në Tropojë, etj., por kudo që ka shkuar ka lënë mbresa e përshtypje nga më të mirat. **"Përse mos ta dua, -** thoshte një miku ynë, **- Si nuk gjeta së paku një njeri që të flasë keq për të! Hë, mor Hasan, a edhe këtu meriton dhjetë?"** Ja, pra, dalim përsëri tek ai vlerësimi që i jep populli djalit të mirë. Ishte djalë që i ngjante kohës, që ecte i matur në rrugën e vështirë të ngjitjes duke parë dhe anash, dhe poshtë, dhe lart. Ta thoshte hapur gjithçka. Nuk e tradhtonte kurrë drejtësinë. Ishte mësuar të mos hynte aq thellë sa të zhytej e të mos dilte prej andej. Nuk i fliste askujt keq. Nuk përgojonte asnjeri. Këshillat e tij ishin tepër miqësore dhe të sinqerta. Të pranonte dhe të kundërshtonte me buzëqeshje. S'bëri kurrë armiq. Kishte plot miq dhe të gjithë e respektonin. Ndoshta këto cilësi morale i trashëgonte dhe nga familja, nga prindërit e mirë, të dashur e punëtorë, nga tërë familja shembullore që kishte, me vëllezër e motra, me kushërinj e farefis. Ishte model i një djali për të cilin ka aq shumë dëshirë çdo prind që ta ketë fëmijën e tij.

Hasani ishte shok i mirë, vëlla i respektuar, mik i nderuar, prind i dashur e shembullor. Hasani ishte burrë që të hijeshonte konakun. Gjatë jetës së tij qe vënë në kryevendi për merita pune në drejtimin e rinisë, si drejtor e komisar shkolle, etj., por mbeti kurdoherë i nderuar dhe i respektuar, mbeti gjithmonë shoqërisht i vlerësuar për marrëdhëniet që ndërtonte me vartësit, në komunikimin me njerëzit e thjeshtë, gjithmonë korrekt e punëtor, asnjëherë mendjemadh e djallëzor, gjithmonë i dashur dhe i thjeshtë duke merituar respektin e të gjithëve.

Thonë se kur vdes një prind i mirë qajnë dhe trarët e shtëpisë. Kur vdes një kopshtar i zoti, lulet ulin kokën. Kur vdes bariu, delet blegërijnë e vrapojnë. Kur vdes njeriu i mirë të gjithë ia përmendin vlerat, ia prekin madhështinë. Këto ditë u nda nga jeta, Hasan Leka. Dhimbje për familjen, për bashkëshorten e tij dhe tri vajzat që la pas, dhimbje për vëllezërit e tij, për farefisin, miqtë dhe shokët e zemrës, për tërë ish-nxënësit e tij, për të gjithë ata që e njohën dhe e përcollën me nderime të mëdha atë ditë në banesën e fundit.

Hej, Hasan, sa shumë na dhemb vdekja jote, vdekje e parakohshme! Na dhëmb, sepse na u shkul nga vatra një lis me degë të rënda e të gjata, që e mbante krahërorin përherë nga shtërngata! Na dhemb se na u u fshi nga horizonti një buzëqeshje e çiltër, një emër i qartë, një dorë e bardhë dhe një zemër bujare. U shua një flakë për të ndezur mijëra kujtime…

Ka mbetur një vend bosh në rradhët tona. Një zë që s'do të ndihet më. Një dorë që s'do të lëvizë më, fleta e fundit e një libri të pambaruar, një faqe e bardhë që duhet shkruar…

Lamtumirë, baba, mik, shok e vëlla! Lamtumirë, njeriu ynë i mirë!

Keq e më keq…

linin natën e parë të rrinte në shtëpi me nënë e nuse… Por më shumë u mërzit me këtë sjellje kaq dashakeqëse të bashkëfshatarëve të tij…

-Si qenkan bërë këta moj nënë… o këta s'njihkan arsye s'paskan pikë njerëzillëku e hatërllëku… këto qenkan më të ligj se egërsirat, qenkan shpirt kazëm… E shfryu sa mundi i shkreti djalë…

Nëna e mërzitur sa s'ka i tha: -Bir o bir, këtë fshat e ka mbuluar ligësia dhe e keqja.. prandaj dhe shpirti i trazuar i zogut të zi, këlthit keq… keq… Shko bir e bëje detyrën e nesër prapë këtu jemi, nusen këtu e ke…

Djali i mërzitur shikoi djalin e vogël, shikoi nusen me lot në sy, pa nënën edhe njëherë të heshtur si nata dhe u nis… Nuk foli asnjë fjalë…

Arriti te Shkëmbi i Zi dhe u ul që ta priste. Zemra i gufonte si motor i prishur, mendime nga më të këqiat i silleshin në kokë… Turfullonte i tëri nga zemërimi dhe urrejtja… Kaq të ligj janë bërë, kaq pa ndjenja e pa arsye… Prit e prit kaloi mesnata e zogu nuk po dukej… sytë po i mbylleshin… kur dëgjoi klithmën drithëruese e të keqe të zogut: Keq… U mendua të thotë mirë, por jo… një valë e nxehtë i doli nga gryka… Keq… klithi edhe djaloshi… Keq këlthiti Shpendi i Zi… Keq e më keq…. u bëftë, klithi djaloshi… Pas një farë kohe prapë shpendi i Zi klithi Keq… Djaloshi mblodhi gjithë forcat dhe bërtiti sa fuqi që kish … Keq e më keq u bëftë e tu shoftë fara o zog i keq, me gjithë ata që janë bërë të ligj si ti…

Një gjëmim i madh u dëgjua… Faqja e malit u rrëzua. Ai përpiu gjithë fshatin me tokë e shtëpi. Nuk mbeti qenie e gjallë mbi atë vend….

Shënim: Thonë që edhe sot në atë vend është vetëm një greminë dhe dheu i zi mbulon fundin e tij. Edhe bar e gjethe nuk rritet më atje… Mallkimi kishte qenë shumë i fortë për ata njerëz që kishin humbur cilësitë e të qenit njeri…

(Marrë nga libri "Lezeti i muhabetit" - 2010")

Botime të reja

roman



Xhafer Martini
Kur Vdiste Kanuni
Roman
Botimet Geer
Tiranë, 2012.
416 faqe

800 lekë

ISBN: 978-9927-07-040-1

publicistikë



Skënder Cala
Magjia e Dibrës
Publicistikë
Botimet AQSHF
Tiranë, 2011.
344 faqe

800 lekë

ISBN: 978-9927-4067-2-9

histori



Vahid Kormaku
Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit
histori
Botimet "M&B"
Tiranë, 2012.
186 faqe

600 lekë

ISBN: 978-99956-04-73-8

dokumente



Zyber Gjoni,
Haki Përnezha
Dibra në defterët osmanë (1467, 1853)
Dokumente
Botimet "M&B"
Tiranë, 2012.
382 faqe

1000 lekë

ISBN: 978-99956-04-72-1

cyan magenta yellow black